ISSN 1857-6443

Regjistrimi pa etni

Ide "kreative" prej një budallai

Fq.3



DËSHMI TË REJA

Ekspertizë gjysmake për "Monstrën"

Fq.5

Yt atë dhe jot ëmë ishin idealistë! Po ti?!

Fq.10



www.koha.mk

Koha

KOHA për kulturë

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3514 · e martë, 20 nëntor 2018 · 1°C | 8°C · 15 DEN

AKTUALE

Punëtorëve shëndetësor u soset durimi



Sindikata e Qendrës Klinike e ka vlerësuar të papranueshme rritjen e propozuar të koeficientit të vështirësisë në punë për pagën e janarit me Buxhetin e vitit 2019, e cila për mjekët specialistë është 10 për qind, ndërsa 5 për qind për punëtorët dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë, me çka, theksojnë në këtë Sindikatë, shkaktohet ndarje e sindikatës. "E hodhët mollën e grindjes....

Fq.9

RAJON

Vizat përballë skepticizmit të BE-së

Fq.16

SPORT

Unitedi s'do të gjejë trajner më të mirë se Mourinho

Fq.22

GLOBI

May kërkon ndihmë

Fq.17

TREGU I PUNËS ME DISBALANS TË MADH

NUK PUNON KUSH PËR 200 EURO!

"Nuk mund të prisni që një i ri të regjistrojë shkollën e mesme profesionale e që nesër të punojë për 12 apo 15 mijë denarë. Kjo është absurd i kohës, pasi paga është faktori që i motivon të rinjtë të ikin prej shkollave të mesme profesionale, apo i demotivon të regjistrohen në këto shkolla. Duhet të kuptohet se kaloi koha e pagave të ulëta në Maqedoni", thotë Nenadiq

Fq.4

Kush i helmon qentë në Tetovë?

Tetovë, 19 nëntor - Gjatë ditëve të kaluara, në Tetovë janë hasur qen endacak të helmuar. Kjo dukuri tashmë po përsëritet pas një periudhe katërvjeçare, kur kishte helmime masive të qenve endacak në rrugët e Tetovës. Edhe pse kanë kaluar disa ditë nga helmimi masiv i qenve endacak, megjithatë deri më tani nuk është zbuluar se kush qëndron prapa këtij akti. Kjo është hera e tretë që brenda katër viteve ndodh një helmim i qenve endacak, të cilët kohëve të fundit kishin "okupuar" rrugët kryesore dhe perfierike të qytetit të Tetovës, por ende nuk është zbuluar se kush e kryen një akt të këtillë. Në Qendrën për Shëndet Publik nuk ka denoncim të këtillë se ka të ngordhur apo helmuar qen endacak. "Unë mund të them se nëse në vendin e përmendur qentë kanë shkumë në gojë dhe nuk kanë shenja dhune...

Fq.8

QËNDRIM

"AKSIDENT I DEMOKRACISË" NË RUMANI

Nga Robert SCHWARTZ

Presidenti rumun, Klaus Iohannis ka të drejtë: Ashtu si vepron qeveria socialliberale aktuale në Rumani e si e paraqet veten jashtë vendit, mund e duhet të ekzistojë cilësimi një "aksident i demokracisë". Iohannis e bëri këtë vlerësim menjëherë pas raportit të progresit të BE-së për Rumaninë, i cili ishte një shuplakë për qeverinë. Më në fund - në një solidaritet të pazakontë si Komisioni Europian ashtu edhe Parlamenti Europian i kanë treguar kartonin e kuq qeverisë rumune për sulmet e vazhdueshme ndaj pavarësisë së sistemit gjyqësor - e gjitha kjo përtej kufij partiakë dhe solidaritetit të shumëpërfolur e të pakuptueshëm brenda familjes së partisë. Për socialdemokratët rumunë, (PSD) dhe partnerin pseudoliberal, ALDE një goditje e fortë. Ndërsa Klaus Iohannis, një liberal-konservator ka një mundësi për të kuptuar, se ai e ka mbështetjen e plotë për të mënjanuar këtë aksident. Presidenti besnik ndaj kushtetutës ka tani edhe provën e fundit, që ishte një gabim i rëndë vendosja e ushtares së bindur të partisë, Viorica Dancila në postin e kryeministres së vendit, kjo me dëshirën e kreut të dënuar të PSD-së, Liviu Dragnea.

Sa për kujtesë: Që para fitores së socialdemokratëve në zgjedhjet e vitit 2016 ishte e qartë që Dragnea, për shkak të dënimit me kusht për manipulimet zgjedhore nuk mund të bëhej kryetar i qeverisë rumune. Prandaj ai duhet të gjente urgjentisht mëkëmbës besnikë - propozimi i parë, një mikeshë e ngushtë e partisë- u refuzua nga presidenti për shkak të arsyeve të sigurisë kombëtare. Me një ritëm gjashtëmujor u zëvendësuan dy kryeministra, të pranuar nga Iohannis, por që shpejt nuk gëzuan më mbështetjen e padronit, Dragnea. Të dy nuk donin më ta mbështesnin porosinë e shefit për ristrukturimin e drejtësisë, fundin e luftës kundër korrupsionit dhe gërryerjen nga brenda të shtetit ligjor.

Viorica Dancila ishte zgjedhja e katërt e Dragneas. Ajo u kthye në një kryeministre shembullore për të bërë realitet projektet e kryemjeshtrit. Me zell ajo i përmbushte të gjitha detyrat e tij, për të nxjerrë nga banka e drejtësisë kolegë të dyshuar për korrupsion nga koalicioni qeverisës. Tani pak para arritjes së qëllimit final, BE shkeli frenat. Por sistemi Dragnea kundërgodet. Duke përdorur madje retorikën e vjetër komuniste e nacional-populiste të epokës së Çausheskut - se kemi të bëjmë me një perëndim që është armiqësor ndaj Rumanisë e përzihet në punët e brendshme të vendit dhe sistematikisht prish imazhin e Rumanisë, me porosi të bërthamës së BE dhe qarqeve ndërkombëtare, përfshirë edhe George Sorosin. Kush kritikon Dragnean dhe pasuesit e tij sulmon vendin. Sepse sigurisht shteti janë politikanët e korruptuar apo të dyshuar për korrupsion.

Qeveria që ende ka një mazhorancë të rehatshme në parlament po shkatërron përmes retorikës nacional-populiste dhe armiqësore ndaj Europës, sulmeve agresive kundër drejtësisë e lirisë së medias konstruktin e brishtë të demokracisë rumune. Gazetarët, politikanët e opozitës dhe sidomos shoqëria civile kanë paralajmëruar nga hapat mbrapa të Rumanisë. Bashkimi Europian, shumë i zënë me veten, dhe Hungarinë e Poloninë, e ka kuptuar me vonesë: Rumania është në kthetrat e kleptokratëve, që po e largojnë vendin hap pas hapi nga BE.

Pikërisht ky vend, që në gjysmën e parë të vitit 2019 merr presidencën e radhës së BE. Klauzolat mbrojtëse që u integruan në marrëveshjen e anëtarësimit të Rumanisë, nuk mjaftojnë më si sfond kërcënues: Transformimi i shtetit ka kohë që ka filluar. Presidenti Iohannis dhe BE nuk e kapën momentin e duhur, për të pastruar vendin e aksidentit. Tani nuk u mbetet gjë tjetër, veçse të bashkuar me forcat proeuropiane në vend të mënjanojnë një karambol masiv. Fjalët pa ekuivoke duhet të pasohen nga veprat. Ende nuk duket kështu. Por rreziku është i madh, që një aksident të kthehet në katastrofë me pasoja të rënda e afatgjata. *(DW)*

ENVER HOXHA DHE KOMITET I RRETHEVE



'Enver Hoxha e mprehi shpatën Edhe një herë o për situatën...' Di që do ta ketë pasur vështirë autori i kësaj kënge të shpikë diçka të re, të pathënë, për prijësin historik të Shqipërisë socialiste, Enver Hoxha. Pas gjithë atyre këngëve e poezive që do të flisnin për të si një figurë historike botërore - hiç më pak se gjeni dhe hiç më pak se trimi i trimave - çka tjetër mund të thuhej për këtë bir që nuk bën më nëna shqiptare?
Megjithatë autori nuk do të ishte ai që ishte, prijës i epikës ndër shqiptarë, po të mos kishte nxjerrë gatishmërinë e Enver Hoxhës për të mprehë shpatën kundër të gjithë armiqve të tanishëm dhe atyre që bëhen gati për t'u bërë armiq në të ardhmen. Prijësi e shpata janë imazhe që lehtë prekin nervin e shqiptarit - rrugën e shkurtër për te Skënderbeu- por problemi i lindi autorit kur duhej që 'shpata' të gjente diçka të madhe me të cilën do të rimohej. Dhe, autori gjeti që 'shpata' rri më së miri me fjalën 'situata', duke krijuar një kombinim metaforik që i rri bukur Shqipërisë së realizmit socialist. Në njërën anë "shpata", simboli mesjetar i nacionalizmit shqiptar, dhe, në anën tjetër 'situata', nga fjalori i analizave të komiteteve të rretheve, Frontit Popullor, Politbyrosë, si në 'Situata ndërkombëtare dhe ajo brenda vendit është e ndërlikuar...". Është ai momenti kur Skënderbeu vesh kostumin gri të sekretarit të Partisë, hipën në "Gaz" dhe niset për në Komitet, për të analizuar bashkëpunimin e të gjithë armiqve të jashtëm të vendit me të gjithë armiqtë e brendshëm të tij. Dhe meqë situata, siç e dimë, gjithnjë ka qenë e ndërlikuar, ka pasur arsye për të kënduar për mprehjen e shpatës si aktivitet ditor i Enver Hoxhës", shkruan në profilin e tij në FB, publicisti Veton Surroi.

KUR KËRKONIM BITCOIN-a



"A ju kujtohet para një viti që kqyrshim me i shit shpiat, banesat, fmit, gratë, babe, nanë, t'gjallë e t'dekun krejt çka kishim, veç me ble naj bitcoin? Nuk gjëjshim as sa për ilaç.
Ata që kishin ble bitcoin me moti kryet përpjet e mbajshin shehrit, na që s'kishim veç i kqyrshim plotë lakmi e xhelozi, edhe ua llogaritshim fitimin. Me vete thoshim: 'pshtun k'ta, tash veç rrijnë edhe milionat ju vijnë n'bank, edhe kurrë s'kanë me pas nevojë me punu'. Vakt, o vakt!
Po tybe kjo dynja për kërkon s'ish, veç kush t'mashtrohet. S'po t'lejshin as me u gzu fort, po as me u idhnu fort...", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari dhe publicisti nga Prishtina, Ilir Mirena.

MEDIACitate

SERBIA KUSHTËZON DIALOGUN ME HEQJEN E TAKSËS NGA KOSOVA



Serbia nuk do pranojë propozimet e kushtëzuara të Brukselit për vazhdimin e dialogut për eurointegrime, madje edhe nëse procesi ngrin për një periudhë të gjatë, shkruan e përditshmja e Beogradit. V.Novosti.
Ky, sipas kësaj gazete, është qëndrim i paluhatur i autoriteteve të Beogradit, ndërsa pas ofertës së padenjë që iu bë presidentit Aleksandar Vuçiq, të dërguar përmes kanaleve diplomatike, që të pranojë vazhdimin e dialogut me shqiptarët e Kosovës, madje edhe nëse Prishtina nuk e tërheq vendimin fatal për rritjen e taksës për produktet nga Serbia, ndërsa si shpërblim Serbisë do t'i hapeshin tre kapituj në negociatat për anëtarësim në BE, vazhdon shkrimi në këtë gazetë. Ministrja e ngarkuar për BE, Jadranka Joksimoviq i ka thënë "Novostit" se në implementimin e marrëveshjeve të Brukselit, që vendet anëtare të BE-së i marrin parasysh kur konstatojnë përparimin dhe numrin e kapitujve, Prishtina shihet qartë se jo vetëm nuk i zbaton me përgjegjësi, por me akte të njëanshme e minon jo vetëm dialogun, por edhe marrëdhëniet ekonomike të rajonit.
Sipas nënkryeministrit të Serbisë, Rasim Lajiq, këtu nuk bëhet fjalë vetëm se Prishtina nuk po zbaton marrëveshjet e arritura, por nga shkaqe politike shtron pengesa të reja në rrugën e tregtisë së lirë, që dëmtojnë të gjithë. "Veprimet e tilla vënë në pyetje gjithë dialogun dhe procesin e normalizimit të marrëdhënieve midis serbëve e shqiptarëve", ka thënë Lajiq.

(Novosti, 19 nëntor)

NËSE NUK E KËNI DITUR...

PASIONI PËR KAFENË ËSHTË I SHKRUAR NË ADN

Pasioni për kafen ose për çajin është i shkruar në ADN, ndonëse njeriu është i programuar që shijen e së hidhurës ta lidhë me një rrezik të mundshëm, disa gjene na bëjnë më të ndjeshëm ndaj kësaj shije dhe modifikojnë shijet tona për kafen, çajin dhe alkoolin, sipas një studimi të drejtuar nga instituti australian "QIMR Berghofer" dhe të publikuar në revistën "Scientific Reports". Studiuesit e drejtuar nga Jue Sheng Ong dhe Liang Dar Hwang, kanë analizuar më shumë se 400 000 gjenome të ruajtur në një prej bankave gjenetike më të mëdha të botës, britanikja "Biobank", në kërkim të llojeve të ADN-së të lidhura me perceptimin e substancave të ndryshme të hidhësisë si propiltiouracil ose Prop, që përdoret si ilaç kundër tiroideve, kinina, që ka veti kundër malaries, ul temperaturën dhe analgjezike, si dhe kafeina. Kjo analizë u bë për të parë efektet e ndryshme të perceptimit të të hidhësisë mbi konsumin e kafesë, çajit apo alkoolit. Në këto analiza hulumtuesit zbuluan se ndjeshmëria më e lartë ndaj hidhësisë së kafeinës, që shkaktohet nga prania e gjeneve specifike, lidhet me një konsum më të lartë të kafesë dhe me një probabilitet më të lartë për të qenë një person që e pëlqen shumë këtë pije.

VAZHDOJNË REAGIMET KUNDËR METODOLOGJISË PËR REGJISTRIMIN E POPULLATËS

IDE "KREATIVE" PREJ NJË BUDALLAI

Modeli i Regjistrimit i paralajmëruar nga Enti Statistikor shtron dilema të shumta lidhur me përkatësinë etnike që i takojnë një etnikumi tjetër, por që flasin gjuhën maqedonishte. Me këtë, thonë ekspertë, synohet që më shumë se 215 mijë qytetarë jomaqedonas, por që flasin maqedonisht, të përvetësohen si popullatë maqedonase dhe me këtë, të ulet dukshëm numri i popullsisë shqiptare

Koha — Zejnulla VESELI

Shkup, 19 nëntor - Unë jam shqiptarë, ndërsa në familjen time komunikojmë në maqedonisht, por ky fakt nuk mund të më detyrojë të heq dorë nga përkatësia etnike. Shqiptar kam lindur dhe shqiptar do të vdes, pavarësisht se nuk e flas gjuhën time amtare. Kështu shprehet Xhabir Deralla, kryetari i Qendrës për Liri "Civil", pas paralajmërimeve se Regjistrimi i popullsisë në Maqedoni i paralajmëruar të të realizohet në vitin 2020, planifikohet të ketë një kombinim metodash: do të shfrytëzohen të dhënat në terren, ato në regjistër dhe në këtë regjistrim nuk do të ketë numërim të popullsisë sipas përkatësisë etnike, por do të regjistrohen sipas gjuhës të cilën e flasin qytetarët.

"Është budallallëku i radhës që mund të ndodhë pas shumë budallallëqeve që kanë ndodhur deri më sot në Maqedoni. Të mos ketë grafë për përkatësi etnike në formularin e Regjistrimit të popullsisë, është një absurd i radhës dhe assesi nuk guxon një Regjistrimi i këtillë të realizohet në Maqedoni. Vlerësojë se ky është një vendim i gabuar", thotë Deralla. Në të gjitha Regjistrimet e popullsisë, si në ish-Jugosllavi dhe nga Pavarësia e Maqedonisë, thotë Derralla, në Regjistrime është deklaruar etniteti shqiptar dhe nuk ka logjikë që tani të mos ketë grafë për përkatësinë etnike. "Në të gjitha regjistrimet jam deklaruar se i përkasë etnikumit shqiptarë dhe mendoj se nuk është në rregull tani të ngritët çështja se, nëse fletë gjuhën shqipe - je shqiptarë. Ja që unë gjuhë komunikimi e kam maqedonishten, por kjo nuk mund të fsheh identitetit tim të vërtetë. Kushtu që, shqiptarë mund të jenë edhe ata që flasin gjuhë tjetër nga shqipja. Qëllimet megjithatë janë të mira. Por, sikur mos të shfrytëzohet ky fakt për uljen e numrit të shqiptarëve që janë qytetarë rezident në Maqedoni, gjithçka mirë do ishte. Në parim, mos figurimi grafës për përkatësi etnikë në formularin për Regjistrim të popullatë është një hap i gabuar", thotë Xhabir Deralla, kryetar i Qendrës për Liri "Civil".

Edhe Ljupço Zikov, pronar i magazinës javore "Kapital", është i mendimit se fshirja e grafës për përkatësinë etnike në formularin e Regjistrimit të popullsisë në vitin 2020 si qytetarë e ka vendosur në një akt të kryer dhe se është i detyruar të deklarohet për gjuhën që e flet e jo përkatësinë etnike vlleh që ai ka. "Besoj se në fund sërish në formularin e Regjistrimit do të mbetet grafa për përkatësinë etnike dhe ky Ligj s'ka mundësi të kalojë. Kemi të bëjmë më një kreativitet budallallëku të disa njerëzve që nuk ka idenë se çfarë flasin. Me siguri se njerëzit të cilët kanë funksione shtetërore mendojnë se atë çka thonë, duhet edhe patjetër ta pranojnë të tjerët. Thjeshtë, një budallai i duket si ide kreativiteti dhe del e thotë në opinion", thotë Zikov.

Akademiku Izet Zeqiri ndërkohë vlerëson se modeli i ri i Regjistrimit të popullsisë që proklamohet pa përcaktim etnik, por me përcaktim të gjuhës që flasin, natyrisht se do ti favorizojë maqedonasit, ngase mund të rrisin përqindjen me një numër të torbeshëve, ndoshta edhe të turqve, boshnjakëve, vllahëve e serbëve. "Këtu bisedohet për një popullatë prej 215.483 vetave në bazë të regjistrimit të vitit 2002, që nuk janë maqedonas e as shqiptarë, por etni tjera të cilët mundet të përvetësohen për rritjen e etnikumit që e flasin gjuhën maqedonase.

SI DO TË REGJISTROHEN PAKICAT QË FLASIN MAQEDONISHT?

Modelin e regjistrimit që parasheh Enti Statistikor i Maqedonisë (ESM) të paralajmëruar për në vitin 2020, shtron shumë dilema lidhur me përkatësinë etnike që i takojnë një etnikumi tjetër, por flasin gjuhën maqedonishte. "Në Maqedoni ka 77959 turq, të cilët deri tash kanë qenë të regjistruar sipas përkatësisë etnike. Me modelin e ri, si do regjistrohen 8595 turq në Shkup, 2597 në Dollnen, 2684 në Dibër, në Kërçovë 2430, në Mavrovë dhe Rostushë 2680, në Shtip 1272... Sipas Regjistrimit të fundit, në Maqedoni ka 53.879 rom edhe atë në qytetet si Shkupi me 23.475, Manastiri me 2613, në Dibër 1080, në Kërçovë 1630, Kumanova me 4256, Shtipi me 2159 rom..., të cilët duhet të paracaktohen për gjuhën që e flasin", thotë Zeqiri dhe pyet se si do të regjistrohen vllehët, të cilët janë 9659 në Shkup, Manastir, Krushevë, Shtip... Apo si do të regjistrohen serbët, të cilët në Maqedoni janë 35.939 apo si do të regjistrohen 17.018 boshnjak?", pyet akademik Izet Zeqiri.

Ndërkaq Abaz Islami, ekspert i demografisë, thotë se në mënyrë kategorikisht duhet të hidhet poshtë propozimi i drejtorit të ESHS-së që numërimi i popullatës të bëhet sipas gjuhës që falsin. "Të numërohemi sipas përbërjes etnik që ka Maqedonia. Në vitin 1994, me shtimin natyror 20 promila, në Maqedoni kanë jetuar 788.640 shqiptarë ose 35 për qind e popullsisë se përgjithshme të Maqedonisë. Sipas regjistrimit te vitit 2001-2002, në Maqedoni kanë jetuar 509.038 shqiptarë që nuk është aspak reale, pasi nga viti 1991 e deri në vitin 2002 me shtimin natyror prej 18 promilash, numri i shqiptarëve ka arrit në 802.296 shqiptarë ose 35 për qind e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Maqedoni", thotë Abaz Islami, ekspert i demografisë.

PARTITË SHQIPTARE KUNDËR

Megjithatë, përfaqësuesit e politikës shqiptare kundërshtojnë ashpër propozimin e drejtorit të Entit për Statistikë, që në pyetësorin e Regjistrimit të popullsisë të mos figurojë grafa e përkatësisë etnike dhe religjionit.

"Këto lloje tendenca fshehin brenda përbrenda vetes edhe qëllime tjera të cilat kanë për qëllim të godasin mbi balancimet etnike dhe mbi formën se si duhet organizuar dhe si duhet të funksionojë Maqedonia. Natyrisht që paralajmërimet që në grafën e regjistrimit do të ekzistojë vetëm gjuha ka për qëllim që në mënyrë artificiale të rritet numri i popullsisë e cila flet në gjuhën maqedonase në mënyrë që të fshihet realiteti demografik të cilën e ka Maqedonia", deklaroi ditë më parë Ziadin Sela, kryetar i Aleancës Shqiptarët. Edhe deputeti i Lëvizjes BESA, Fadil Zendeli është kundër fshirjes së gafës për përkatësinë etnike në formularin e regjistrimit sepse kjo ide krijon shumë element dyshuese. "Shqiptarët e Maqedonisë tash duhet të heqin dorë nga elementi etnik a elementin etnik e kemi në kushtetutë, e kemi në ligjet pozitive të vendit", thotë Fadil Zendeli nga Lëvizja BESA. Edhe nga BDI-ja, partia në pushtet, shprehen se identiteti gjuhësor jo gjithmonë mbulon identitetin etnik.

"Jemi të vetëdijshëm se procesi i regjistrimit të popullsisë është gjithmonë paksa jo vetëm proces statistikor në Maqedoni por edhe proces politik për arsye të ndryshimeve kushtetuese dhe Marrëveshjes paqësore të Ohrit e cila përcakton të drejtat e komuniteteve në Maqedoni me përqindje, përdorimi i gjuhës dhe përdorimi i flamujve të komuniteteve në këtë vend", tha Artan Grubi. Edhe BESA e Afrim Gashit është kundër kësaj ideje të ESM-së për shkak se identiteti gjuhësor jo gjithmonë e mbulon edhe identitetin etnik. "Ka plot njerëz që për arsye të ndryshme flasin një ose disa gjuhë por kanë vetëm një përkatësi etnike. Prandaj, mendoj që identiteti gjuhësor jo gjithnjë e mbulon edhe atë etnik. Fjala bie në Amerikë, njerëzit flasin anglisht por nuk e mbajnë veten për anglezë", thotë Orhan Mutezani, nga BESA e Afrim Gashit.



XHABIR DERALLA

Në të gjitha regjistrimet jam deklaruar se i përkasë etnikumit shqiptarë dhe mendoj se nuk është në rregull tani të ngritët çështja se, nëse fletë gjuhën shqipe - je shqiptarë. Ja që unë gjuhë komunikimi e kam maqedonishten, por kjo nuk mund të fsheh identitetit tim të vërtetë. Kushtu që, shqiptarë mund të jenë edhe ata që flasin gjuhë tjetër nga shqipja

LJUPÇO ZIKOV

Besoj se në fund sërish në formularin e Regjistrimit do të mbetet grafa për përkatësinë etnike dhe ky Ligj s'ka mundësi të kalojë. Kemi të bëjmë më një kreativitet budallallëku të disa njerëzve që nuk ka idenë se çfarë flasin. Me siguri se njerëzit të cilët kanë funksione shtetërore mendojnë se atë çka thonë, duhet edhe patjetër ta pranojnë të tjerët. Thjeshtë, një budallai i duket si ide kreativiteti dhe del e thotë në opinion

TREGU I PUNËS ME DISBALANS TË MADH

NUK PUNON KUSH PËR 200 EURO!

"Nuk mund të prisni që një i ri të regjistrojë shkollën e mesme profesionale e që nesër të punojë për 12 apo 15 mijë denarë. Kjo është absurd i kohës, pasi paga është faktori që i motivon të rinjtë të ikin prej shkollave të mesme profesionale, apo i demotivon të regjistrohen në këto shkolla. Duhet të kuptohet se kaloi koha e pagave të ulëta në Maqedoni", thotë Nenadiq

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup 19 nëntor - Maqedonia duhet më shumë të angazhohet për kuadër profesional që aktualisht i mungon bizneseve siç janë muratorët apo saldatorët. Në këtë drejtim, përveç rritjes së pagave për zanatlinjtë e profileve të ndryshme, nevojitet të intervenohet më seriozisht edhe në sistemin e arsimit të mesëm, por edhe të lartë për të krijuar një balans midis kuadrove tepricë që i refuzon tregu i punës dhe kuadrove më se të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të punës në kompanitë e ndryshme, e që nuk dalin nga shkollat e mesme profesionale.

Shteti duhet të angazhohet më shumë për të ofruar kuadro në tregun e punës që kërkohen nga ana e punëdhënësve. Në këtë drejtim nevojitet të rritet cilësia e arsimit formal, ndërsa arsimi joformal duhet të ofrojë adaptim më të madh ndaj kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, thonë nga Oda Ekonomike e Maqedonisë.

"Përfundimi i fakultetit në Maqedoni akoma është më atraktiv në raport me shkollat mesme profesionale, përkundër faktit se kompanitë ofrojnë paga solide për personat që përfundojnë shkollën e mesme profesionale. "Sistemi shtetëror i arsimit është strukturë përafërsisht rigide, e cila nuk mund të ndryshohet konform dinamikët së tregut dhe nuk mundet për një kohë të shkurtër t'u përgjigjet nevojave të tregut. Presim që cilësia e tij të përmirësohet, ndërsa joformalisht arsimi të mundësojë për një kohë të shkurtër kuadër të nevojshëm për kualifikimit dhe rikualifikimit", thotë Boris Trimçev nga Oda Ekonomike e Maqedonisë.

Sipas tij, tek ne akoma bëhen përpjekje për vendosjen e sistemit të arsimit dual nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër - jemi të vonuar në këtë proces për shkak se në Evropë tashmë po vendoset sistemi trepalësh i shkollës, apo krahas shkollave dhe kompanive në të janë të përfshirë edhe shkathtësitë digjitale.

Analizat e ndryshme tregojnë se shumica e fuqisë së aftë për punë në Maqedoni është me arsim të mesëm të përfunduar, ndërsa nga ana tjetër mungojnë më shumë profile të kuadrove me arsim të mesëm profesional si saldator, murator, punëtorë qelqi, vozitës profesionist, gdhendës të metalit etj. Njohësit e tregut të punës thonë se këto profesione në një pjesë të madhe, edhe pse deficitare, nuk paguhen mjaftueshëm.

Sipas drejtorit të agjencisë për punë të përkohshme "Partner", Rade Nenadiq, duhet të mendohet edhe për uljen e numrit të nxënësve që përfundojnë shkollat e mesme me zvogëlimin e numrit të nxënësve që pranohen, apo duke vendosur një pjesë të tyre edhe në pushim të përkohshëm.

Njëherazi duhet të mendohet edhe për uljen e numrit të studentëve në një pjesë të fakulteteve në shtet që do të mundësojë gradualisht barazimin e kërkesës dhe nevojave në tregun e punës.

"Nuk mund të prisni që një i ri të regjistrojë shkollën e mesme profesionale e që nesër të punojë për 12 apo 15 mijë denarë. Kjo është absurd i kohës, pasi paga është faktori që i motivon të rinjtë të ikin prej shkollave të mesme profesionale, apo i demotivon të regjistrohen në këto shkolla. Duhet të kuptohet se kaloi koha e pagave të ulëta në Maqedoni. Për shembull, tek tekstili nevojitet që pronarët të heqin dorë nga një pjesë e fitimit, për shkak se nuk është e vërtetë se nuk mund të rriten pagat në këtë sektor", thotë Nenadiq.

Kohë më parë, Qeveria paralajmëroi se ulja e papunësisë dhe krijimi i kuadrit të nevojshëm do të zgjidhet edhe përmes Ligjit të ri për praktikë që do të mundësojë që, me kompensim përkatës, personat deri në 29 vjet të kryejnë praktikën legale në kompani të ndryshme. Në këtë drejtim do të ndihmojë edhe Regjistri komunal për personat e papunë dhe për vendet e lira të punës në favor të rikualifikimit të kuadrit. Parashikohet që personat që do të angazhohen për praktikë - për periudhën prej 1 deri 6 muaj, edhe të paguhen. Kjo me qëllim që të ndërpritet praktika e deritanishme kur shpesh edhe nuk paguhej praktikuesi. Kompanitë për praktikën deri në 3 muaj do të paguajnë nga 5000 denarë, ndërsa ato që do të mbesin në punë praktike më shumë se 3 muaj, do të fitojnë kompensim të vlefshëm sa paga minimale.

Të ruhet kursi i progresit mes dy vendeve

Shkup, 19 nëntor - Zëvendëskryetari i Qeverisë së Maqedonisë për çështje evropiane, Bujar Osmani, ka takuar dje ambasadorin e sapoemëruar të Kosovës në vend, Gjergj Dedaj. "Kemi një numër të projekteve të përbashkëta të cilat realizohen, siç është pika kufitare 'Bellanoc-Stançiq', si dhe një numër i projekteve të tjera nga programi për bashkëpunim ndërkufitar që janë duke u zhvilluar ose janë në pritje të realizimit, për suksesin e të cilave besoj se do të përkushtohemi bashkarisht", theksoi zëvendëskryetari I Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani Në takim u diskutuan edhe temat e progresit të dy vendeve në kuadër të integrimit evropian, si dhe progresi i përgjithshëm i rajonit në aspektin e perspektivave evropiane. "Parlamenti dha dritën e pareë të gjelbër për ndryshimet kushtetuese në përputhje me Marrëveshjen e Prespës, me të cilën jo vetëm që u hap rruga për implementimin e detyrimeve sipas marrëveshjes, por gjithashtu krijoi kushte për përshpejtimin e procesit reformues të vendit", theksoi Osmani. Duke potencuar suksesin e Marrëveshjes së Prespës, por edhe më herët Marrëveshjen e fqinjësisë së mirë me Bullgarinë, si nxitje edhe për vendet tjera në rajon, për të bërë përpjekje dhe më shumë guxim në tejkalimin e mosmarrëveshjeve të ndërsjella si një interes i përbashkët i të gjithë rajonit. Në vazhdim, të dy bashkëbiseduesit ranë dakord se do të vazhdojnë të punojnë me përkushtim në drejtim të promovimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, në mënyrë që të mbështesin njëratjetrën në integrimet evropiane euroatlantike.

MINISTRIA E DREJTËSISË PËR EKSTRADIMIN E GRUEVSKIT

SHPRESA PËR EKSTRADIM TE KONVENTA EVROPIANE

Shkup, 19 nëntor - Ministria e Drejtësisë me përshpejtim punon në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për ekstradimin e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, por nuk potencojnë se kur saktë do të përfundojë dhe dërgohet në Budapest. Thonë se për shkak të ndjeshmërisë së materialeve, tani për tani nuk mund të japin më shumë informata. Nga kjo ministri theksojnë se ka bazë juridike Maqedonia të kërkojë ekstradimin nga Hungaria për Gruevskin, ndërsa ajo është Konventa Evropiane për ekstradim dhe Ligji për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjen penale. Gruevski, pas arratisjes e cila vijoi prejse duhej të paraqitet në vuajtjen e dënimit me burg prej dy vitesh për furnizimin e "mercedesit luksoz" qeveritar, kërkoi azil politik në Hungari. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Maqedonisë ishin hapur dy hetime. Me to duhet të konfirmohet se si ka ikur Gruevski dhe a i ka ndihmuar dikush nga policia, pas së cilës pritet MPB të dalë me detaje.

Deri tani, MPB-ja e Maqedonisë dhe Prokuroria nuk kanë dalë me informata zyrtare për arratisjen dhe lëvizjen e Gruevskit dhe për atë se ku janë lëshimet në tërë rastin. Ajo që deri tani dihet për rutën nëpër të cilën ka qarkulluar Gruevski, ndërsa për çka konfirmim arriti nga policia shqiptare, është se ai ka qenë në territorin shqiptar dhe prej atje përmes vendkalimit Han Hoti është nisur drejt Malit të Zi. Zëdhënësi i policisë shqiptare deklaroi ditë më parë se Gruevski në Shqipëri pa dyshim ka hyrë në këmbë, sepse hyrja e tij nuk është regjistruar në asnjë vendkalim kufitar mes Maqedonisë dhe Shqipërisë. Nga Shqipëria ka hyrë në Mal të Zi prej ku, sipas mediave të cilat referohen në burime diplomatike, ka hyrë në Serbi përmes vendkalimit kufitar Dobrakovo, ndërsa prej atje ka shkuar në Hungari.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjen penale në dhjetor të vitit 2013 si risi është vendosur procedurë e shkurtuar për ekstradim, e cila i jep mundësi personit të kërkuar të pajtohet për t'u dorëzuar në organet gjyqësore të vendit të tij, pa u zbatuar procedurë formale për ekstradim. Në këtë procedurë afatet për ndërmarrje janë shumë të shkurtra dhe afati e përcakton shtetin në të cilin personi është arrestuar. Nga praktika e deritanishme afati për ndërmarrje gjatë procedurës së shkurtuar lëviz prej një deri 2 muaj, por ka edhe raste kur mundet procedura e shkurtuar të realizohet edhe në afat më të shkurtër prej 30 ditësh. (O.Xh)

Stuhia e të ftohtit mbërthen Ballkanin

Zagreb, 19 nëntor - Stuhia e të ftohtit arriti në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përderisa në Kroaci ra borë, në Federatën BeH është shpallur alarm i kuq për shkak të reshjeve të paralajmëruara, në Mavrovë të Maqedonisë trashësia e borës arriti 25 centimetra. Në Bosnje dhe Hercegovinë pritet mot kryesisht i vranët, ndërsa në Federatën BeH është paralajmëruar alarm i kuq për shkak të reshjeve më të mëdha për rajonin e Hercegovinës dhe Bosnjës jugperëndimore.
Sasia e akumuluar e reshjeve e cila prognozohet lëviz ndërmjet 40 dhe 80 litra për një metër katror, ndërsa në Hercegovinë edhe deri 120 litra. Reshje priten edhe prej mbrëmjes së sotme dhe gjatë natës drejtë të martës. Borë pritet që të bjerë në zonën e Krahinës dhe Bosnjës Perëndimore dhe në malet në zonat qendrore të Bosnjës. Borë ra edhe në Kroaci, ndërsa ende bie në shumë zona të pjesës qendrore të vendit dhe në Gorski Kotar.
Borë do të ketë edhe më tutje në male ku pritet formimi i mbulesës së borës. Në zonat më të ulëta do të dominojë shiu. Shiu në tokë do të ngrihet dhe do të krijojë rrezik, prandaj iu bëhet thirrje shoferëve që të jenë të kujdesshëm. Krahas reshjeve fryn edhe erë nga drejtimi verior, në Adriatik stuhi, veçanërisht në Velebit, gjë që e përkeqëson komunikacionin. Borë në disa pjesë të Kroacisë është paralajmëruar edhe për nesër, ndërsa nga e mërkura paralajmërohet mot më i ngrohtë me shi. Më së shumti borë në 24 orët e fundit ka rënë në Mavrovë të Maqedonisë ku trashësia e borës arriti deri në 25 centimetra.

DËSHMI TË REJA PËR VRASJEN E PESËFISHTË NË SMILKOVË

EKSPERTIZË GJYSMAKE PËR "MONSTRËN"

Avokati Raufi tha dje se Prokuroria Speciale Publike është dashur që prej në fillim ti prezentojë dështmitë e veta që i ka për këtë lëndë. Ripërsëritja e seancave gjyqësore për ngjarjet e Smilkovës të vitit 2012, për palën mbrojtëse të të akuzuarve, ndonëse është një rutinë, në këtë proces megjithatë po burojnë elemente të reja që e vërtetojnë tezën se bëhet fjalë për një rast të montuar

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 19 nëntor - Inxhinierët e informatikës të Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk kanë pasur urdhër të analizojnë intervalin kohor të bisedave që të akuzuarit në rastin "Monstra" i kanë realizuar gjatë shfrytëzimit të internetit, e-mail adresave dhe bisedave të ndryshme online. Shefja e Sektorit për forenzikë digjitale në MPB, Katerina Jovanovska, të premten, para Këshillit Penal në Gjykatën Themelore Shkupi 1 tha se më 1 maj të vitit 2012, janë urdhëruar të bëjnë ekspertizën e të dhënave nga kompjuterët e konfiskuar të të dyshuarve për kryerje ne vrasjes së pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës. Me urdhëresë gjyqësore, siç tha ajo, nga krim-teknika e policisë së shtetit, është kërkuar që të zbulohen lidhjet e të dyshuarve për vepër terrorizëm. Mirëpo, pas reagimit të palës mbrojtëse të të akuzuarve për rastin "Monstra", Jovanovska tha se nga ato nuk është kërkuar që të konstatojnë kohën se kur janë zhvilluar bisedat në fjalë.

"Jo, ne nuk e kemi pasur atë detyrë për ta kryer. Ne kemi vepruar në bazë të urdhëresës gjyqësore, e cila ka kërkuar vërtetimin e të dhënave nga dosjet kompjuterike dhe bisedat nëpërmjet internetit për veprën penale 'terrorizëm'. Sigurisht se me një analizë shtesë të atyre të dhënave mund të zbulohet se kur janë zhvilluar ato bisedat, përmbajtja e të cilave i është dhënë prokurorisë dhe gjykatës", tha Jovanovska.

Avokati Naser Raufi, duke folur për rrjedhën e këtij procesi, tha se Prokuroria Speciale Publike është dashur që prej në fillim ti prezentojë dështmitë e veta që i ka për këtë lëndë. Ripërsëritja e seancave gjyqësore për ngjarjet e Smilkovës të vitit 2012, për palën mbrojtëse të të akuzuarve, ndonëse është një rutinë, në këtë proces megjithatë po burojnë elemente të reja që e vërtetojnë tezën se bëhet fjalë për një rast të montuar.

"Prokuroria Speciale ende në seancë gjyqësore nuk e ka argumentuar faktin se pse e ka marrë përsipër këtë lëndë. Ne kemi shpresuar se ajo do të veprojnë në kohë dhe për këtë arsye, nuk kemi kërkuar prezantimin e provave që i posedon për këtë lëndë. Deri tash janë përsëritur provat e vjetra në rastin 'Monstra', por që kanë zbuluar elemente të reja. Kështu që, në këtë seancë u vërtetua se Prokuroria për krim të organizuar nuk ka kërkuar nga personat ekspert të konfirmojnë se kur janë detektuar bisedat kompjuterike mes të palëve. Ky është një lëshim krucial dhe besojmë që në rrjedhën e mëtutjeshme, ekspertët e MPB-së do të tregojnë se në çfarë kohe janë realizuar ato biseda", tha avokati Raufi.

Ndryshe, deri më tani, nga fillimi i rigjykimit të lëndës për "Monstrën", në Gjykatën Penale të Shkupit janë prezantuar një varg dështmitarësh, kryesisht të propozuar nga PSP. Gjatë rrëfimeve të tyre, ato edhe pse i përsëritnin deklaratat e mëhershme, mes rreshtat tregonin edhe diçka të re, siç ishte rasti me përfshirjen e një pjesëtari të njësitit "ALFA", në transportimin e dështmitarëve të komunitetit rom për në stacionin policor në Autokomandë, detal ky i pathënë deri më tash. Përveç këtij pjesëtari të MPB-së, emër tjetër i strukturave të larta policore që u përmend ishte ai i ish-shefit të Byrosë për Siguri Publike, Lupço Todorovski, të cilën Haki Aziri e apostrofoi si personin që e kishte marrë në pyetje dhe që i kishte kryer presion.

Shkup, 43 aksidente për 24 orë

Shkup, 19 nëntor - Tre persona kanë marrë lëndime të rënda trupore në tre nga gjithsej 43 aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve të kaluara në Qytetin e Shkupit. Në 22 aksidente lëndime më të lehta kanë marrë 41 persona, ndërsa në 18 është shkaktuar dëm material. Sipas raportit policor, këtë fundjavë policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar numër të madh kundërvajtjesh. Njëqind e katër shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, tetë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, dy shoferë kanë kaluar në udhëkryq, dy shoferë për mosdhënie të lejes për parakalim të këmbësorëve dhe dy shoferë për rreshtim jo të rregullt. Nga trafiku janë përjashtuar gjithsej 63 shoferi, 31 nga të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 26 para se të pajisen me të drejtën e drejtimit të automjetit dhe gjashtë shoferë fillestarë, si dhe dy automjete teknikisht jo të rregullta dhe 24 automjete të paregjistruara. Janë hasur 182 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 110 vetura. *(O.Xh)*

Kontrolle të rrepta në rrugët e Gostivarit

Gostivar, 19 nëntor - Në fillimin e vikendit që kaloi, në qytetin e Gostivarit, është realizuar kontroll aksion në trafikun rrugor, në të cilën janë përfshirë 47 vetura. Gjatë kontrollit, tek 11 vetura janë konstatuar parregullsi në pajisjet e frenimit, një veturë ka pasur të parregullta pajisjet e drejtimit të automjetit, një veturë ka qenë me parregullsi në pajisjet e sinjalizuese dhe ndriçuese, si dhe katër vetura kanë qarkulluar në trafik me regjistrim të skaduar. Veturat tek të cilat janë konstatuar parregullsi, janë shkyçur nga trafiku, 22 shoferëve u janë përgatitur fletëpagesa për kundërvajtje, si dhe katër kërkesa për vazhdimin e procedurës për kundërvajtje.

Gjatë kontrollit, gjithashtu janë konstatuar edhe tetë lloje tjera të kundërvajtjeve, të cilat janë sanksionuar në mënyrë adekuate. Aktivitete të përforcuara në rajonin e Gostivarit janë planifikuar edhe gjatë ditëve në vijim, ku theks të veçantë do të përqendrohet në parkimin e veturave, para së gjithash në rrugët "Vëllezërit Gjinovski", "Ilindenska", "JNA" dhe rrugën "Zhivko Brajkovski". Gjatë kësaj do të sanksionohen të gjithë veturat gabim të parkuara, nëpër trotuare, udhëkryqe, vendkalime për këmbësorët, të cilët pengojnë qarkullimin e lirshëm dhe të sigurt të këmbësorëve, si dhe të pjesëmarrësve tjerë në trafik. Aktivitetet, thonë në polici, do të realizohen si gjatë ditës, po ashtu edhe gjatë orëve të vona të natës, kur edhe më së shpeshti haset lloj i këtillë i kundërvajtjeve.

"Kjo, më së shumti nga shkaku se pason një periudhë me të reshura të borës, ku veturat gabim të parkuara, në masë të madhe pengojnë dhe rëndojnë pastrimin dhe largimin e borës nga rrugët, dhe trotuaret nëpër qytet. Për këtë shkak, apelojmë deri tek shoferët të mos i parkojnë veturat e tyre vend e pa vend, sepse do të sanksionohen me kundërvajtje adekuate, dhe të njëjtat vetura do të ngriten nga ana e merimangës", thotë zëdhënësi i SPB-së në Tetovë, Fatmir Rexhepi. *(U.H)*

MBËSHTETJE PËR BUXHETIN 2019

FMN KËMBËNGULË NË RRITJEN E MOSHËS PËR PENSIONIM

Me qëllim të qëndrueshmërisë afatgjate të sistemit pensional, sipas FMN-së, është e nevojshme të shqyrtohen masa shtesë si kushte perspektive për pensionim para kohe dhe rritje të moshës për pensionim

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 19 nëntor -Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili e mbajti takimin përfundimtar në Ministrinë e Financave, vlerëson se është e drejtë që Propozim-buxheti për vitin 2019 është fokusuar në qëndrueshmërinë e sistemit pensional, promovimin e barazisë sociale dhe mbështetjen e punësimit. FMN, siç theksohet në kumtesë, vlerëson se reformat e propozuara pensionale do ta ulin deficitin pensional në afat të mesëm. Sipas vlerësimeve preliminare të FMN-së, këto masa, së bashku me mbështetjen për punësim dhe investime, do të rezultojnë me rritje të përkohshme të deficitit fiskal në 3 për qind të BPV-së në vitin 2019 dhe më pas uljen e tij në 2.4 për qind të BPV në afat të mesëm.

Me qëllim të qëndrueshmërisë afatgjate të sistemit pensional, sipas FMN-së, është e nevojshme të shqyrtohen masa shtesë si kushte perspektive për pensionim para kohe dhe rritje të moshës për pensionim. FMN gjithashtu vlerëson se me qëllim të përmirësimit të mbulimit dhe targetimit të ndihmës sociale, buxheti parashikon konsolidim dhe zëvendësim të llojeve ekzistuese të ndihmës, duke e përfshirë edhe kompensimin për fëmijën e tretë, me të ardhura të garantuara minimale të bazuara në nevojat edhe me pensionin social. Më tej, sipas misionit, reformat e propozuara pensionale do ta ulin deficitin pensional në afat të mesëm. Misioni, qëndron në kumtesë, konsideron se ndryshimet në kompensimin e të ardhurave personave e rrisin tatimin mbi të ardhurat nga kapitali dhe e përmirësojnë baraspeshën e ngarkesës tatimore midis personave me të ardhura të larta dhe të ulëta.

FMN-ja rekomandon arritje zero deficit parimor në afat të mesëm me qëllim të arritjes së trajektores së qartë në rënie të borxhit publik. Për FMN-në inkurajuese janë dhe duhet të vazhdojnë reformat e fundit për përforcimin e menaxhimit me financat publike dhe përmirësimin e transparencës fiskale. Gjithashtu, theksohet se masat për përforcimin e kornizës për monitorimin e obligimeve të papaguara në sektorin publik dhe ndryshimet e propozuara që i lidhin buxhetet komunale me realizimin e të ardhurave janë hapa në drejtim të dukur. Sipas projeksionit bazë, borxhi publik do të arrijë maksimum 54.7 për qind nga Bruto Prodhimi Vendor në vitin 2021.

Në kumtesën përmbyllëse të ekipit të FMN-së theksohet se kthimi i stabilitetit politik dhe avancimi ndaj zgjidhjes së problemit me emrin dukshëm i kanë përmirësuar perspektivat për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE, më shumë se 12 vjet pas marrjes së statusit kandidat. Që të shfrytëzohet kjo mundësi dhe të sigurohet ardhmëri më e ndritur përmes produktivitetit më të lartë dhe konvergjencës më të shpejtë mbi të ardhurat, kyçe janë reformat strukturore për tejkalimin e dobësive gjatë-ekzistuese në tregun e punës, gjyqësinë dhe administratën publike.

BPV-ja reale në vitin 2018 është projektuar në dy për qind, gjatë kushteve të volitshme makroekonomike, gjegjësisht inflacionit të ulët, deficitit në rënie të llogarive rrjedhëse dhe trendet pozitive të tregut devizor. Me rimëkëmbjen e investimeve, pritet shpejtim i rritjes së BPV-së në 2,8 për qind në vitin 2019 dhe intensifikimin e mëtutjeshëm në 3,5 për qind në afat të mesëm, në kushte të investimeve infrastrukturore dhe eksportit të fuqishëm.

Sipas FMN-së, në dekadën e fundit janë dobësuar financat publike, që e kufizon hapësirën për përballje me goditjet. Më saktësisht, deficitet parimore ekzistuese, të zhvilluara nga të ardhurat tatimore në rënie dhe shpenzimet vijuese rritëse, rezultuan me borxh të ndarë publik në dekadën paraprake. Në vitin 2018, pritet se deficiti buxhetor do të arrijë 2,6 për qind nga BPV-ja, ndërsa borxhi publik 50.5 për qind nga BPV-ja. Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar ishte në kontroll vjetor të ekonomisë së Maqedonisë nga data 8 e këtij muaji. Qëllimi i vizitës u zbatua në kontrollin e rregullt vjetor të ekonomisë së Maqedonisë.

Në takimin përmbyllës në Ministrinë e Financave, mori pjesë ministri Dragan Tevdovski dhe guvernatorja e BPRM, Anita Angelovska-Bezhoska.

"Alibaba" e shmang Ballkanin

Pekin, 19 nëntor - Gjiganti kinez për tregti online "Alibaba" do të hap qendër logjistike në Belgjikë, me çka është evident qëllimi që ta evitojë Ballkanin. Qendra do të jetë në qytetin belg Liezh, në trekëndëshin e kufirit me Gjermaninë dhe Luksemburgun, ndërsa në afërsi është edhe Brukseli. Kjo është qendra e pesë logjistike të kësaj kompanie në botë. Në Evropë tashmë ka në Frankfurt. Tash për tash nuk ka hollësi pse është zgjedhur pikërisht Liezhi, por spekulohet se themeluesi i "Alibaba", Xhak Ma dhe mbreti belg kanë vendosur bashkëpunim të shkëlqyer pas forumit në Davos. Supozohet edhe se do të ketë ende investime të ngjashme në Evropë, ndërsa lobimi i shtetit për këtë biznes ka qenë aq i fuqishëm, që Holanda për shembull, kumtoi se e ka lëshuar shansin për shkak të aksionit të vonshëm diplomatik.

Shqipëria me karburantet më të shtrenjta në Evropë, Maqedonia e treta

Tiranë, 19 nëntor - Shqiptarëve në Shqipëri u duhen mesatarisht 10.3 për qind e të ardhurave ditore për të blerë një litër benzinë, duke e renditur në këtë mënyrë në shtetin evropian që ka karburantin më të shtrenjtë në Evropë, në raport me të ardhurat për frymë (pa përfshirë vendet e Ish Bashkimit Sovjetik).

Ndërsa në botë, Shqipëria renditet në vendin e 15, me vendet të tilla si Afganistani, Zambia, Haiti, Etiopia, Kamboxhia, Bangladeshi. Të dhënat janë përllogaritur nga agjencia e lajmeve Monitor, bazuar në të ardhurat për frymë të publikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Global Petrol Price për benzinën. Një litër benzinë në Shqipëri kushton 1.48 euro, ndërsa të ardhurat ditore për frymë janë 14 euro (ndër më të ulëtat në Evropë, bashkë me Kosovën). Pas Shqipërisë, në Evropë, nafta është më e shtrenjtë në vendet e rajonit, ku në Bosnjë duhen 7.6 për qind të të ardhurave ditore, në Maqedoni 7.2 për qind dhe në Bosnjë 7.1 për qind.

Teksa në vlerë absolute, benzina në Shqipëri është pak më e lirë se në vende të tjera të Evropës, si Francë, Portugali, Finlandë, Greqi, Holandë, Itali, në raport me të ardhurat për frymë ajo është shumë më e shtrenjtë. Në Francë, e cila prej disa ditësh është mbërthyer nga protesta masive për shtrenjtimin e çmimeve të naftës, qytetarëve të saj u duhen vetëm 1.3 për qind e të ardhurave ditore, pra 10 herë më pak se shqiptarëve. Italianëve u duhen 1.8 për qind e të ardhurave ditore, holandezëve 1.1 për qind, grekëve 2.9 për qind. Në botë, nafta më e shtrenjtë është në Afganistan dhe Zambia, ku banorëve u duhen përkatësisht 42 dhe 38 për qind e të ardhurave ditore për të blerë një litër karburant. Ndërsa më e lirë në botë është në Venezuelë, me vetëm 0.1 për qind. *(R.K)*

Më pak udhëtarë në transportin urban dhe ndërkombëtarë

Shkup, 19 nëntor - Më pak udhëtarë janë transportuar në komunikacionin rrugor në tremujorin e tretë të këtij viti, lidhur me të njëjtën periudhë vitin e kaluar. Sipas të dhënave të publikuara të Entit shtetëror për statistikë, ulja e numrit të përgjithshëm të udhëtarëve të transportuar është 0,1 për qind, por në mënyrë të ndarë më shumë se 13,4 për qind ka tek transporti ndërkombëtar, në transportin urban është ulur për 6,2 për qind, ndërsa rritje ka në transportin periferik për 8,5 për qind dhe në transportin ndërurban për 6,4 për qind. Lidhur me tremujorin e dytë të vitit 2018, numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është ulur për 18,4 për qind. Sipas llojit të transportit, numri i udhëtarëve të transportuar në transportin ndërkombëtar është rritur për 26,3 për qind, ndërsa në transportin urban është ulur për 19 për qind, në transportin periferik për 22,5 për qind, ndërsa në transportin ndërurban për 2,2 për qind. Në tremujorin e tretë të vitit 2018, lidhur me periudhën e njëjtë të vitit 2017, numri i përgjithshëm i kilometrave të udhëtarëve në transportin rrugor të udhëtarëve është rritur për 0,5 për qind. Sipas llojit të transportit, numri i kilometrave të udhëtarëve në transportin urban është ulur për 5,6 për qind, në transportin ndërkombëtar për 12,8 për qind, ndërsa në transportin periferik është rritur për 12,3 për qind, ndërsa në transportin ndërurban për 12,1 për qind. Lidhur me tremujorin e dytë të vitit 2018, numri i përgjithshëm i kilometrave të udhëtarëve është ulur për 2,2 për qind. Sipas llojit të transportit, numri i kilometrave të udhëtarëve në transportin urban është ulur për 31.6 për qind, në transportin periferik për 4,8 për qind, ndërsa në transportin ndërurban për 3,3 për qind, ndërsa në transportin ndërkombëtar është rritur për 28,1 për qind.

INSPEKTORATET QË LUFTOJNË KORRUPSIONIN

RROGA MË TË LARTA DHE PUNËSIME TË REJA

"Një nga propozimet në ligj është se duhet të parashikojmë rritje të rrogave sidomos për ata shërbime inspektuese që janë të ekspozuar në rrezik më të madh", tha Mançevski duke sqaruar se inspektorët kanë rroga të njëjta sikur edhe nëpunësit tjerë në administratë pa të drejtë rritjeje për rrezikun përkatës, të cilin e ndërmarrin gjatë punës

Koha — Qefsere ABDYLI

Shkup, 19 nëntor - Shërbime më efikase inspektuese pa rol represiv, por fillimisht me rol këshillëdhënës, punësim i inspektorëve të rinj dhe rritje e rrogave, me qëllim të uljes së korrupsionit në këtë veprimtari, paralajmëroi ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski në debatin e djeshëm publik për Propozim risitë e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

"Mbikëqyrja inspektuese duhet të ndërpret të jetë mekanizëm për mbushje të buxhetit, ai fillimisht duhet të ketë rol këshillëdhënës dhe edukativ, subjektet fillimisht të marrin paralajmërim dhe afat që t'i mënjanojnë parregullsitë para se të shqiptohet dënimi. Vetëm në këtë mënyrë inspeksioni nuk do të përjetohet si represion", deklaroi Mançevski. Analizat kanë treguar se nuk ka mjaftueshëm inspektorë, ndërsa procedura e ndërlikuar për marrjen e statusit të inspektorit ka kontribuar që ky profesion të jetë jo atraktiv. Shërbimet inspektuese janë të stërngarkuara me detyrime nga natyra administrative, punojnë në kushte mjaft të vështira dhe janë të ekspozuar në rrezik.

"Një nga propozimet në ligj është se duhet të parashikojmë rritje të rrogave sidomos për ata shërbime inspektuese që janë të ekspozuar në rrezik më të madh", tha Mançevski duke sqaruar se inspektorët kanë rroga të njëjta sikur edhe nëpunësit tjerë në administratë pa të drejtë rritjeje për rrezikun përkatës, të cilin e ndërmarrin gjatë punës. Siç informoi Magdalena Filipovska Grashoska, drejtoreshë e Këshillit inspektues, me ligjin thjeshtësohen kushtet për punësim të inspektorëve dhe për avancimet e tyre.

Ligji duhet të pësojë ndryshime, sipas asaj që është parashtruar në debatin publik dhe për shkak të kësaj që subjektet që janë lëndë e mbikëqyrjes nuk janë mjaftueshëm të njoftuar me të drejtat dhe detyrimet dhe janë të mbingarkuar me numër të madh mbikëqyrjesh. Me risitë vendoset koncept i ri i planifikimit me çka do të evitohen mbikëqyrjet e shpeshta ndaj subjekteve të njëjta në periudhë relativisht të shkurtër.

ARSIM MË CILËSOR FORMAL

Të rritet cilësia e arsimit formal, ndërsa ai joformal të mundësojë përshtatje më të shpejtë ndaj kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, apelon Oda Ekonomike e Maqedonisë. Siç u tha dje në konferencë për shtyp, mjekët dhe kuadrot profesionale të profesionit të ndërtimtarisë dhe të makinerisë ende janë më deficitarë. Sipas Boris Trimçevit të Odës, në Maqedoni mbarim i fakultetit ende është më atraktiv nga shkollat e mesme profesionale edhe pse kompanitë ofrojnë paga solide për personat me arsim të mesëm të mbaruar profesional. Edhe derisa te ne bëhen përpjekje për vendosjen e arsimit dual, në suaza evropiane, përmendi, tashmë promovohet i ashtuquajturi sistem trepalësh në arsim, ku përveç shkollave edhe kompanitë, janë të përfshira edhe atësitë digjitale. "Sistemi shtetëror i arsimit është strukturë përafërsisht rigide e cila nuk mund të ndryshohet konform dinamikët së tregut dhe nuk mundet për një kohë të shkurtër t'u përgjigjet nevojave të tregut. Presim që cilësia e tij të përmirësohet, ndërsa joformalisht arsimi të mundësojë për një kohë të shkurtër kuadër të nevojshëm për kualifikimit dhe rikualifikimit", theksoi Trimçev.

"Buxheti Qytetar" edhe në shqip

Shkup, 19 nëntor - Aplikacioni në internet i "Buxhetit Qytetar" (budget.finance.gov.mk) është i arritshëm në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Në këtë mënyrë, Ministria e Financave, Buxhetin e Maqedonisë dëshiron ta thjeshtësojë dhe afrojë te qytetarët. "Në ueb-aplikacionin janë treguar të ardhurat dhe shpenzimet në buxhet. Gjithashtu, aplikacioni dha edhe sqarime se çka paraqesin normat e ndara, që e bën të lehtë për shfrytëzim. Që të merret fotografi më e qartë, aplikacioni jep mundësi të bëhet krahasim mes buxheteve në vite të ndryshme. Qytetarët përmes grafikonëve mund të ndjekin se si të ardhurat ose shpenzimet e ndara kanë qarkulluar nëpër vite", qëndron në kumtesën e Ministrisë së Financave. Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, theksoi se në këtë mënyrë përmirësohet informimi i qytetarëve për Buxhetin e RM-së, ndërsa me atë edhe rritet kontrolli i tyre mbi menaxhimin me financat publike. "Buxheti qytetar i Maqedonisë është bindshëm më i mirë jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Ai i tregon qartë të ardhurat dhe shpenzimet në buxhet, si dhe mundësi të bëhet krahasim përmes kohës se sa ishin ato norma. Ka edhe paraqitje të qartë se sa pjesë kanë të ardhurat e ndara në buxhet. Në këtë mënyrë qytetarët marrin informata se ku kanë shkuar paratë shtetërore, ndërsa me atë kanë edhe kontroll më të madh mbi shpenzimin e tyre". potencoi ministri i Financave Dragan Tevdovski. Ueb-aplikacioni për "Buxhetin Qytetar" nuk ka të bëjë vetëm me një buxhet, por është platformë në të cilën edhe në të ardhmen mund të vendosen të dhëna nga buxhetet e reja.

Zero tolerancë për ndotjen e ajrit dhe rrezikim të jetës

Shkup, 19 nëntor - Shoqata për inovacione sociale dhe zhvillim të qëndrueshëm "RADAR", Gazetarë për të drejtat e njeriut, Ambasada e parë për fëmijë "Megjashi" dhe Instituti i gjelbër, me rastin e Ditës ndërkombëtare të tolerancës e ngritën peticionin "Zero tolerancë për ndotjen e ajrit dhe rrezikim të jetës", duke apeluar deri tek të gjithë qytetarët e Maqedonisë për ta nënshkruar. I bënë thirrje shtetit t'i plotësojë obligimet lidhur me respektimin e të drejtës bazë, të drejtës së jetës, duke vendosur masa urgjente për uljen e ndotjes e cila direkt ndikon në shëndetin e njerëzve dhe jetën e tyre.

Gordana Nestorovska, përfaqësuese e "RADAR" theksoi se buxheti i Qeverisë për vitin 2019 është ndarë 21,5 milionë euro, gjegjësisht 0,6 për qind për uljen e ndotjes së ajrit. Ajo kërkoi që Qeveria të jetë transparente në punën e saj dhe të paktën njëherë në javë t'i informojë qytetarët çka është ajo që konkretisht e ndërmerr për uljen e ndotjes së ajrit. "Subvencionimi i autobusëve ndërurbanë, transport falas me autobusë për të gjithë qytetarët gjatë tre muajve të ardhshëm, vendosje të mbikëqyrjes së përforcuar policore për 24 orë me radhë, pajisim i shërbimeve inspektuese me pajisje adekuate dhe detektim urgjent të ndotësve", propozoi ajo si masa urgjente për uljen e ndotjes së ajrit.

Dragi Zmijanac nga "Megjashi" e kualifikoi situatën me ndotjen e ajrit si alarmante, ekocide, të jashtëzakonshme, siç tha "horor". Theksoi se janë detyruar deri tek të gjithë anëtarët e Komitetit për të drejtat e fëmijëve të dorëzojnë letra protestuese, duke kërkuar nga ata të parashtrojnë masa konkrete dhe rekomandime deri tek Republika e Maqedonisë.Natasha Amdiju nga Instituti i gjelbër, apeloi deri tek Ndërmarrja publike transportuese, që ta rritë numrin e linjave me autobusë, veçanërisht në disa pika ku tani për tani nuk ekzistojnë, duke konstatuar se për këto arsye shumë qytetarë shfrytëzojnë automobila. *(Q.A)*

RIKTHEHET NGORDHJA ENIGMATIKE NË RRUGËT E QYTETIT

KUSH I HELMON QENTË NË TETOVË?

Në Policinë e Tetovës theksojnë se muajve të fundit nuk është denoncuar asnjë rast me helmim të kafshëve në Tetovë, megjithëse nëpër rrugë vërehen qen të ngordhur

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 19 nëntor - Gjatë ditëve të kaluara, në Tetovë janë hasur qen endacak të helmuar. Kjo dukuri tashmë po përsëritet pas një periudhe katërvjeçare, kur kishte helmime masive të qenve endacak në rrugët e Tetovës. Edhe pse kanë kaluar disa ditë nga helmimi masiv i qenve endacak, megjithatë deri më tani nuk është zbuluar se kush qëndron prapa këtij akti. Kjo është hera e tretë që brenda katër viteve ndodh një helmim i qenve endacak, të cilët kohëve të fundit kishin "okupuar" rrugët kryesore dhe perfierike të qytetit të Tetovës, por ende nuk është zbuluar se kush e kryen një akt të këtillë. Në Qendrën për Shëndet Publik nuk ka denoncim të këtillë se ka të ngordhur apo helmuar qen endacak.

"Unë mund të them se nëse në vendin e përmendur qentë kanë shkumë në gojë dhe nuk kanë shenja dhune. Kjo dëshmon se bëhet fjalë për helmim klasik. Vetëm mund të them se është shumë rrezik nëse ata qëndrojnë në atë vend në atë gjendje, sepse mundësia e përhapjes së epidemisë është e pashmangshme", thotë Ratko Davidovski, mjek në Qendrën për Shëndet Publik. Ai fton institucionet që sa më shpejtë të intervenojnë në këtë drejtim.

"Vetë fakti që kafshët kanë ngordhur dhe qëndrojnë aty, është një rrezik për banorët, sidomos për fëmijët. Ata duhet që të groposen, ndërsa po ashtu duhet të bëhen analiza se si ka ardhur deri kjo situatë. Nga qentë e ngordhur shumë lehtë krijohen parazite helmuese, prandaj duhet që të njëjtit të largohen", thotë Davidovski. Ai thekson se helmimi i kafshëve është i ndaluar me ligj dhe duhet sa më shpejtë të merren masa në këtë drejtim. Në Policinë e Tetovës theksojnë se muajve të fundit nuk është denoncuar asnjë rast me helmim të kafshëve në Tetovë, megjithëse nëpër rrugë vërehen qen të ngordhur. Nga ana tjetër, në ndërmarrjen publike komunale në Tetovë thonë se ka patur lajmërime për qen të ngordhur, të cilët janë marrë dhe transportuar dhe me kaq, përfundon edhe puna e tyre.

Dënimet për groposje joadekuate të kafshëve në pajtim me Ligjin për kafshët arrijnë prej 3000 deri në 5000 euro për personin fizik dhe dënimi shtesë prej 1000 deri në 3000 për personin përgjegjës. Sipas njohësve të këtyre rrethanave, helmimi është i ndaluar me të gjitha konventat ndërkombëtare për mbrojtje të kafshëve, konventë kjo nënshkruar edhe nga Maqedonia. Edhe shumë organizata që merren me mbrojtjen e kafshëve kanë reaguar në forma të ndryshme, duke apeluar që të zbulohen fajtorët dhe të dënohen, kurse autoritetet përgjegjëse të merren më seriozisht me këtë problem. Arianit Xhaferi nga "Eco Guerilla" e dënon këtë akt dhe thotë se helmimi i qenve nuk është zgjidhje. "Helmimi i qenve endacak nuk është zgjidhje, as njerëzore. Një sjellje e tillë, nga kushdo që të jetë bërë, është e papranueshme për shekullin në të cilin jetojmë. Qentë endacakë duhet të grumbullohen nga rrugët, të dërgohen nëpër strehimore të posaçme të ndërtuara për kujdesin e tyre. Helmimi i qenve, ngordhja e tyre nëpër rrugë dhe me gjasë era e keqe që vjen nga trupi i tyre, mund të shkaktojë epidemi të tjera nëse nuk ndërhyhet shpejtë për mënjanimin e qenve të helmuar dhe të ngordhur nëpër rrugë", deklaroi Xhaferi. Ndryshe, kohëve të fundit në rrugët e Tetovës nuk vërehen qen endacak, ndërsa dyshimet janë se në mënyrë ilegale, të njëjtit helmohen me qëllim që të mos qëndrojnë në pjesët qendrore të qytetit të Tetovës.

Punohet në inkluzionin social të fëmijëve me pengesa

Shkup, 19 nëntor - Në Maqedoni ende nuk mund të sigurohet inkluzion i tërësishëm i fëmijëve dhe personave me pengesa në arsim dhe shoqëri. Pengesat me të cilat përballen personat me pengesa janë barriera fizike dhe infrastrukturore, ekzistimi i shkollave speciale, mungesa e asistencës arsimore dhe personale, shenja dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve arsimore dhe shoqërisë në tërësi që t'i pranojë, në mënjanimin e së cilës punon sektori joqeveritar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe MASH përmes zbatimit të projekteve për zhvillim të shërbimeve sociale në nivel lokal, deinstitucionalizimin por edhe zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve dhe shoqërisë që të mund të mundësojnë inkluzion më të madh. "Për atë ne si Ministri, si Qeveri punojmë në përfshirjen e këtyre personave, së pari përmes mbylljes së institucioneve të mëdha me deinstitucionalizimin, si proces i tërheqjes së fëmijëve ose personave nga institucionet, por megjithatë shoqëria duhet të përgatitet për pranimin e tyre. Përkujtohemi në rastin "Timjanik" i cili është shembull se si ne e perceptojmë inkluzionin – po, mirëpo jo te unë në oborr. Dhe pikërisht për atë, konsideroj se këto programe publike që i bëjnë organizatat qytetare me përkrahje të KE-së, ndërsa në bashkëpunim me shkollat, qendrat për punë sociale, institucionet shëndetësore dhe vetëqeverisjen lokale do të bëjnë ndryshim të gjendjeve", tha ministrja Milla Carovska në prezantimin e projektit "Partneritet inkluziv në bashkësitë", që e zbaton Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore "Hap pas hapi".

Tre të lënduar rëndë në Sllatinë të Tetovës

Tetovë, 19 nëntor - Tre persona, dy minorenë nga Sllatina dhe një grua e moshuar nga Nerashti janë lënduar më rëndë në aksidentin e komunikacionit që dje ndodhi rreth orës 11 e 40 minuta në rrugën rajonale Tetovë- Jazhincë para hyrjes në Sllatinë, informojnë nga policia e Tetovës. Në aksidentin kanë marrë pjesë dy vetura udhëtarësh me tabela të Tetovës, "Golf" e drejtuar nga 16 vjeçari nga Sllatina dhe "Opel korsa" e drejtuar nga F.A (36) nga Nerashti. Në përplasjen lëndime trupore kanë marrë shoferi i "Golfit" dhe bashkudhëtari i tij 17 vjeç, si dhe bashkudhëtarja e "Korsës" F.A (71) nga Nerashti. Tre personat e lënduar rëndë janë dërguar dhe mbajtur për mjekim në spitalin klinik të Tetovës. Ekip i policisë së Tetovës ka kryer mbikëqyrje në vendin e ngjarjes dhe punohet në vërtetimin e arsyeve të fatkeqësisë, rrethanave dhe gjithçka tjetër lidhur me të.

DEKLARATAT DOGANORE VETËM ELEKTRONIKE

Letra shkon në histori

Shkup, 19 nëntor - Drejtoria Doganore e Maqedonisë e pranoi sistemin e ri për përpunim të deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës (SPDDDA) që do ta zëvendësojë sistemin e deritanishëm, ndërsa i njëjti ishte përgatitur në pesë vitet e kaluara dhe paraqet fillim të erës digjitale të Drejtorisë Doganore.

"Sistemi i ri ka për qëllim që t'i zëvendësojë procedurat doganore të cilat bazohen në letër me procedura elektronike. Në këtë mënyrë do të krijohet rrethinë më efikase dhe moderne doganore në pajtueshmëri me zhvillimin global. Me të duhet të lidhen të gjitha sistemet ekzistuese digjitale në një tërësi të integruar dhe vendosjen e të gjitha deklaratave elektronike doganore për të gjitha procedurat doganore në import dhe eksport si dhe dorëzimin dhe përpunimin elektronik të dokumenteve të akcizës. Gjithashtu, me këtë sistem do të sigurojmë shpenzime më të vogla për transaksionet tregtare, zbatimin e lehtësuar të marrëveshjeve për tregti të lirë, menaxhim dhe kontroll më të mirë", informojnë nga Drejtoria Doganore. Sistemi i ri, siç theksojnë, paraqet parakusht për zhvillimin e mëtutjeshëm të vendimeve dhe shërbimeve digjitale, duke e bërë jetën më të mirë për pjesëmarrësit në veprimtarinë doganore dhe jashtë-tregtare, për agjencitë tjera kufitare që janë prezent në kufi si dhe për nëpunësit doganor.

Zbatimi i Sistemit të ri për përpunim të deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës do të fillojë në tremujorin e parë të vitit 2019 përmes Pilot zyrave doganore, ndërsa vendosja e tyre e plotë në funksion pritet kah mesi i vitit 2019. Nga Dogana vlerësojnë se kjo mes tjerash do të rezultojë edhe në pagesë më të suksesshme të të hyrave, shfrytëzimin më racional të resurseve dhe shkëmbim më efikas tregtar ndërkombëtar në të cilën tregtarët elektronikë do të shkëmbejnë informacione me Doganën dhe agjencitë e tjera pjesëmarrëse në procedurë doganore.

AKTIVITETET E PRESIDENTIT ILIR META NË MAQEDONI

110 ABETARE NË 110-VJETORIN E KONGRESIT TË MANASTIRIT

Pas vizitës në "Muzeun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe" i mikpritur e i shoqëruar nga shumë banorë shqiptarë, Meta shpërndau në mënyrë simbolike 110 Abetare për fëmijët shqiptarë të Manastirit

Manastir, 19 nëntor - Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë fundjavës mori pjesë dhe përshëndeti veprimtaritë përkujtimore të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, me pjesëmarrjen e dhjetëra shqiptarëve nga të gjitha trevat, ministrit të Kulturës së Maqedonisë, Asaf Ademi, gjuhëtarëve, politikanëve e filologëve.

Pas vizitës në "Muzeun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe" i mikpritur e i shoqëruar nga shumë banorë shqiptarë, Meta shpërndau në mënyrë simbolike 110 Abetare për fëmijët shqiptarë të Manastirit. Ai uroi mbarë kombit shqiptar gëzuar 110-vjetorin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe duke theksuar se rikthehet me shumë emocion në Manastir. "Të bëjmë gjithçka që kjo ndërtesë historike për shqiptarët të pasqyrojë më së miri kontributin e patriotëve shqiptarë. Pa Kongresin e Manastirit do të kishte qenë e vështirë edhe shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë", u shpreh Meta, duke shtuar se shqiptarët tashmë janë faktor progresist në shërbim të paqes, stabilitetit dhe integrimit të rajonit tonë.

Ai duke shprehur kënaqësinë që ndodhet në, siç tha ai, Kongresin historik të Manastirit, të Kongresit të Alfabetit tonë, që i bashkoi të gjithë shqiptarët, përkujtoi se udha e shkronjave tona për të mbërritur deri këtu, në Kongresin që u mbajt 110 vite më parë, ka qenë një udhë mjaft e gjatë, mjaft e vështirë, mjaft e përgjakshme në emër të mbijetesës dhe të ruajtjes së kombit, duke ruajtur e duke mbrojtur gjuhën e nënës dhe gjuhën e kombit tonë.

Meta e riafirmoi angazhimin e tij si President i Republikës së Shqipërisë për të bashkëpunuar më ngushtë me autoritetet e Maqedonisë dhe me të gjithë të tjerët në mënyrë që , siç tha , të bëjmë gjithçka që kjo ndërtesë historike gjithnjë e më shumë të pasqyrojë atë të vërtetë të madhe, atë kontribut historik për kombin tonë që dhanë këtë patriotë të jashtëzakonshëm, si Gjergj Fishta, Mid'hat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Bajo Topulli, Shahin Kolonja, Gjergj Qiriazi, Grigor Cilka, Sotir Peci, Taqi Buda, Nyzhet bej Vrioni dhe Parashqevi Qiriazi, të cilët i dhanë zgjidhje një problemi madhor të kulturës kombëtare, Alfabetit të gjuhës shqipe.

"Ndaj ne me këtë Kongres, me këtë alfabet të standardizuar e të dakortësuar këtu nga figurat më përfaqësuese të kombit tonë nga të gjitha trevat 110 vite më parë, i detyrohemi jo vetëm ekzistencës e Shqipërisë, jo vetëm ekzistencën e shtetit të Kosovës, por edhe faktin se shqiptarët, të cilët në pjesën më të madhe të historisë, për fat të keq, kanë qenë të pushtuar e të shtypur, sot janë një faktor, që po afirmohet kudo si faktor jashtëzakonisht progresist në shërbim të paqes, të stabilitetit dhe integrimit europian dhe euro-atlantik, dhe një rast shumë i mirë është roli i shqiptarëve të Maqedonisë", tha Meta.

Ai shprehu optimizëm që të përfundojë shumë shpejt edhe çështja e marrëveshjes për emrin e Maqedonisë, e marrëveshjes me Greqinë, dhe Maqedonia të jetë anëtare e NATO-s dhe së bashku me Shqipërinë të çelin negociatat vitin e ardhshëm për anëtarësim në Bashkimin Europian.

KOEFICIENTI PËR RRITJEN E PAGAVE, REAGON SINDIKATA E QENDRËS KLINIKE

PUNËTORËVE SHËNDETËSOR U SOSET DURIMI

"Rritjet e ndryshme të propozuara të koeficientit të vështirësisë në punë prej 10 për qind për mjekët specialistë dhe 5 për qind për punëtorët dhe bashkëpunëtorët tjerë shëndetësorë me pagën e janarit thellë sulmojnë marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe e dëmtojnë punën ekipore...", reagojnë nga Sindikata e Qendrës Klinike

Koha — Delvina KËRLUKU

Shkup, 19 nëntor - Sindikata e Qendrës Klinike e ka vlerësuar të papranueshme rritjen e propozuar të koeficientit të vështirësisë në punë për pagën e janarit me Buxhetin e vitit 2019, e cila për mjekët specialistë është 10 për qind, ndërsa 5 për qind për punëtorët dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë, me çka, theksojnë në këtë Sindikatë, shkaktohet ndarje e sindikatës.

"E hodhët mollën e grindjes. Me rritjen e propozuar të pagës së janarit për punëtorët dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë hytë në ekipin, nga mosdija ose me qëllim provuat ta ndani ekipin. Ajo për çka jemi të sigurt është se nuk do të keni sukses në provën ose qëllimin tuaj. Por, i ngjallët dyshimet. A do të ndahet mjeku specialist nga ekipi, parashtrojnë pyetje nëpër mjetet sociale një pjesë e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë. Kemi shikime të zymta nga ata me pesë për qind drejtë atyre me 10 për qind rritje të propozuar të koeficientit të kompleksitetit për pagën e janarit", theksojnë nga Sindikata duke u larguar nga çfarëdo lloj konotacioni politik.

Sindikata e Qendrës Klinike, gjithashtu shton se kishin shfaqur mbështetje publike të programit 2017-2020 për rritjen e dyfishtë të pagave të punëtorëve shëndetësorë dhe mjekëve specialistë në shëndetësinë terciare deri në minimum 100.000 denarë deri në fund të mandatit dhe se pjesërisht janë të kënaqur nga rritja e koeficientit të punës së natës, për të cilin vlerësojnë se ka hapësirë dhe duhet edhe më tutje të negociojmë, por theksojnë nuk janë të kënaqur nga dinamika e përmbushjes së programit në pjesën e rritjes së pagave të punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë.

"Të durueshëm dhe realist besojmë në argumentet e Juaja se mjetet në Buxhet janë të kufizuara. Por, kjo ofertë për ne është thjeshtë e papranueshme. Këto rritje të ndryshme të propozuara të koeficientit të vështirësisë në punë prej 10 për qind për mjekët specialistë dhe 5 për qind për punëtorët dhe bashkëpunëtorët tjerë shëndetësorë me pagën e janarit thellë sulmojnë marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe e dëmtojnë punën ekipore. Jemi të bindur se duhet të bëni përpjekje shtesë dhe të gjeni mjete për rritjen e koeficientit të vështirësisë në punë prej 10 për qind edhe për punëtorët tjerë shëndetësorë si dhe të bashkëpunëtorëve me pagën e janarit", qëndron mes tjerash në kumtesën e Sindikatës së Qendrës Klinike.

Yt atë dhe jot ëmë ishin idealistë! Po ti?!

Nga
Adelina MARKU

Frikërat dhe rrenat të ushqejnë ty, njëjtë siç e kanë ushqyer tët atë!, kështu i tha Presidenti i tanishëm i Francës kundërkandidates së tij, Le Pen, në një nga debatet nga fundi për zgjedhjet e fundit parlamentare të Francës . M'u kujtua ky emocion i tij, ngase sot - ideja mbi fuqinë e rrenës dhe frikës shkathtësisht po barabarëzohet me fuqinë e së vërtetës. Sa peshon rrena kur përgjigja qëndron në: për aq sa e vërteta? E sa peshon frika kur përgjigja qëndron në: për aq sa guximi?

Dhe ...doemos që është e vështirë të guxosh me të vërtetën pas një periudhe të gjatë të gjëmimit mes rrenës dhe frikës! Kjo i ndodh edhe sot shoqërisë ku jetojmë ne bashkë miku im ose mikesha ime! Guximi ngadalë ngadalë ka ulur kokë dhe mundohet të gjejë një platformë të rrehatshme të veprimit mëtej! Por, ka një problem kapital këtu veçse, sidomos për atë që guxon fillimisht e që mëpastaj t'ia ulë kokën me vetëdorë guximit! Problemi konstaton si vijon: guximi vërtet ndihmon për të ngritur një popull të tërë mëkëmbë - në luftë kundër rrenës e frikës, por ky (guximi) mjaftoka deri në momentin kur arriheshka qëllimi! Pra deri në momentin kur bjen konjukutura e rrenës dhe frikës e ngritet konjukturа që e thanka të vërtetën. Por sa gjëmon e vërteta në vijim?!

Sigurisht që jo! Sepse, i guximshmi i deridjeshit tani është në kërkim të zonës së komforit me qëllim që të ndërtojë ideologjinë e veprimit ngadalë ngadalë. Ndërton "platformën e sigurisë së veprimit të mëtejshëm politik" - do e quanin disa!

Platformë e rehatshme politike vështirë dështmohet për funksionale megjithatë! Sidomos kur sistemi është partiakisht i majorizuar e etnikisht i manipuluar deri në palcë! Aq më shumë kur shoqëria është kronikisht e ngarkuar me stereotipe nga më të vulgaret, e primitivet! Aty ku mbi stereotipet flitet formalisht, s'ka bukë! Aty ku vlon mediokriteti politik, s'ka vend për "guximin e idealistit"! Ose ose, aty ku përkatësia identitare shndërrohet në modele softweresh kontekstuale kulturoreah, integrohet asimilimi, jo integrimi! E sidomos - sidomos, kur në emër të procesit që duheshka shkuar përpara, detyrohesh të bësh lëshime! Aha, edhe këtë e kapërdyem. Pra, qenka procesi me rrëndësi! Por cili proces e ka radhën tani, ose sa herë definoheshka/standardizoheshka ky

proces? Ose sa herë kryheshka që të kthehet përsëri nga fillimi ky proces? Për mua një nga proceset shqetësuese që pjellën kjo "platformë drejt rehatisë politike" është edhe censusi ose numërimi i popullsisë , i cili paralajmërohet për t'u implementuar sipas një modeli të zgjedhur nga ekspertë! Është e vërtetë se ka modele të ndryshme të përcaktimit të numërimit të popullsisë, disa elemente (nr.shtëpive, përkatësia gjinore, përkatësia etnike etj) që zgjidhen për t'u integruar/numëruar verifikohen me qëllim për t'u shndërruar në politika zhvillimore më tej. Kështu është gjithandej nëpër botë. Numërimi i popullsisë në esencë është proces matematikor e që kryesisht bëhet për matje prodhimtarie e progresi ekonomik e me qëllim produktshmërie veprimi politik!

Po tek ne miq, ka një rrenë , apo një mister për të cilin flitet kuluareve qoshaxhike. Kjo rrenë që hidhet kuluareve qoshaxhike m'i ngjan asaj prostitutës që del në rrugë natën, sikur fshehtas! Njëjtë si puna e do gazetarëve por edhe politikanëve të cilët kishin kapur këtë prostitutë, e ishin kënaqur me aq..., ata pra nuk pyesin më gjatë se përse misteri nuk qartësohet! Nuk kërkojnë llogaridhënien ! Ata vetëm e qarkullojnë

Të gjithë pa dallim, duam të dimë sa jemi, kush jemi që të dimë se ku shkojmë dhe sa lartë do arrijmë! Është matematik e thjeshtë miq! Sepse, rrafshimi i përkatësisë etnike në petkun e përkatësisë gjuhësore e asaj fetare është një rrenë konformiste, padyshim që nuk sjell asnjë dobi praktike, por vetëm politizim te ri!

rrenën me lehtësinë e këmbimit të prostitutës , nga një kunj në tjetrin! Palaço, se jo gazetarë e as përfaqësues! Të rrxum n'gjunj! Rrena që hidhet ka të bëjë me misterin se përse nuk u bë numërimi i popullsisë në kohën kur duhej bërë. M'u si prostituta pra, natën flitet qosheve se nuk kishin rënë dakord për do parime dy liderët politikë të qeverisë së kaluar, për shkak të disa paqartësive politike që implikonte ky proces në kontekstin e atëhershëm politik! Po sot ç'thuhet se? Oh, thuhet e njëjta - mjafton të dëgjoni deklaratat e Shefit të Entit Statistikës. Pra, numërimi i popullsisë në Maqedoni shndërrohet në mjet për bërje platformë të rehatshme politike në momentin kur thuhet se për arsye të keqinterpretimeve/implikimeve politike në vend, nuk do parashtrohet pyetja se cilës etni i takoni, por cilën gjuhë e flisni e cilit besim fetar i takoni. Dmth ky arsyetim blozë është rezultat i ndërgjegjes së flliqun, për më shumë , përmban përsëri plot politikë! Cili është dallimi? Çka është komunitet linguistik para komunitetit etnik? Çka është komunitet fetar para atij etnik? Përse përcaktim linguistik e fetar po e jo etnik? Përse asnjëra e përse të gjitha pa përjash-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërdëshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 19 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

tim? Çfarë është prapavija? Përse implikon prapavijë e përsëri mister ky arsyetim i kryesuesit te Entit për Statistikë? A është ai që duhet të vendosë se si do bëhet regjistrimi i popullsisë? Cila është pedigreja e pesha e tij ne rëndësinë e vendimmarrjes lidhur me këtë proces? Pyetje që më vërshojnë në mëndje e që më ndjellin përsëri dyshimin! Miq, konteksti politik sot ka të bëjë me garantimin e një stabiliteti të veprimit të kësaj qeverie për të cilën thuhet, rrënoi rrenën dhe frikën që ndjellte qeveria e kaluar! Deri këtu dakord. Por , kjo qeveri ushtron me diktatin politik të një konformizmi social, i cili në mendimin tim do tregohet po aq i dëmshëm sa ç'ishte veprimi i së kaluarës.

E ky, konformizmi social ka të bëjë me ndryshimin e sjelljes, sidomos asaj publike , ka të bëjë me ndryshimin e besimeve , ideve , opinioneve (formalisht ose jo) për t'iu përshtatur besimeve e standardeve të shumicës apo për t'iu nënshtruar presioneve sociale, të grupeve e individëve drejtues kryesisht. Është Erich Fromm që shkruan se konformizmi më tepër mund të kuptohet si një konsekuencë (si një rrjedhojë e dëmshme) e pashmangshme e vetë industrializmit të jetës , që fillimisht ka mundësuar asimilimin dhe shkrirjen e individualitetit të njeriut , e pastaj për shkak të humbjes së këtij uni , integrohet konformizmi si linjë karakteri e cila i largon(i hedh jashtë, i përjashton) dyshimet rreth identitetit . E si? E thjeshtë: duke KONFORMUAR me dëshirat e të tjerëve , përmes të mosqenurit ndryshe e për hir të njëfarë sigurie (komfori) . Përmes identifikimit me të tjerët, njeriu pushon së qeni vetja dhe e përshtat tipin e personalitetit që i ofrohet nga modelet kulturore. Dhe pikërisht, ky model kulturor komformist i mënyrës se si është vendosur të qeverisë kjo qeveri implikon një interpretim "politikisht korrekt" mbi përse numërimi i popullsisë do bëhet pa identifikim etnik, por me identifikim gjuhësor e fetar.

E këtu alarmi im ndizet, sepse kjo lloj korrektësie politike të nderuar miq, më së paku i nevojitet procesit të numërimit të popullsisë! Të gjithë pa dallim, duam të dimë sa jemi, kush jemi që të dimë se ku shkojmë dhe sa lartë do arrijmë! Është matematik e thjeshtë miq! Sepse, rrafshimi i përkatësisë etnike në petkun e përkatësisë gjuhësore e asaj fetare është një rrenë konformiste, padyshim që nuk sjell asnjë dobi praktike, por vetëm politizim te ri!

Dhe vërtet', pastaj do na thonë se: "Frikërat dhe rrenat të ushqejnë ty, njëjtë siç e kanë ushqyer tët atë!".

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

Gruevski dhe "refugjati" me influencë

Nga
Krsto LAZAREVIĆ

Ai është i dënuar, nuk ka dokumente dhe kërkohet në vendlindje, sepse e ka mashtruar shtetin duke i marrë shumë para. Ai është kreu i një klani kriminelësh dhe me gjasë duhet të ketë në zotërim disa telefona smartphone. Ai ka shkuar ilegalisht në Budapest dhe ka kërkuar azil, për t'i ikur një dënimi prej dy vjetësh në vendin e tij. Viktor Orban e pranon krahëhapur këtë refugjat kriminel. Sepse bëhet fjalë për mikun e tij dhe shokun e idealit, Nikola Gruevski që 10 vjet drejtoi fatet e Maqedonisë, si kryeministër.

Orbani thotë, ai nuk do refugjatë, që nuk përshtaten me kulturën hungareze. Por Nikola Gruevski i shkon shumë për shtat kulturës së Orbanit. Të dy janë autokratë, që brenda pak vitesh i kanë shkatërruar strukturat demokratike, të drejtat qytetare dhe lirinë e shtypit në vendet e tyre. Të dy janë të korruptuar, dhe i kanë bërë shumë të pasur disa miq apo anëtarë të klaneve të tyre. E të dy luftojnë kundër ardhjes së refugjatëve dhe punojnë me teori komplotiste.

BAGAZHI QË GRUEVSKI MORI ME VETE NË HUNGARI

Në vitin 2014 ishte Gruevski ai që luftoi, që Maqedonia të shpallej "vend i sigurt origjine", po duket se tani ai vetë nuk e po quan vend të sigurt. Ishte po ai që në marsin e vitit 2016 mbylli kufirin me Greqinë duke e mbyllur kështu edhe itinerarin e Ballkanit. Për këtë atij i shtrohej qilimi i kuq nga konservatorët e populistët e djathtë në Europë. Kancelari austriak, Sebastian Kurz fluturoi madje në Shkup për të bërë fushatë për të. Në një kohë që lista e akuzave kundër Gruevskit ishte e gjatë. Ai lejoi përgjimet ilegale të dhjetëra mijëra qytetarëve, burgosi gazetarët kritikë, u përpoq të fshihte vdekjen e një të riu, që u eliminua nga forcat e sigurisë, dhe madje edhe për vetë marrëdhëniet "ballkaneze" ishte shumë i korruptuar.

Viktor Orban nuk e vret shumë mendjen për këtë - përkundrazi. Në maj mediat e afërta me Orbanin blenë disa mediat maqedonase, që atëherë u bien daulleve për Gruevskin. Njeriu që mbylli itinerarin e Ballkanit është vetë një migrant ilegal. Pasaporta e tij u konfiskua nga autoritetet maqedonase për shkak të rrezikut të arratisë, prandaj atij iu desh të kontrabandohej me disa automjete diplomatike hungareze nëpër disa kufij. Ligjet që bëjnë populistët e djathtë me sa duket nuk vlejnë për vetë ata.

A MUND T'I NDODHTE KJO NIKOLA GRUEVSKIT?

Sepse nëse Nikola Gruevski do të ishte vetë një refugjat normal, nuk kishte pse të hynte në Hungari. Ai duhet të priste në qendrën e tranzitit në kufirin serb derisa të vendosej për kërkesën e tij. Kërkesa do të refuzohej, sepse ai nuk mund të paraqiste një pasaportë të vlefshme udhëtimi. Ndoshta Gruevski do të ishte përpjekur në një rast të tillë të udhëtonte ilegalisht përmes Bosnjes deri në kufirin kroat. Por atje ai do të ngrinte nga të ftohtit në çadrat e improvizuara dhe do të ishte i varur nga aktivistët që ndihmojnë refugjatët, të cilët ai dhe miqtë e tij populistë i kanë kriminalizuar dhe i kanë ndjekur penalisht.

Hungaria i kërcënon refugjatët me burg, nëse hyjnë ilegalisht në vend. Por me sa duket ligji nuk vlen për mikun e Viktor Orbanit, ish-kryeministrin maqedonas në kërkim ndërkombëtar, Nikola Gruevski

Ndërkohë që në përpjekjen për të kaluar kufirin kroat, mund të kishte ndodhur që policët kroatë t'i kishin thyer ndonjë këmbë, ose mund ta kishin qëlluar, si më 31 maj, kur u qëllua me armë ndaj një autobusi duke u plagosur dy fëmijë. Por sigurisht të gjitha këto nuk do t'i ndodhnin, Nikola Gruevskit, sepse ai nuk është refugjat lufte, por një kriminel me influencë. Një autokrat i korruptuar, që ka vjedhur popullin e tij dhe që tani i trembet burgosjes.

NJË SHAKA?

Nikola Gruevski madje ka futur në politikë teorinë më të dashur komplotiste të Viktor Orbanit, ajo që miliarderi hebre, George Soros në prapaskenë lëviz fijet, që të islamizojë Europën përmes emigrantëve. Orbani e bëri të tijën këtë narrativë dhe si temë kryesore të fushatës së fundit elektorale. Pra burri i dikurshëm i fortë i Maqedonisë, ka dëmtuar keqazi jo vetëm vendin e tij, por ka futur në sallonet e politikës një teori antisemitiste komplotiste. Prandaj mund të paramendohet se trajtimi i kërkesës për azil mund t'i sjellë favore... Mendoni se kjo është shaka? Jo nuk është. Kur një zëdhënës i partisë hungareze, Fidesz u pyet për Gruevskin, ai tha "Hungaria u ofron të gjithë të përndjekurve mbrojtje, dhe Nikola Gruevski kërcënohet nga qeveria maqedonase, që ndodhet nën influencën e George Sorosit".

Rasti Gruevski hedh dritë mbi një problem bazë të demokracive në Europën Lindore. Pushtetmbajtësit në Hungari, Rumani, Bullgari, Serbi, Mal të Zi e vende të tjera janë të korruptuar e duhet të llogarisin një ditë që edhe mund të burgosen, nëse pushteti i tyre merr fund. Prandaj ata janë të gatshëm të bëjnë gjithçka, që të mbajnë postet e tyre, pa e çarë kokën për shtetin ligjor e demokracinë. Viktor Orban dhe Nikola Gruevski janë të dy tipi i këtij politikani dhe prandaj është logjike që njëri i hap krahët tjetrit, edhe kur nuk është ndonjë mik i madh i refugjatëve.

(Krsto Lazarević ka lindur në Bosnjë -Hercegovinë dhe si fëmijë ka ardhur refugjat në Gjermani bashkë me familjen. Sot ai jeton në Berlin, punon si gazetar dhe publicist dhe shkruan për media të ndryshme në gjuhën gjermane)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Koha për Kulturë

Koha, e martë, 20 nëntor 2018

KOSOVA E MAQEDONIA SHKELIN AFATIN PËR KALENDAR TË PËRBASHKËT KULTUROR

Në një konferencë të përbashkët për media kishin shpalosur se kanë rënë dakord për bashkëpunim konkret në fushën e kulturës. Bile ministri Gashi kishte shkuar edhe më tej. Kishte thënë se është e mundshme të bëhet një kalendar i përbashkët kulturor midis Kosovës, Maqedonisë e Shqipërisë. Por deri më tash nuk ka asgjë konkrete as midis vetë Kosovës e Maqedonisë

Kosova e Maqedonia kanë planifikuar që të kenë kalendar të përbashkët kulturor qysh prej shtatorit të këtij viti. Por dështimet në projektimin e ngjarjeve të përbashkëta kulturore kanë nisur në hapat e parë. Dy Ministritë e Kulturës nuk i janë përmbajtur as afatit të caktuar për nënshkrimin e dokumentit ku do të parashihej bashkëpunimi në fushën e kulturës midis institucioneve të të dyja vendeve. Entuziastë e bindës ishin treguar ministri i Kulturës, Kujtim Gashi, dhe homologu i tij në Maqedoni, Asaf Ademi, në ditën e parë të gushtit të këtij viti. Ademi ia kishte mësyrë vizitës së parë jashtë vendit si ministër që të ketë takim me ministrin Gashi në Ministrinë e Kulturës në Prishtinë.

Në një konferencë të përbashkët për media kishin shpalosur se kanë rënë dakord për bashkëpunim konkret në fushën e kulturës. Bile ministri Gashi kishte shkuar edhe më tej. Kishte thënë se është e mundshme të bëhet një kalendar i përbashkët kulturor midis Kosovës, Maqedonisë e Shqipërisë. Por deri më tash nuk ka asgjë konkrete as midis vetë Kosovës e Maqedonisë.

"Duke pasur parasysh që një numër i madh i shqiptarëve jetojnë në Maqedoni dhe Maqedonia ka një mërgatë të madhe shqiptare, jemi dakorduar që t'i autorizojmë institucionet e kulturës në mënyrë që të kemi aktivitete, ngjarje të përbashkëta kulturore. Gjithashtu të kemi shkëmbime të ansambleve tona me ansamblet e Maqedonisë. Shqiptarët këndej e andej kanë një gjuhë, kulturë e traditë të përbashkët. Po ashtu jemi dakorduar që ta kemi edhe një kalendar të përbashkët kulturor", kishte thënë ministri Gashi. Asokohe ai kishte thënë se në kuadër të marrëveshjeve ngjarjet kulturore do të caktohen veç e veç.

Homologu i Gashit, Asaf Ademi, kishte thënë se bashkëpunimi do të shkojë duke u thelluar edhe më shumë./koha.net

"MARTESA" NË FUSHATË PËR "OSCAR"

Shfaqja e "Martesës" në Los Angeles bëhet nga "European Film Production" që synon t'i theksojë produksionet evropiane mes 87 filmave që konkurrojnë për t'u nominuar për "Oscar" për filmin më të mirë në gjuhë të huaj.

"Martesa", propozimi i Kosovës për "Oscar", do të shfaqet dy herë në Los Angeles, në kuadër të fushatës promovuese për çmimin prestigjioz. Filmi me regji të Blerta Zeqirit, bashkëfinancuar nga Qendra Kinematografike e Kosovës, do të shfaqet për t'iu dhënë rast anëtarëve të Akademisë prestigjioze ta shohin propozimin e Kosovës. Qendra Kinematografike e Kosovës në shtator bëri të ditur se do të koordinohet me distributorin amerikan "Uncork'd Entertainment" për ta realizuar fushatën promovuese të filmit "Martesa". Shfaqja e "Martesës" në Los Angeles bëhet nga "European Film Production" që synon t'i theksojë produksionet evropiane mes 87 filmave që konkurrojnë për t'u nominuar për "Oscar" për filmin më të mirë në gjuhë të huaj. Arben Zharku, drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, ka thënë se një ekip nga Kosova do të jetë prezent në shfaqjen e "Martesës" në Los Angeles. "Do të jemi aty unë, producenti Kreshnik Kekë Berisha dhe regjisorja Blerta Zeqiri. Gjithashtu edhe dy regjisore, More Raça e Lendita Zeqiraj, me filma të shkurtër", ka thënë Zharku.Filmi "Ajo" i Raçës do të shfaqet në kuadër të festivalit të njohur amerikan "AFI Festival", derisa "Gardhi" i Zeqirajt nuk do të ketë shfaqje. Përveç filmit të Blerta Zeqirit, edhe projekte filmike të Lendita Zeqiraj e More Raça janë kualifikuar për nominim për edicionin e 91-të të ndarjes së çmimeve të akademisë prestigjioze "Oscars".

TË HËNËN DHE TË MARTËN NË VATIKAN

ARTISTËT TË BASHKUAR NË KUJTIMIN E SKËNDERBEUT

Në vitin 1968, në 500 vjetorin e vdekjes së heroit, shqiptarët e diasporës u pritën në Vatikan nga Papa Pali VI, një përvjetor që gjeti Shqipërinë nën diktaturën komuniste. Tani, për herë të parë, përfaqësuesit e popullit shqiptar, një grup prej rreth 200 personash, do të jenë në gjendje të takojnë Papa Françeskun.

Ermal Meta, Dua Lipa, Olen Çezari, Inva Mula, Kledi Kadiu, Genc Tukiçi, Reme Lahaj, Elhaida Dani, Lorik Cana, Eno Peci, Erza Muqolli: një kast i yjeve shqiptarë për koncertin "Të Bashkuar në Muzikën dhe Kujtimin e Skënderbeut", organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, i programuar të hënën në teatrin "Argentina" në Romë, duke filluar nga ora 20.30.

Eventi është hapur nga Kardinali Pietro Parolin, Sekretari i Shtetit i Vatikanit, me rastin e mbylljes së vitit kombëtar të Skënderbeut, i cili u festua në mëngjes me një takim me Papa Françeskun.

Ambasada e Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë njoftoi për ngjarjet që po realizohen në 550-vjetorin e vdekjes së Heroit Kombëtar të Shqipërisë, Skënderbeut, 'Atleta Cristi "dhe "Difensore della Fede", i dominuar nga Papalët Romanë.

Skënderbeu konsiderohet si figura më e rëndësishme në historinë e Shqipërisë, një simbol i unitetit dhe forcës së kombit në të gjitha kohët me kohë solli së bashku shqiptarët pa dallim feje. Për ta kujtuar atë, "bijtë e Shqipërisë" do të takohen në Romë të hënën 19 dhe të martë 20 nëntor.

"Skënderbeu – njofton Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, – do të përkujtohet nga Selia e Shenjtë. Papa Françesku ka pranuar kërkesën e ambasadorit të Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, Majlinda Dodaj, ku do të presë në një audiencë të veçantë përfaqësuesit e popullit shqiptar nesër në orën 17:00 për të përkujtuar së bashku heroin kombëtar shqiptar. Seanca do të mbahet në "Sala Clementina" të Pallatit Apostolik. Ndër përfaqësuesit e Shqipërisë, do të jetë gjithashtu edhe Kardinali Ernest Simoni, i vetmi prift ende i gjallë i persekutuar nga diktatura komuniste.

Autoritetet shtetërore shqiptare që ishin të pranishëm, u përfaqësuan nga Kryetari i Parlamentit Shqiptar, Gramoz Ruçi, me grupin e përfaqësuesve të parlamentit; Ministri i Diasporës Pandeli Majko, Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla dhe të gjithë liderët e konfesioneve të ndryshme fetare të pranishme në Shqipëri, të ndjekur nga besimtarët e tyre. Nuk ka munguar as peshkopi i Eparkisë së Lungros në Kalabri në përfaqësi të Arbëreshëve, ose ialo-shqiptarëve, Mons.Donato Oliverio dhe Mons.Giorgio Gallaro, peshkopi i Eparkisë së Piana degli Albanesi në Sicili.

Në vitin 1968, në 500 vjetorin e vdekjes së heroit, shqiptarët e diasporës u pritën në Vatikan nga Papa Pali VI, një përvjetor që gjeti Shqipërinë nën diktaturën komuniste. Tani, për herë të parë, përfaqësuesit e popullit shqiptar, një grup prej rreth 200 personash, do të jenë në gjendje të takojnë Papa Françeskun.

Të martën, në 20 nëntor në orën 10:00, delegacioni shqiptar do të pranohet në Pallatin Magjistral të Urdhrit Sovran të Maltës, me të cilin Shqipëria ka mbajtur marrëdhënie që nga viti 1994, nga Mjeshtri i Madh i Rendit, Fra Giacomo Dalla Torre del Tempio di Sanguinetto.

ÇFARË E BËN FEDERICO FELLININ "MAESTRO" TË KINEMASË ITALIANE?

Deri në vdekjen e tij më 1993, Federico Fellini kishte marrë katër çmime Oscar, duke u barazuar me bashkëvendësin e tij Vittorio De Sica për numrin më të madh të çmimeve të fituara nga ndonjë regjisor.

25 vjet pas vdekjes së tij, hija e gjatë e trashëgimisë së tij shkon përtej çmimeve dhe mirënjohjeve. Vizioni i Maestros ishte i rrallë dhe hipnotik, sa që në fjalorin e kinematografisë u fut epiteti "Fellinesk", ndërsa gjeneratave tjera ua tregoi rrugën se si duhet eksperimentuar dhe rrezikuar, shkruan për BBC kritiku Chris Nashawaty.

Martin Scorsese kohët e fundit ka pranuar se e ka parë për çdo vit kryeveprën e Fellinit të vitit 1963, "8½".

"Në shumë aspekte, '8½' ka qenë kriter për mua", ka thënë ai.

Për pjesën tjetër prej nesh, nga ata që paguajnë për t'u ulur në kinematë e errëta e për t'ia ngul sytë ekranit me shpresën për magjepsje dhe udhëtim, nuk është e tepërt të thuhet se Fellini i ka drejtuar adhuruesit e filmit në një mënyrë tjetër të shikimit të gjërave. Ai vazhdon të na dërgojë në destinacionet përtej botës anglofone – destinacionet që nuk i kemi menduar as në fantazitë tona më të çmendura. Ai e krijoi një stil personal të kinemasë që mrekullisht ishte universal, duke e bërë planetin tonë të duket më i vogël e më intim.

Megjithatë, nuk ndjehem mirë të them se komuniteti kritik kishte marrëdhënie të komplikuar me Fellinin. Në analizën e filmit "8½", Pauline Kael merr një snajper dhe e vë filmin në shënjestër. Por, nuk ishte e fundit. Në antologjinë e vitit 2008, "Have You Seen?", David Thomson kritikon pothuajse të gjithë filmat e tij të mëdhenj: "8½", "Amarcord", "La Dolce Vita" (për të cilin thotë se aty "asgjë nuk ndodhë"), "Le notti di Cabiria" (ku luan gruaja dhe muza e Fellinit, Giulietta Masina, në një nga rolet më të guximshme që kam parë ndonjë herë, e ai thotë se e "shoh si aktore të neveritshme").

Kael dhe Thomson nuk janë veç gabim, sepse gjykimet e tyre janë edhe të pakuptimta. Me përjashtim të De Sicas dhe filmin e tij "Umberto D", Fellini ka qenë filmbërësi më introspektiv, më me art dhe më i thellë italian (ju kërkoj falje partizanëve të Antonionit). Askush nuk e përzien të hidhurën me të ëmblën me prekje aq të lehta si ai. Dhe, me sa duket, unë nuk jam i vetmi kritik që e ndjen këtë. Në sondazhin e BBC-së për 100 filmat më të mëdhenj të gjuhëve të huaja, Fellini është në vendin e dytë në mesin e regjisorëve me më shumë filma në listë. Ai kishte katër; vetëm Ingmar Bergman dhe Luis Bunuel kishin më shumë, me pesë secili. Filmat e Fellinit që bën ndryshimin, janë: "8½" në vendin 7; "La Dolce Vita" në vendin 10; "La Strada" në vendin 83; "Le notti di Cabiria" në vendin 87. "Amarcordi" është jashtë liste, në vendin 112.

I lindur në vitin 1920, në qytetin e Riminit në bregdetin e Adriatikut, Fellini e nisi karrierën e tij si skenarist për filmin neorealist të vitit 1945 të Roberto Rossellini, "Roma città aperta". Një dekadë e gjysmë më vonë, do të ishte e vështirë të imagjinohej dikush që do t'ia kthente shpinën realizmit (Neo ose ndryshe), më shumë se Fellini. Filmat e tij të hershëm, të frymëzuar nga Rossellini, si ai i vitit 1953 "I Vitelloni", u la në harresë nga "La Strada" e vitit 1954-ës dhe "Le notti di Cabiria" i vitit 1957, për shkak të sentimentalizmit pikaresk dhe ndjesive njerëzoren të shtresave të ulëta të cirkusantëve dhe prostitutave. Pastaj erdhi "La Dolce Vita" – një bredhje në orët e vona në shoqërinë e lartë të Romës. Kjo ishte si shkollë në zjarrin ekzistencial dhe hedonizmin e pasluftës, i ndezur nga sharmi cinik i heroit Marcello (Marcello Mastroianni), imazhet e paharruara të statujës së Krishtit duke u ngritur lart dhe biondinës Anita Ekberg si një Venerë në shatërvanin Trevi… "La Dolce Vita" do të katapultojë Fellinin në radhët e regjisorëve më të famshëm në botë. Kjo atë e çoi në një krizë shpirtërore dhe artistike (si mund ta ndjekësh suksesin më të madh të karrierës suaj?) që u bë brumë narrativ për projektin e tij të ardhshëm, "8½". Duke folur përmes alter egos së tij, përmes Mastroiannit edhe këtë herë, Fellini e shndërroi "8½"-shin në një nga filmat më reflektues e më me humor të tij. Ky film do të nis një kapitull të ri në karrierën e tij, ku narracioni ishte i dytësor për spektaklin.

Nuk dua të them se të gjitha filmat e Fellinit, nga fundi i viteve 1970, meritojnë të njëjtin status 'klasik'. Por, kur në vitin 1993 merr Oscarin e Nderit, duke ecur në skenë për të marrë statujën, më pak se një vit përpara vdekjes së tij, 73-vjeçari ishte i sinqertë deri në atë pikë sa që i tha faleminderit gruas së tij Giulietta dhe i kërkoi të mos qajë. Dhe, çfarë kishte për të thënë më shumë? Filmat e tij tashmë kishin thënë gjithçka.

DËSHMIA E AT GJERGJ FISHTËS NË KONGRESIN E MANASTIRIT

Fjala e tij u ndigjue me duartrokitje e më caktuen Kryetar të Komisionit të Kongresit të Manastirit, i cili do të delte bosh sikur mos të ishte tregue toleranca e eme që të pranojshm dy alfabete njiherit, atë të Stambollit që kërkonte Mit'hat Frashëri dhe këtë që u vendos.

Njëri nga pjesëmarrësit e Kongresit të Manastirit, At Gjergj Fishta, pati ndikim të fuqishëm në unifikimin e alfabetit të shqipes, të cilin e përdorim tash e 110 vjet.

At Fishta duke e rikujtuar atë ditë, shkruante:

"Ishim nga të gjitha skajet e Shqipnisë dhe të kolonive shqiptare ndër dhena të hueja. U treguam me të vertet shqiptar sepse kurnjani nuk donte me i lëshue asnji fije penit nga mendimi i vet atij tjetrit. Kongresi duhej të shpërndahej pa marrë kurrnji vendim.

– U terbova nga inati, U çova në kambë e u fola: – O burra shqyptarë po a me të vërtetë do t'i lamë marre vedit para të gjithë botës?

– Po a mendoni ndopak se çka do t'u thomi shqyptarëve kur të na pvesin se çka keni ba ju dijetarët atje në Manastir?

– Çka do t'u thomi na njerzve të pashkollë që nuk dijnë as me shkrue as me këndue?… Na jemi që mendojmë me ba Shqypninë e si do ta bajmë atë kur na nuk duem me u marrë vesht ndërmjet vedit se si duhet me u shkrue germa A e ajo I?

– Burra po u flas me zemër në dorë se asht marre e turp e faqe e zezë me i lanë marre vedit para popullit shqyptar e para tanë botës, që pret dishka prej nesh e na të kthejmë pa kurrgja në dorë ndër shpija tona.

– Po ulnju burra, ulnju sheshit e pse të kalojmë edhe nji ditë ma shumë në kët vend, mos ta lamë duerbosh popullin që na pret!…

– Aferim! P.Gjergj!… Aferim të kjoftë, . bërtiti më të madhë një hoxhë me mjekërr. Ai u çue në kambë e e erdh drejt te un, e më puthi në ballë e më tha: – Kështu flet shqiptari që e di që asht shqiptar!…

Ulnju burra, – u tha, – ulnju këtu në shesh të zgjedhim një komisjon e në krye të vemë Pader Gjergj Fishten e vetëm komisjoni do të caktojë se shka duhet të bajmë sot-për të mirën e popullit shqiptar neser…

Fjala e tij u ndigjue me duartrokitje e më caktuen Kryetar të Komisionit të Kongresit të Manastirit, i cili do të delte bosh sikur mos të ishte tregue toleranca e eme që të pranojshm dy alfabete njiherit, atë të Stambollit që kërkonte Mit'hat Frashëri dhe këtë që u vendos.

Kjo sjellje e eme në Kongres të Manastirit më ka kushtue mjaft shterjt në jetë sepse Abat Doçi, të cilin un e përfaqsova në atë Kongres m'u idhnue e kur u ktheva më tha :Pater Gjergj, un të kam dijtë si nieri që nuk ban kompromis në jetë! …

Por Shqypnija nuk mund të bahej ndrysh…"

Nga, Gjergj Fishta

Në bazë të nenit 2 pika 4 alineja 2, nenit 4, 24, 25, 27, 28, 29, 46, 47, 48 dhe nenit 49 nga Ligji për shfrytëzim dhe diskonim me sendet në pronësi shtetërore dhe sendet në pronësi të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/2015, 106/2015, 153/2015, 190/2016 dhe 21/2018), Vendimi për shitjen e sendeve të luajtshme – automjet motorik rrugor pronësi e Komunës së Strugës nr. 08-753/4 ("Informatori zyrtar i Komunës së Strugës" nr. 02/2018) dhe Vendimit për plotësimin e Vendimit për shitjen e sendeve të luajtshme – automjet motorik rrugor pronësi e Komunës së Strugës nr. 08-753/4 me nr. 08-393/35 ("Informatori zyrtar i Komunës së Strugës" nr. 05/2018), Raportit për vlerësim të mjetit transportues përpiluar nga NT JETA 000 – Strugë nr. 03-1196/9 të datës 04.07.2018, nr. 03-1196/10 të datës 04.07.2018, nr. 03-1196/11 të datës 04.07.2018, 03-1196/12 të datës 04.07.2018 dhe nr. 03-1196/14 të datës 08.11.2018, Komisioni për realizimin e procedurave për shitje dhe dhënie me qira të sendeve të paluajtshme, procedura për shitjen e sendeve të luajtshme dhe procedurës për furnizim të sendeve të paluajtshme të Komunës së Strugës publikon:

SHPALLJE nr. 1/2018

për shitjen e sendeve të luajtshme 5 (pesë) automjete motorike rrugore në bazë të ankandit elektronik publik (Shpallja e parë)

I. LËNDË E SHITJES ME ANKAND ELEKTRONIK PUBLIK

Lëndë e kësaj shpalljeje në bazë të ankandit elektronik publik është shitja e sendit të luajtshëm – Automjetit motorik rrugor pronësi e Komunës së Strugës i cili shitet në pajtim me Vendimin për shitjen e sendeve të luajtshme – automjetit motorik rrugor pronësi e Komunës së Strugës nr. 08-753/4 dhe Vendimit për plotësim të Vendimit për shitjen e sendeve të luajtshme – automjetit motorik rrugor pronësi e Komunës së Strugës nr. 08-753/4 me nr. 08-393/35, miratuar nga Këshilli i Komunës së Strugës.

MERCEDES BENZ me nr.regj.SU-2854-AB me karakteristikat vijues:

Të dhëna për automjetin	Çmimi fillestar i vlerësuar në denarë	Garancia bankare 2%	Hapi minimal	Orë /fillimi
- Automjeti motorik marka MERCEDES BENZ - Shenja regjistruese: SU-2854-AB - Regjistrimi i parë: 16.02.2006 - Viti i prodhimit:2005 - Lloji: Automjet motorik - Tipi: 211 E CLASSE 200 CDU - Nr. i sasisë WDB2110041A837658 - Nr. I motorit 646951/30433693 - Fuqia e motorit 90 kw (ks) - numri i ulëseve : 5 - Ngjyra: hi metalik 11 - Sasia e automjetit: 1600 kg	233.700,00	4.674,00	Pa kufizime	Ora 10:00

Çmimi fillestar i sendit të luajtshëm është vlera e vlerësuar i të njëjtit theksuar në pasqyrën tabelore.

Çmimi për shitjen e sendit të luajtshëm është përcaktuar në bazë të Raportit për vlerësim të mjetit transportues përpiluar nga ana e NT. JETA 000 – Strugë nr. 03-1196/9 të datës 04.07.2018.

2. OPEL VEKTRA me targa regjistrimi SU-0348-AB me karakteristika vijues:

Të dhëna për automjetin	Çmimi fillestar i vlerësuar në denarë	Garancia bankare 2%	Hapi minimal	Orë/ fillimi
- Automjeti motorik marka OPEL VEKTRA - Shenja regjistruese: SU-0348-AB - Regjistrimi i parë: 24.07.2001 - Viti i prodhimit: 2001 - Lloji: Automjet motorik - Tipi: VEKTRA COMFORD 2.0 TD - Nr. i sasisë WOLOJB1911099196 - Nr. i motorit Y2ODTH17926227 - Fuqia e motorit 74 kw (ks) - numri i ulëseve : 5 - Ngjyra : hi metalik 7f - Sasia e automjetit: 1385 kg	36.900,00	738,00	Pa kufizim	Ora 11:00

Çmimi fillestar i sendit të luajtshëm është vlera e vlerësuar i të njëjtit theksuar në pasqyrën tabelore.

Çmimi për shitjen e sendit të luajtshëm është përcaktuar në bazë të Raportit për vlerësim të mjetit transportues përpiluar nga ana e NT. JETA 000 – Strugë nr. 03-1196/10 të datës 04.07.2018.

3. OPEL ASTRA me targa regjistrimi SU-1017-AB me karakteristika vijues:

Të dhëna për automjetin	Çmimi fillestar i vlerësuar në denarë	Garanciai bankare 2%	Hapi minimal	Orë/ fillimi
- Automjeti motorik marka OPEL - Shenja regjistruese: SU-1017-AB - Regjistrimi i parë: 10.10.2003 - Viti i prodhimit: 2003 - Lloji : Automjet motorik - Lloji: ASTRA COMFORD 1.7 TDI - Nr. I sasisë WOLOTGF 6935259435 - nr. I motorit Y17DTO753385 - Fuqia e motorit 55 kw (ks) - numri i ulëseve 5 - Ngjyra: e zezë 20 - Fuqia e motorit: 1195 кг/kg	98.400,00	1.968,00	Pa kufizim	Ora 12:00

Çmimi fillestar i sendit të luajtshëm është vlera e vlerësuar i të njëjtit theksuar në pasqyrën tabelore.

Çmimi për shitjen e sendit të luajtshëm është përcaktuar në bazë të Raportit për vlerësim të mjetit transportues përpiluar nga ana e NT. JETA 000 – Strugë nr. 03-1196/11 të datës 04.07.2018.

4. AUDI A6 me targa regjistrimi SU-5554-AC me karakteristika vijues:

Të dhëna për automjetin	Çmimi fillestar i vlerësuar në denarë	Garancia bankare 2%	Hapi minimal	Orë/ fillimi
- Automjeti motorik marka AUDI - Shenja regjistruese: SU-5554-AC - Regjistrimi i parë:13.06.2011 - Viti i prodhimit: 2011 - Marka:AUDI - Lloji: 4G - Shenja komerciale:A6 - Numri identifikues i automjetit :WAUZZZ4G4CN020782 - Kategoria dhe lloji i automjetit: M1 PATNICKO - Forma dhe qëllimi i karoserisë: AA LIMUZINA - Lloji i motorit, siç është shënuar në motor CDU - Fuqia e motorit 180 kw - numri i ulëseve: 5 - /lloj i karburantit: dizel - numri identifikues i motorit : 23241 - Ngjyra: e zezë 20	1.076.250,00	21.525,00	Pa kufizim	Ora 13:00

Çmimi fillestar i sendit të luajtshëm është vlera e vlerësuar i të njëjtit theksuar në pasqyrën tabelore.

Çmimi për shitjen e sendit të luajtshëm është përcaktuar në bazë të Raportit për vlerësim të mjetit transportues përpiluar nga ana e NT. JETA 000 – Strugë nr. 03-1196/12 të datës 04.07.2018.

5. FIAT SCUDO me targa regjistrimi SU-1018-AB me karakteristika vijues:

Të dhëna për automjetin	Çmimi fillestar i vlerësuar në denarë	Garancia bankare 2%	Hapi minimal	Orë/ fillimi
-Automjeti motorik marka -: FIAT - Shenja regjistruese: SU-118-AB - Regjistrimi i parë: 09.06.2008 - Viti i prodhimit: 2008 - Shenja komerciale:FIAT SCUDO - Numri identifikues i automjetit : ZFA27000064179223 - Kategoria dhe lloji i automjetit: M1 PATNICKO - Forma dhe qëllimi i karoserisë: AC-KOMBI - Lloji i motorit, siç është shënuar në motor :RHK - Fuqia e motorit 88 kw - numri i ulëseve : 9 - lloj i karburantit: dizel - numri identifikues i motorit : 4309653 - Ngjyra : E GJELBËRT METALIKE 8C	123.000,00	2.460,00	Pa kufizim	Ora 14:00

Çmimi fillestar i sendit të luajtshëm është vlera e vlerësuar i të njëjtit theksuar në pasqyrën tabelore.

Çmimi për shitjen e sendit të luajtshëm është përcaktuar në bazë të Raportit për vlerësim të mjetit transportues përpiluar nga ana e NT. JETA 000 – Strugë nr. 03-1196/14 të datës 08.11.2018.

1. DATA E MBAJTJES SË ANKANDIT PUBLIK

Ankandi elektronik publik do të mbahet më 03.12.2018 me fillim në ora 10.00 në ueb faqen e internetit www.e-stvari.mk

2. TË DREJTË PJESËMARRJEJE

Të drejtë pjesëmarrjeje në ankandin elektronik publik kanë të gjithë personat e interesuar fizik dhe juridik vendas dhe të huaj të cilët mund të arrijnë pronësi të sendeve të luajtshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin dhe të cilët i plotësojnë kushtet e dhëna në shpallje.

Personat e interesuar mund të marrin pjesë me parashtrimin e Fletëparaqitjes për pjesëmarrje.

Shqyrtim të automjetit personat e interesuar do të mund të kryejnë çdo ditë pune në kohëzgjatje të shpalljes në periudhë prej orës 10.00 deri në ora 15.00 në rrethin e Komunës së Strugës.

Kontakt personi: Faruk Vinca – 071 244 100.

3. KUSHTE PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN ELEKTRONIK PUBLIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrojnë në mënyrë elektronike fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankand publik, e cila duhet të përmbajë të dhëna dhe dëshmi përcaktuar në shpallje.

Vërejtje: *Që të mund të parashtrojë fletëparaqitje për pjesëmarrje së bashku me dëshmitë e përcaktuara në shpallje çdo person fizik dhe juridik duhet paraprakisht të regjistrohet në faqen www.e-stvari.mk . Nëse ofertuesi ka marrë pjesë në procedurat pas shpalljeve paraprake dhe ankande të realizuara elektronike publike realizuar përmes sistemit për të vlejnë ende emri shfrytëzues automatik i ndarë dhe shifra – nga pjesëmarrja në procedurë të cilën e ka realizuar në çfarëdo komunë.*

Dëshmitë të cilat nevojitet të dorëzohen ndaj fletëparaqitjes për ankand elektronik publik, personi i regjistruar është i obliguar t'i vendos në sistem në kopje të skanuar në origjinal në format PDF, dhe atë:

1. Deklaratë për pranimin e kushteve të cilat janë dhënë në shpallje
2. Garanci bankare për seriozitetin e ofertës në lartësi prej 2% nga vlera e vlerësuar të sendit të luajtshëm, për pjesëmarrje në ankand publik. Përpos formës elektronike, garancisë bankare për seriozitetin e ofertës duhet në formë të shkruar (në origjinal) të dorëzohet në adresën e Komunës së Strugës dhe atë sheshi "Nënë Tereza" pn. ose në Arkivin e Komunës më së voni deri më 30.12.2018 deri në ora 12.00, me shenjë për Komisionin për realizimin e procedurave për shitje dhe dhënie me qira të sendeve të paluajtshme, procedura për shitjen e sendeve të luajtshme dhe procedurë për furnizim zë sendeve të paluajtshme të Komunës së Strugës.
   Mosdorëzimi i garancisë bankare në formë të shkruar deri te Komisioni e bën fletëparaqitjen të papranueshme dhe e njëjta do të refuzohet.
3. Dëshmi për identitetin për persona juridik

- Gjendja rrjedhore nga Regjistri qendror i RM-së – jo më e vjetër se gjashtë muaj (për personat juridik vendas) ose certifikatë nga regjistri adekuat (për persona juridik të huaj)

4. Për persona fizik

Kopje nga letërnjoftimi ose nga dokument udhëtimi.

5. E-mail adresë të parashtruesit së fletëparaqitjes përmes të cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankand elektronik publik, respektivisht do t'ju dërgohet emër shfrytëzuesi dhe shifër për qasje në faqen www.e-stvari.mk ku do të mbahet ankandi elektronik publik.

4. Komisioni pas pranimit të fletëparaqitjeve përcakton a janë dorëzuar në afat të përcaktuar dhe a janë kompletuar në pajtim me kushtet e shpalljes me çka i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike.

5. AFATI PËR DORËZIMIN E FLETËPARAQITJEVE

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankand publik është deri më 29.11.2018.

6. GARANCIA BANKARE

Garancia bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankand publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga mbajtja e ankandit publik, kurse garancia bankare i ofertuesit më të përshtatshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme arritur në ankand publik.

Garancia bankare duhet të jetë dhënë në valutën maqedonase, nga banka e cila punon dhe kryen aktivitet bankar në Republikën e Maqedonisë, kurse kohëzgjatja e garancisë bankare duhet të jetë me afat deri më 29.11.2018

7. PROCEDURA

Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të automjetit dhe realizohet në bazë të ankandit nga ana e pjesëmarrësve. Ankandi publik do të mbahet edhe nëse pas Shpalljes paraqitet vetëm një pjesëmarrës i cili i plotëson kushtet e dhëna në shpallje dhe e oferton çmimin fillestar.

Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë respektivisht rritet çmimi i automjetit. Ankandi publik llogaritet si e përfunduar në momentin e përfundimit të kohës përcaktuar në shpallje, gjatë të cilit nëse gjatë përfundimit të dy minutave të fundit nga orari i përcaktuar për zgjatjen e ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ofertë, afati i fundit për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për një minutë kurse do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të fundit nuk ka ofertë të re. Ankandi publik vazhdon pa kufizim, deri në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re.

Nëse në pesë minutat e para nga ankandi publik nuk është pranuar oferta, respektivisht nuk është dhënë ofertë më të lartë nga pjesëmarrësi i ankandit publik, vlera e sendit të luajtshëm zvogëlohet për 2% nga vlera e vlerësuar me çka pjesëmarrësit e ankandit publik përsëri kanë mundësi ta pranojnë respektivisht zmadhojnë çmimin e automjetit pa u kufizuar hapi minimal i zmadhimit. Nëse pas përfundimit të dy minutave të fundit prej pesë minutave të dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, gjegjësisht është dhënë ofertë më të lartë, afati i fundit për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, kurse do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave vijuese nuk ka ofertë të re. Nëse në kohëzgjatje prej 5 minutave përsëri nuk ka ofertë, vlera e sendit të luajtshëm përsëri zvogëlohet për 2 % nga vlera e parë e vlerësuar.

Për ofertues më të përshtatshëm llogaritet pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ofron çmim të fundit i cili përfaqëson çmim më të lartë për shitjen e sendit të luajtshëm.

Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon Procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili e dorëzon tek të gjithë pjesëmarrësit e ankandit publik.

Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjidhje është i obliguar t'i paguajë mjetet në pajtim me çmimin e arritur të fundit për automjet në llogarinë e Komunës së Strugës, por nëse nuk i paguan në këtë afat nuk do të qaset ndaj lidhjes së kontratës, garancia bankare do të aktivizohet, kurse ofertuesi në periudhë prej një viti nuk do të mund të merr pjesë në çdo ankand të ardhshëm publik për sendin e luajtshëm në fjalë.

Me ofertuesin më të volitshëm në afat prej 15 ditëve të punës pas pagesës së kryer të çmimit të automjetit, lidhet Kontratë për shitjen e sendit të luajtshëm. Kontrata në afat prej 30 ditëve blerësi e dorëzon tek noteri për shkak të evidentimit të të njëjtit. Obligimi për shpenzimet e vërtetimit të Kontratës janë në barrë të blerësit.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë kundërshtimi vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri te Komisioni i cili vendos sipas kundërshtimit me Aktvendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i kundërshtimit.

Nr. 03-1196/15
19.11.2018

Komisioni për realizimin e procedurave për shitje dhe dhënie me qira të sendeve të paluajtshme, procedurës për shitjen e sendeve të luajtshme procedurë për furnizim të sendeve të paluajtshme të Komunës së Strugës

MIRA MEKSI SJELL LIBRIN ME NOVELA E TREGIME "HAKMARRJA E KAZANOVËS"

Ata që e njohin Mira Meksin e dinë se rimarrja e miteve, legjendave, figurave dhe historive nga Spanja e Venecia magjike nuk është diçka e re. Por, këtë herë ajo e josh publikun shqiptar me "Kazanovën".

Edhe pse njihet më së shumti si romanciere, në këtë panair të 21 të librit, Mira Meksi guxon me tregimet e shkurta dhe novelën e "Kazanovës".

Mesazhi që fshihet pas kësaj vepre e lidh atë edhe më shumë me autorin që ajo ka përkthyer.

Në panairin e librit, autorja mblodhi rreth vetes dhjetëra dashamirës të letërsisë që ajo kultivon.



KUJTIMET E MICHELLE OBAMA-s, DITA E PARË ME 725.000 KOPJE TË SHITURA

Qarkullimi i librit u rrit nga 1.8 në 2.6 milion kopje, dhe kujtimet e zonjës së parë të Shteteve të Bashkuara tashmë janë përkthyer në tridhjetë gjuhë. Libri i Michelle Obamta-ës me kujtime – "Becoming", pati 725,000 kopje të shitura që në ditën e parë, duke e bërë kështu një nga librat më me dinamikë të lartë shitjeje të këtij viti në SHBA, raportoi AP.
Shtëpia botuese Agjencia Croën Publishing se ndërkohë qarkullimi i librit u rrit nga 1.8 në 2.6 milion kopje.
Michelle Obama shkruan për fëmijërinë, kolegjin, racizmin, martesën me Barak Obamën dhe vajzat e tyre. Paralel me botimin amerikan, "Kujtimet" e Michelle Obama-s tashmë janë përkthyer dje në tridhjetë gjuhë. Një milion kopje do t'i dhurohen organizatës jofitimprurëse First Book. Këtë vit, shitjet më të mëdha që në ditën e parë me rreth 900.000 kopje, i kishte vetëm libri "Frika – Trump në Shtëpinë e Bardhë" i Bob Woodward.

VEPRA E YLBER HYSËS ËSHTË ORIGJINALE DHE JOKONVENCIONALE

Libri "Shqiptarët dhe të tjerët: nga Madona e Zezë deri te Molla e Kuqe" i historianit Ylber Hysa do duhej të ishte libër i obligueshëm për të gjithë studentët shqiptarë të historisë.



Oliver JENS SCHMITT

Në shumë pika, Hysa shkruan ndryshe nga shkenca e zakonshme shqiptare Historiografia shqiptare në Evropën Juglindore njeh një rend temash të përhershme të cilin e ndjekin shumica e historianëve deri më sot. Prandaj të befasuar marrim në dorë një libër që përpiqet të ecë rrugëve të reja dhe që qëllimisht rrok tema jokonvencionale. Ylber Hysa ka shkruar një vepër, e cila ofron një përzgjedhje interesante të trajtesave.

Ai merret me çështjen e herezisë dualiste dhe heterodoksisë në Shqipërinë mesjetare (të cilën flamurtarët e ateizmit në Shqipërinë e Enver Hoxhës me qejf e përmendin si argument historik për distancën e shqiptarëve ndaj dy kishave); vijon pastaj një punim për Stećci-n, (formë mesjetare e gurëve të varrit, v.j.), thelbi i veprës i kushtohet popullsisë me prejardhje afrikane të Ulqinit; mandej autori ndjek "gjurmët e ortodoksisë te shqiptarët e Maqedonisë"; "Sinan Pasha dhe shafrani në Kaçanik" përbën objektin e kapitullit pasues; dy kapitujt e fundit rrokin titullin e librit – "Madona e zezë në Kosovë" dhe "Molla e kuqe".

Në fillim Hysa paraqet mendimet e tij metodologjike. Me këtë rast ai fillimisht i qaset prezantimit të historisë shqiptare nga ata historianë serbë dhe bullgarë, të cilët shqiptarët i shihnin kryesisht si malësorë pa histori, të cilët jetonin në katërkëndëshin e konstruktuar nga albanologu kroat Milan Shuflaj, Shkodër-Prizren-Ohër-Vlorë, përtej rrugëve të mëdha.

Lidhur me fjalinë se "çfarë është për grekët deti dhe për sllavët rrafshina, për shqiptarët janë malet", Hysa flet për një pikëpamje "horizontale". Paraqitja e hulumtimeve serbe është e diferencuar, pasi që Hysa nuk merr qëndrim vetëm kundër autorëve nacionalistë, por thekson edhe punimet e shkencëtarëve nga Ilarion Ruvarac deri te Olga Zirjoviq.

Një pikëpamje "vertikale" Hysa e konstaton në anën e historiografisë shqiptare, e cila, sipas tij, niset nga prania pothuaj e përhershme "metafizike" iliro-shqiptare në viset që sot banohen nga shqiptarët dhe "përtej tyre".

Këtu ai përpiqet të qëmtojë elemente dinamike në imazhin statik të historisë. Në shumë pika, Hysa shkruan ndryshe nga shkenca e zakonshme shqiptare: kjo bëhet e qartë në shembullin e popullsisë zezake dhe shqipfolëse në portin e piratëve në Ulqin. Si duhet të kategorizohet ajo?

Nga njëra anë është krenaria mbi të kaluarën e qytetit, i cili në Epokën e re të hershme përbënte një qendër të pashembullt piratësh në Adriatik, nga ana tjetër paqartësia, e cila krijohet nga përkatësia kombëtare që bazohet në prejardhje, kur ajo përballet me fenomenin e afrikanëve albanofonë.

Fakti që një historian merret me të kaluarën osmane përtej kryengritjes dhe represionit po ashtu duhet të vihet në dukje: Hysa është njëri prej historianëve të parë shqiptarë që hulumton një temë të kulturës materiale, fjala është për shafranin e rëndësishëm në periudhën osmane dhe të njohur në mbarë Evropën juglindore, i cili mbillej në Kosovë.

Gjatë trajtimit të Stećci-t boshnjak, Hysa mban anën e atyre shkencëtarëve, të cilët ato nuk i shohin si dëshmi të Kishës Boshnjake, por si monumente të lashta ballkanike – më saktë ilire. Referencat ndaj mendimtarëve të njohur vërehen edhe gjatë trajtimit të ortodoksëve shqiptarë të ritit sllav.

Zakonisht në shkencën shqiptare dhe në historiografinë shqiptare ortodoksia kufizohet në Shqipërinë e sotme jugore, e cila deri në shekullin 20-të ka ndjekur ritin grek. Sa i përket Kosovës mesjetare, përkatësia e shqiptarëve ndaj ritit ortodoks hidhet poshtë me vërejtjen se të gjithë, ose shumica e shqiptarëve të krishterë paskëshin ndjekur ritin romak.

Edhe atëherë kur hulumtohet çështja e ortodoksëve albanofonë të ritit sllav (Pejë dhe Ohër), vështrimi jo përherë është i çliruar nga shtesat nacionale; thuhet se ky grup i ortodoksëve dalëngadalë edhe gjuhësisht i ishte përshtatur shumicës sllave, në rastin konkret asaj maqedonase, kështu që pastaj portat janë të hapura për teorinë se disa, shumë ose të gjithë – varësisht nga orientimi politik – ortodoksët maqedonas të një rajoni të caktuar qenkan "në fakt" ortodoksë të asimiluar albanofonë, ose edhe më mirë: shqiptarë ortodoksë.

Hysa sjell shembuj interesantë për shkrimin e shqipes me alfabet cirilik (shënim varri i Andçes, i biri i Duko-s, në Tetovë) dhe tërheq vëmendjen te publicisti Josif Bageri nga Reka, i cili ishte botues i revistës "Shqypeja e Shypënis/Albanski orel" në Sofje.

Për Hysën, asimilimi i shqiptarëve ortodoks është një "dëm kolateral" i krijimit të shtetësisë maqedonase dhe identitetit nacional maqedonas. Kësaj ai ia kundërvë traditën shqiptare të identitetit mbifetar. Grupin e ortodoksëve shqiptarë të maqedonizuar ai e sheh në fushën e tensionuar të "asimilimit të plotë ose ruajtjes së trikonfesionalitetit". /gazetametro.net

VIZAT PËRBALLË SKEPTICIZMIT TË BE-së

Aktiviteti i shtuar i autoriteteve të Kosovës për lobim, për marrjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e vendit, vjen pas skepticizmit të shfaqur nga vende të caktuara të Bashkimit Evropian për një vendim pozitiv për Kosovën lidhur me liberalizimin e vizave

Autoritetet e Kosovës, janë duke i shfrytëzuar javët e fundit për të lobuar që çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën të jetë pjesë e agjendës së takimit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian, i cili pritet të mbahet në dhjetor të këtij viti. Paraprakisht, po ashtu, në fillim të dhjetorit, pritet që në Kosovë të qëndrojë Komisioneri për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, i cili do të diskutojë me autoritetet në Prishtinë për zbatimin e reformave për integrim në BE.

Aktiviteti i shtuar i autoriteteve të Kosovës për lobim, për marrjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e vendit, vjen pas skepticizmit të shfaqur nga vende të caktuara të Bashkimit Evropian për një vendim pozitiv për Kosovën lidhur me liberalizimin e vizave. Ministrja e Integrimit Evropian e Qeverisë së Kosovës, Dhurata Hoxha, e cila aktualisht është në një turne lobues në disa prej vendeve të BE-së, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë duke u bërë përpjekje që t'i bindin ato shtete që kanë hezitime për një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas saj, hezitimet e tilla më shumë kanë për bazë rrethanat e brendshme politike të vendeve të caktuara, para zgjedhjeve të cilat do të mbahen në Bashkimin Evropian, në vitin e ardhshëm.

"Shumë prej shteteve janë shumë përkrahëse. Por, në anën tjetër, disa prej shteteve të mëdha, janë më hezituese, jo për shkak të Kosovës, por për shkak të rrethanave të tyre të brendshme. Ne, për shkak të marrëdhënieve tona të punës, komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të përditshëm që e kemi me këto shtete, nuk do të doja t'i përmend emrat, sepse ne ende jemi duke punuar me këto shtete që të formësojnë pozicionin e tyre për të na mbështetur. Shpresojmë që këto pak javë që na kanë mbetur, edhe këto shtete do ta kuptojnë rëndësinë e vendimmarrjes dhe që Kosova nuk është argument që do të ndikojë në një mënyrë ose tjetër në politikat e tyre të brendshme", tha ministrja Dhurata Hoxha.

Taulant Kryeziu nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK), më herët pati thënë për Radion Evropa e Lirë se gatishmëria e shteteve të BE-së për një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën, është duke u zbehur. "Në votimin e fundit për liberalizim të vizave për Kosovën është parë hezitim nga Gjermania, Franca dhe Holanda, por ky numër i shteteve tani ka kaluar në 10 apo 12 shtete", thekson Kryeziu.

RRITJA E SKEPTICIZMIT

Skepticizmin për një vendim pozitiv të Këshillit të Ministrave për liberalizimin e vizave për Kosovën, e pati shtuar deklarata e kancelarit të Austrisë, Sebastian Kurtz. Gjatë vizitës në Prishtinë, me 6 nëntor, Kurtz, pati theksuar që lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën, ka pasur vendime pozitive nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian. Ai tha se pritet edhe vendimi i Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian, por, sipas tij, brenda BE-së ka vende që janë skeptike në këtë drejtim. "Ende ka shtete të BE-së që janë shumë skeptike sa i përket liberalizimit të vizave", pati thënë Kurtz.

Një ditë pas deklaratës së kancelarit Kurc lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën, kryetari i kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, theksoi që nuk do të ndalet së lobuari për liberalizimin e vizave dhe se në të njëjtën kohë do të jetë edhe më i zëshëm në të drejtën e qytetarëve të Kosovës për të lëvizur pa viza në Evropë. "E drejta na takon që në dhjetor të merret vendimi i Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave, ndryshe - ky tash është qëndrimi im politik - është racizëm. Është racizëm i skajshëm", ka thënë Veseli. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, më 8 nëntor, paralajmëroi se ka hezitime që çështja e liberalizimit të vizave të vendoset në agjendën e takimit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian.

"Jemi duke punuar që të hyjmë në rend të ditës. Është dramatizuar. Ka edhe emocione, ka edhe tensione. Është e kuptueshme sepse tema është e tillë, sepse kur vjen deri te vendimi, dramatizohen gjërat. Unë nuk dua të dal më optimist se që duhet, por unë besoj që kemi mundësi reale që të hyjmë në rend të ditës. Nëse hyjmë në rend të ditës, nuk mund të ketë votë negative, sepse e dimë që e kemi votën për liberalizim", pati thënë Haradinaj. Ndërkaq, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë më herët në një intervistë për Radion Evropa e Lirë që në rast se Bashkimi Evropian nuk merr një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave, atëherë duhet shqyrtuar një lloj politike të kushtëzimit për dialogun me Serbinë. Sipas tij, Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret, të cilat BE-ja ia ka vënë Kosovës për liberalizimin e vizave.

"Nëse Bashkimi Evropian nuk është në gjendje të përmbushë premtimet e tija në raport me liberalizimin e vizave... atëherë, pse do të duhej t'i besojmë BE-së që do të ketë instrument që ta bindë Serbinë që ta njeh Kosovën. Duhet të jemi realist në një qasje të tillë", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj.

KOHA PËR T'I BINDUR VENDET E BE-SË

Lidhur me mundësinë që gjatë këtij viti të mos ketë ndonjë vendim pozitiv për liberalizimin vizave për Kosovën, ka reaguar edhe raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon. Në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë, ajo ka shprehur shqetësimin për zhvillimet dhe deklaratat lidhur me liberalizimin e vizave, siç ishte ajo e kancelarit austriak Kurz. "Është e papranueshme sesi disa politikanë po mundohen që të politizojnë edhe më tutje procesin, duke imponuar kushte të reja dhe në këtë mënyrë të vonojnë heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës", ka thënë Fajon. Ajo e ka quajtur të padrejtë faktin se janë plotësuar të gjitha kushtet nga ana e Kosovës, megjithatë Bashkimi Evropian nuk po vepron.

Ndërkaq, raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Soltes ka thënë se "nuk duhet lejuar që të ketë aparteid me vizat për Kosovën". Ai, megjithatë, ka shfaqur shpresën që kjo çështje do të jetë në agjendën e Këshillit të Ministrave në dhjetor të këtij viti.

"Padyshim se deri atëherë ka ende kohë për t'i bindur vendet anëtare për rëndësinë e garantimit të Kosovës dhe qytetarëve të saj, për mundësinë e liberalizimit të vizave", ka theksuar Soltes. Në anën tjetër, njohësit e integrimeve evropiane, muaj më parë kanë theksuar se zgjedhjet që do të mbahen vitin e ardhshëm në Bashkimin Evropian, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në gjithë vendimmarrjen e BE-së, përfshirë edhe çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Jehona Lushaku, njohëse e çështjeve të integrimeve evropiane ka theksuar më herët që një vendim vendimtar nga këshilli i Ministrave për liberalizim të vizave do të jetë i vështirë për shkak të pasojave që vendet anëtare të BE-së mund t'i kenë nga ky vendim, në zgjedhjet e ardhshme në BE. "Secili shtet kalkulon që vota e tij 'për', mund të jetë një argument më shumë për partitë populiste të tyre, që gjatë zgjedhjeve ta përdorin këtë vendim si argument që është rritur migracioni, për të cilin thuhet që është një prej problemeve kryesore në BE, momentalisht", thekson Lushaku.

Njohësit e integrimeve evropiane kanë shprehur mendimin që pa një konsensus të shteteve të mëdha brenda BE-së,shtyrja përpara e agjendës së procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën, është e vështirë. Megjithatë, sipas tyre, autoritetet në Kosovë mund t' ia lehtësojnë vendimmarrjen vendeve të Bashkimit Evropian. Ministrja e Integrimit Evropian, Hoxha, thotë se institucionet e Kosovës, në përgjithësi, nuk kanë hequr dorë nga kërkesa që çështja e vendimmarrjes për liberalizimit të vizave për vendin të vendoset në agjendën e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian.

Sidoqoftë, që nga viti 2010, përfaqësuesit politik dhe institucional të Kosovës, në vazhdimësi kanë premtuar liberalizimin e vizave për qytetarët e vendit, duke përcaktuar edhe data dhe afate të shkurta. Megjithatë, rekomandimi pozitiv për liberalizimin e vizave nga Komisioni Evropian, erdhi në korrik të këtij viti, ndërkaq, votimit në favor të liberalizimit nga Parlamenti Evropian, në muajin shtator. Sfida kryesore në këtë proces për Kosovën mbetet në Këshillin e Ministrave, ku ministrat e Brendshëm të vendeve anëtare të BE-së, i japin vlerësimet e tyre.

KOSOVË-SHQIPËRI MARRËVESHJE PËR HEQJEN E ROAMINGUT

Operatorët e telekomunikacionit në Shqipëri e Kosovë nuk i rezistojnë presionit të BE-së për mosnënshkrimin e marrëveshjes për uljen, deri në heqjen e plotë, të tarifave të roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor. Me nismën e BE-së, kjo rezistencë duket se është thyer dhe, së shpejti, qytetarët e Ballkanit Perëndimor do të mundë të komunikojnë brenda të gjithë kësaj hapësire pa paguar tarifa roaming shtesë. Muajin e ardhshëm pritet të finalizohet marrëveshja për uljen, deri në heqjen e plotë, të tarifave të roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja do të prezantohet në Sesionin Plenar të Grupit të Autoriteteve Rregullatore Europiane (BEREC) që do të zhvillohet në muajin dhjetor.

MAY KËRKON NDIHMË

Kryeministrja britanike do të udhëtojë këtë javë për në Bruksel, për të diskutuar me BE për marrëdhëniet ekonomike pas Brexitit. Kundërshtarët e Theresa Mayt në ishull vazhdojnë të jenë në pozita lufte

"Një ndërrim në lidership nuk i bën negociatat aktuale më të lehta dhe nuk ndryshon gjë në aritmetikën parlamentare", deklaroi Theresa May në intervistë te Sky News. Ajo edhe mund t'u kishte thënë Brexitasve të vijës së ashpër në partinë e saj: bëni çfarë të doni, por jeni ju që e trashëgoni rrëmujën. Dhe njëkohësisht kryeministrja bëri të ditur se ka në plan që të kthehet që këtë javë në Bruksel, për të negociuar atje më tej me shefin e Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker.

MARRËVESHJA ËSHTË MARRËVESHJE, POR...

May foli për negociata në vazhdim me BE dhe ajo e përdor këtë formulim për të zbutur kritikët e saj në kabinetin qeveritar britanik. Një grup i kritikëve të saj kërkon që ajo të vazhdojë edhe më tej përpjekjet për t'i marrë lëshime Brukselit. Por May e di se kjo nuk ka shanse, sepse si qeveria franceze, ashtu edhe kancelarja Angela Merkel në Berlin e kanë bërë të qartë, se marrëveshja nuk do të rinegociohet më. Pra ajo që kërkon kryeministrja britanike janë disa bonbone, të cilat në metrat e fundit para takimit të nivelit të lartë të BE të dielën e ardhshme mund të futen ende në të ashtuquajturën "deklaratë politike". Në të skicohet, si e përfytyron BE raportin midis të dyja palëve pas Brexitit.

Është fjala për një dokument me shtatë faqe, në të cilin me viza hyrëse deri tani janë përshkruar vetëm temat për negociatat e mëvonshme. Marrëdhëniet e ardhshme tregtare për shembull do të zhvillohen mbi bazën e një bashkimi doganor, siç janë përcaktuar tashmë si siguri për Irlandën e Veriut në marrëveshjen e ndarjes. Këtu May mund të përpiqej që të marrë premtime më konkrete nga BE, për të mundur që ta shesë me ndihmën e tyre më mirë paketën në Britaninë e Madhe.

Njëra nga kritikat kundër marrëveshjes është që Britania e Madhe po e blen derrin në thes, përsa i përket raportit të ardhshëm. Por kjo nuk do të ndryshojë në mënyrë rrënjësore. Deklarata politike nuk është e detyrueshme nga ana juridike. Qeveritë e BE mund ta ndryshojnë mendimin e tyre më vonë në çdo kohë. Sepse deri tani kanë qenë të preokupuar vetëm me ndarjen, negociatat e vërteta për të ardhmen ende nuk kanë nisur. Ato do të zhvillohen vetëm pas Brexitit dhe ndoshta do të zgjasin me vite.

EDHE MË TEJ E ARDHME E PASIGURT

Thuajse nuk ekzistojnë shanse, që Theresa May të arrijë në Bruksel lëshime që ia vlen t'i përmendësh. Po të arrihet me të vërtetë të formohet grupi për mocionin e votëbesimit brenda partisë së saj, ithtarët e vijës së ngurtë mund të vepronin që në fillim të javës. Besohet se May votimin vërtet mund ta mbijetojë politikisht, por kundërshtarët e saj besojnë që ajo do të dëmtohet rëndë.

Pengesa vendimtare është parlamenti, ku aktualisht nuk ka shumica për një marrëveshje. Shefi i laburistëve, Jeremy Corbyn bëri të ditur sërish të dielën se partia e tij do të votojë kundër. Të njëjtën gjë ka thënë partia skoceze SNP, disa liberalë dhe deri më sot edhe DUP irlandezoveriore. Po t'i shtosh këtyre edhe disa dyzina mbështetësish të vijës së ashpër, në këtë gjendje duket thuajse e pashpresë që marrëveshja të miratohet në parlament. *(DW)*



Trumpi vlerëson vetveten!

Pothuajse në gjysmën e mandatit të tij katërvjeçar në Shtëpinë e Bardhë, Presidenti Donald Trump thotë se e sheh veten në mesin e presidentëve më të mirë amerikanë. "Do t'i jepja vetes një A +," tha Trump në një intervistë me Fox News Sunday. "A mund të shkoj më lart se kaq?" Por presidenti Trump, në një intervistë të regjistruar në Shtëpinë e Bardhë, të premten dhe të transmetuar të dielën, pranoi një gabim në gjykim, duke thënë se duhet të kishte shkuar të hënën e kaluar në Varrezat Kombëtare të Arlingtonit për të përkujtuar Ditën e Veteranëve duke nderuar ata që kanë shërbyer në forcat e armatosura amerikane ose që shërbejnë aktualisht në një nga degët e saj ushtarake."Në retrospektivë, duhet të kisha shkuar," i tha presidenti Trump intervistuesit Chris Wallace. Udhëheqësi amerikan, i cili ende nuk ka vizituar trupat në ndonjë zonë lufte jashtë vendit, tha gjithashtu, "Ka gjëra që po planifikohen, do ta bëj këtë." Ai nuk pranoi të komentonte se kur mund të ndodhte një vizitë e tillë për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Në zgjedhjet e 6 nëntorit për në kongres, demokratët e opozitës morën kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve për herë të parë në tetë vjet dhe fituan garat për guvernatorë në shtetet industriale që ishin të rëndësishme në zgjedhjet presidenciale në vitin 2016. Por presidenti Trump nuk pranoi fajësinë për humbjet, sepse emri i tij nuk ishte personalisht në fletëvotime, edhe pse ai tha në disa tubime politike përpara zgjedhjeve se votuesit duhet t'i vlerësonin zgjedhjet si një referendum për politikat dhe ecurinë e punës së tij gjatë 22 muajve të parë të presidencës.

Kryengritësit huthi ndalin luftimet në Jemen

Rebelët huthi në Jemen kanë thënë se do të ndalin sulmet raketore dhe ato me dronë ndaj koalicionit të udhëhequr nga sauditët, pas një kërkese të Kombeve të Bashkuara. Ky hap vjen pasi koalicioni ka urdhëruar ndaljen e ofensivës në portin kyç të Jemenit, Hudajdah. Kombet e Bashkuara janë duke synuar që përmes negociatave t'i japin fund luftës që ka shkaktuar krizën më të rëndë humanitare në gjithë botën. Në këtë konflikt janë vrarë më shumë se 10.000 persona dhe miliona të tjerë përballen me varfëri. Lideri i Komitetit Suprem Revolucionar të rebelëve huthi, Mohammed Ali al-Huthi, ka thënë se vendimi për të ndalur luftimet është marrë "pas kontakteve me të dërguarin e OKB-së", Martin Griffiths. Në deklaratë është thënë se huthit e mbështetur nga Irani janë të gatshëm për të negociuar armëpushimin në rast se "koalicioni i sauditëve dëshiron të ketë paqe".

Bllokada e Gazës turp për gjithë njerëzimin

"Mendoj se Netanyahu është gjëja më e keqe që u ka ndodhur Izraelit dhe palestinezëve", ka thënë ish-nënkryetarja e Parlamentit Evropian, Morgantini

Ish nënkryetarja e Parlamentit Evropian, Luisa Morgantini deklaroi se bllokada izraelite ndaj Gazës paraqet turp të vërtetë për gjithë njerëzimin. "Izraeli kryen krime çdo ditë dhe duhet të nxirret para Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë, sepse më shumë se 50 vite mban nën pushtim territorin palestinez", tha ish nënkryetarja e PE-së, Morgantini.

Politikanja italiane në një prononcim për Anadolu Agency (AA) shprehu shpresën se komuniteti ndërkombëtar do të arrijë të vendosë paqe dhe t'i japë fund masakrës ndaj banorëve të enklavës palestineze, Gaza. Duke theksuar se situata e tanishme është turp për mbarë komunitetin ndërkombëtar, Morgantini tha se është e papranueshme që Izraeli të paraqitet si viktimë dhe të mos hetohet për krime. "Shpresoj se komuniteti ndërkombëtar do të mund të ndryshojë qasjen dhe të dëgjojë nevojat e palestinezëve. Konsideroj si të domosdoshëm bashkimin e palestinezëve dhe të mos lejojnë Izraelin të luaj me ta në saje të përçarjes së tyre", tha Morgantini. Ajo akuzoi Izraelin për ndërtimin e një shoqërie me një nacionalizëm të rritur, racizëm dhe diskriminim. Morgantini veçanërisht kritikoi politikën e keqe të kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu, të cilin e konsideron si fajtorin kryesor për zvarritjen e procesit të paqes në Lindjen e Mesme.

"Mendoj se Netanyahu është e keqja më e madhe që ka mund t'u ndodhë Izraelit dhe palestinezëve", ka thënë Morgantini. Në fund ajo tha se nuk është e sigurt nëse largimi i Netanyahut nga pushteti do të ndryshojë situatën në terren, dhe i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar të intervenojë që palestinezët përfundimisht të bëhen një popull i lirë. "Komuniteti ndërkombëtar duhet të dëgjojë edhe zërin e izraelitëve të cilët kundërshtojnë pushtimin dhe konsiderojnë se kjo është e dëmshme edhe për Izraelin", përfundon Morgantini.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 288/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në "Qeverinë e Republikës së Maqedonisë – Sekretariati gjeneral" për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor më i ri për përkrahje të politikave ekonomike, Njësia për politikë ekonomike, Sektori për politikë ekonomike , reforma strukturore dhe investime — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas SETK ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat ekonomike, shkencat juridike, shkencat e organizimit dhe administrim (menaxhment)
- me ose pa përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 20.987,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101V03000 Bashkëpunëtor për konkurrencë me bashkitë ndërkombëtare, Njësia për përcjellje dhe analizë të strategjive shtetërore, klimë afariste dhe koordinim të projekteve të ndihmuara nga bashkia ndërkombëtare, Sektori për politikë ekonomike, reforma strukturore dhe investime — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas SETK ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Ekonomike, Shkencat juridike, Shkencat e organizimit dhe administrim (menaxhment)
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 22.500,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

KOMUNA E BUTELIT
Nr. 09-98/14 të datës 19.11.2018
Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 163/2016 dhe 64/18), kryetari i Komunës së Butelit sjell këtë:

NJOFTIM

Njoftohen banorët dhe subjektet juridike që Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizimin e:

PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE
për projektin Arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore në pjesën nga PK 102/1, për ndërtim të objektit me klasë themelore me qëllim - G1, industri e lehtë dhe jo ndotëse (fermë për pula), në bllokun 9, nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg / përpunimi i bllokut 12/, KK Vizbeg, komuna Butel, Shkup

Hapësira e definuar për përpunimin e Projektit arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore në pjesën nga PK 102/1, për ndërtim të objektit me klasë themelore me qëllim - G2 dhe industria jo ndotëse (fermë për pula) në bllokun 9, nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg / përpunim i bllokut 12/, KK Vizbeg, komuna Butel, Shkup, është me sipërfaqe prej 2 380,13 m2 (0.23 ha).

Përfshirja e projektit është i definuar me koordinatat në vijim:

	Y	X	Z
1	7533271.29	4655793.87	295.910
2	7533288.50	4655792.40	295.795
3	7533288.54	4655816.60	296.212
4	7533271.09	4655815.91	296.318
5	7533271.02	4655827.33	296.371
6	7533290.44	4655828.83	296.449
7	7533291.11	4655839.71	296.652
8	7533291.82	4655858.23	296.992
9	7533270.35	4655856.05	296.744
10	7533270.71	4655838.73	296.574
11	7533231.33	4655837.48	296.677
12	7533231.98	4655856.72	296.962
13	7533190.79	4655853.50	296.883
14	7533192.26	4655836.59	296.645
15	7533168.83	4655836.10	296.897
16	7533154.34	4655839.71	297.168
17	7533158.49	4655855.59	297.562
18	7533153.42	4655854.80	297.157
19	7533139.51	4655865.78	297.353
20	7533138.87	4655842.95	297.307
21	7533139.53	4655823.41	297.176
22	7533143.01	4655820.34	297.025
23	7533145.81	4655829.13	296.928
24	7533154.33	4655827.36	296.875
25	7533152.83	4655818.15	296.725
26	7533161.16	4655826.49	296.876
27	7533163.27	4655821.12	296.767
28	7533175.15	4655824.37	296.664
29	7533193.77	4655826.34	296.640
20	7533207.39	4655823.58	296.543
31	7533227.42	4655823.16	296.454
32	7533228.24	4655832.00	296.577
33	7533251.58	4655822.19	296.241
34	7533250.85	4655831.14	296.437
35	7533139.60	4655803.06	296.469
36	7533152.82	4655802.06	296.234
37	7533171.22	4655798.79	296.063
38	7533199.83	4655797.58	295.990
39	7533235.18	4655795.81	295.937
40	7533256.83	4655795.33	295.877
41	7533258.05	4655815.70	296.293
42	7533230.25	4655815.53	296.403
43	7533206.58	4655815.80	296.410
44	7533169.36	4655817.32	296.656

Projekti i përpiluar Arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën e takimeve (Salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 26.11.2018 deri më 30.11.2018 (pesë ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël).

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund të parashtrojnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose në formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Lajmërimi për organizim të të anketës publike do të publikohet në mjetet e informimit, në sistemin informatik e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik projekt për formimin e parcelës ndërtuese të pjesë nga PK 102/1, për ndërtim të objektit me klasë themelore për qellim - G2, industri e lehtë dhe jo ndotëse (fermë për pula), në bllokun 9, nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg / përpunim i bllokut 12/, KK Vizbeg, komuna Butel, Shkup nga do të mbahet në lokalet e Komunës së Butelit, në Sallën e takimeve (Salla e vogël) më datë 29.11.2018 me fillim në ora 10:00.

KRYETARI I KOMUNËS
Velimir Smilevski

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), Pajtimi për punësim nga Ministria e financave nr. 18-12005/2 të datës 24.10.2018 dhe Vendimi nr. 02-2740/1 të datës 19.11.2018, drejtorët prof. dr. Katarina Stavriq dhe m-r Ridvan Ibraimi të IPSH Klinika Universitare për sëmundje të fëmijëve - Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

për punësim të 40 (dyzet) motrave medicinale, 1(një) teknik farmaceutik dhe 5 (pesë) teknik laborantë për kohë të pacaktuar

1. IPSH Klinika Universitare për sëmundje të fëmijëve - Shkup ka nevojë për punësimin e:
1.1- 40(dyzet) motrave medicinale,
1.2- 1(një) teknik farmaceutik dhe
1.3- 5(pesë) teknik laborantë
2. Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
-të jetë shtetas i RM,
-të jetë i moshës së rritur,
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
-të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim:
- Kandidatët nga pika 1.1 të kenë të mbaruar arsim të mesëm të mjekësisë (profili: teknik motra medicinale),
-Kandidatët nga pika 1.2 të kenë të mbaruar arsim të mesëm të mjekësisë (profili: teknik farmaceutik) dhe
- Kandidatët nga pika 1.3 të kenë të mbaruar arsim të mesëm të mjekësisë (profili: teknik laborant)
- Provim profesional të dhënë
- me ose pa përvojë pune
4. Orari i punës është me 40 orë në javë dhe rrogë neto fillestare 19.200,00 denarë.
5. Në bashkëngjitje me fletëparaqitjen kandidatët janë të detyruar të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;
- biografi e shkurtë (CV);
- Certifikatë për shtetësi (origjinal ose kopje e vërtetuar në noter);
- Vërtetim mjekësor për aftësi të përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje e vërtetuar në noter);
- Certifikatë që nuk ka të shquar me vendim gjyqësor dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje e vërtetuar në noter);
- Dëshmi për arsim të mesëm të mjekësisë të mbaruar (profili teknik motër medicinale) për pikën 1.1
- dëshmi për arsim të mesëm të mjekësisë të mbaruar (profili teknik farmaceutik) për pikën 1.2 dhe
- dëshmi për arsim të mesëm të mjekësisë të mbaruar (profili teknik laborant) për pikën 1.3 edhe atë Dëftesat për të gjithë 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksese i arritur në SHMM për secilin vit veç e veç (origjinal ose kopje e vërtetuar në noter)
- dëshmi për provim profesional të dhënë (origjinal ose kopje e vërtetuar në noter).
6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni jo i plotë, jo i rregulluar dhe i vonuar nuk do të jetë lëndë për shqyrtim nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
8. Kandidatët e paraqitur i nënshtrohen testimit (pjesa profesionale).
9. Pas selektimit të mbaruar të kandidatëve të paraqitur për doktorë të medicinës të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim me shkrim dhe me gojë në pajtim me nenin 164-v nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
10. Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë të duhur dhe telefoni për kontakt, të parashtrohen deri tek IPSH klinika Universitare për sëmundje të fëmijëve - Shkup rr. Vodnjanska nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH klinika Universitare për sëmundje të fëmijëve - Shkup, me shkrimin "për shpalljen publike për punësim".

IPSH Klinika Universitare për sëmundje të fëmijëve - Shkup

NDESHJA NDAJ AZERBAJXHANIT ËSHTË SI FINALE PËR KOSOVËN

"Ndeshja ndaj Azerbajxhanit është si finale, dhe ndeshja më e rëndësishme për të gjithë neve si shtet. Sot ne kemi përfunduar pjesën e parë dhe e dyta është në stadiumin 'Fadil Vokrri' kundër Azerbajxhanit. Besoj se kemi përparësi me gjithë ata tifozë tonë, por prapë se prapë në fushë jemi të gjithë të barabartë", është shprehur Rashica

Përfaqësuesja e Kosovës të martën me fillim prej ora 20:45 në stadiumin "Fadil Vokrri" do të pret reprezentacionin e Azerbajxhanit , ku dhe do të jetë ndeshja e fundit e Grupit 3 në Ligën D në kuadër të Ligës së Kombeve. Kosovës i duhet fitorja ose barazimi për t'u promovuar në Ligën C, pasi aktualisht është në krye të grupit me 11 pikë, dy më shumë se Azerbajxhani, por azerbajxhanasit vijnë në Prishtinë për të fituar dhe kështu për të prishur festën e Kosovës. Mesfushori i Kosovës, Herolind Shala është shprehur i kënaqur me fitoren e thellë ndaj Maltës në udhëtim. Megjithatë thotë se tani ekipi mendon për ndeshjen vendimtare, atë ndaj Azerbajxhanit, dhe kërkon përkrahjen e tifozëve për ta vazhduar ëndrrën "Fitorja ndaj Maltës ishte shumë e bukur. Jemi të parët në grup, por tani me mendje për Azerbajxhanin. Na duhet përkrahja e tifozëve për ta vazhduar ëndrrën", ka theksuar Shala. Ylli i Werder Bremenit, Miltot Rashica thotë se përkundër fitores së thellë nuk ka kundërshtar të lehtë, e ashtu ishte edhe Malta. Rashica po ashtu shtoi se tani fokusi është te ndeshja ndaj Azerbajxhanit në "Fadil Vokrri", e kualifikimi i mundshëm do të ishte fantastike për Kosovën. "Ndeshja ndaj Azerbajxhanit është si finale, dhe ndeshja më e rëndësishme për të gjithë neve si shtet. Sot ne kemi përfunduar pjesën e parë dhe e dyta është në stadiumin 'Fadil Vokrri' kundër Azerbajxhanit. Besoj se kemi përparësi me gjithë ata tifozë tonë, por prapë se prapë në fushë jemi të gjithë të barabartë. Kualifikimi tutje do të ishte dhurata më e mirë për shtetin tonë të ri, do të ishte diçka fantastike", është shprehur ai. Edhe për trajnerin e përfaqësueses së Kosovës, Challandes sfida e ardhshme ndaj Azerbajxhanit është si një finale. "E dija qysh në fillimin se finalja do të ishte ndaj Azerbajxhanit. Ka një ekip të fortë me disa lojtarë shumë të mirë. Azerbajxhani ende e ka ëndrrën gjallë dhe mund të rrezikojë. Do të jetë shumë interesante ndeshja në Prishtinë", ka thënë ai.

Shaqiri: Nuk shqetësohem nga kritikët

Futbollisti i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, është shprehur i vendosur kundër kritikëve të tij, duke thënë se trajneri Jurgen Klopp ka besim të plotë tek ai edhe pse nuk luan tërë ndeshjen. "Shumë persona më kanë përqeshur kur u transferova te Liverpooli, pasi mendonin se nuk mund t'ia dal. Nuk kisha shumë minuta në fillim, por mbaja qetësinë. Duhet të punoja shumë, pasi e dija nga eksperienca ime te Bayern dhe Inter, andaj nuk u ndala dhe nuk do të ndalem. Do t'i shfrytëzoj minutat që m'i jep trajneri. Ai ka besim në mua dhe s'kam për çfarë të shqetësohem se ç'thonë të tjerët", është shprehur futbollisti shqiptar për mediat gjermane. Ndryshe, Shaqiri këtë sezon kaloi në radhët e Liverpulit nga skuadra Stoke City për 15 milionë euro.

Struga Trim Lum pjesëmarrëse në "Kupa Pavarësia"

Shkup, 19 nëntor - Kupa "Pavarësia" edhe për këtë vit do të zhvillohet në qytetin e Korçës. Federata Shqiptare e Futbollit, organizatorja e këtij turneu mbarëkombëtar, për te dytin edicion radhazi ka zgjedhur qytetin juglindor për organizimin e këtij aktiviteti. Pjesëmarrëse do të jenë katër skuadra: Struga Trim Lum nga Maqedonia, Otrant e Ulqinit, 2 Korriku nga Prishtina dhe Skënderbeu i Korçës. Shorti për gjysmëfinalet do të hidhet më 27 nëntor. Ndeshjet do të luhen më datë 28 nëntor në aneksin dhe stadiumin Skënderbeu. Aktiviteti fillon ne orën 11:00. Pwrndryshe ekipi futbollistik Struga Trim Lum ishte fituese e edicionit 2017 të Kupës Pavarësia. *(F.N)*

SHQIPËRI "E FASHUAR" NDAJ UELLSIT, TRI MUNGESA PËR SHKAK DËMTIMESH

Kombëtarja kuqezi e sheh veten në një tunel, në fund të të cilit nuk duket dritë. Këtë e ka pranuar sot edhe vetë trajneri Christian Panucci, i cili është kryqëzuar nga të gjitha tashmë, edhe nga tifozët në "Loro Boriçi", gjatë disfatës së fundit me Skocinë. Miqësorja e nesërme, në "Elbasan Arena", në orën 20:00, ndaj Uellsit, është një mundësi për të reflektuar. Një rezultat pozitiv ndaj Gareth Bale me shokë, sidoqoftë, nuk mund të zhbëjë sezonin e dështuar në Ligën e Kombeve, as të ndryshojë mendimin e presidentit Armand Duka, nëse e ka vendosur "t'i japë duart" Panuccit. Veç krizës psikologjike, e cila është e qartë në kampin kuqezi, për nesër rëndojnë edhe mungesat. Kjo, për shkak dëmtimesh. Më konkretisht, Ndoji, Binaku dhe Gjimshiti janë të lënduar dhe nuk do të jenë në dispozicion për miqësoren me Uellsin. Në këtë mënyrë, duhet riformatuar mbrojtja, sepse dy titullarë

të sfidës me skocezët (Gjimshiti dhe Binaku) mungojnë. Kuptohet, rikthehet Hysaj, që ishte i pezulluar për shkak kartonësh në humbjen 4-0, ndërkohë që mbetet të shihet nëse kjo miqësore do të jetë një mundësi për prurjet e reja, që nuk kanë pasur hapësirë deri më tani. Trajneri, Christian Panucci pranoi në konferencën për shtyp se është koha të ndryshojë diçka në ekip, pasi ajo çfarë ai dëshironte të arrinte nuk solli aspak sukses. Një pjesë të dështimit në Ligën e Kombeve, e sidomos humbjes së thellë të Shqipërisë në shtëpi, Panucci ia faturon edhe mungesave në formacion. I ndodhur para pyetjeve-kritike të gazetarëve, Panucci theksoi se nuk ka ndërmend të largohet pa përfunduar edhe faza e kualifikuesve të europianit. "Nëse kualifikohemi qëndroj, nëse jo largohem", u shpreh ai. Mërgim Mavraj ka dalë në konferencë për shtyp para ndeshjes që Shqipëria e zhvillon ndaj Uellsit. Kapiteni i Shqipërisë ka folur për rezultatet e dobëta por edhe për trajnerin Christian Panucci. Sipas Mavrajt, duhet që të analizojnë gjërat dhe se Shqipëria ka tjetër mundësi të kualifikohet. "Është shumë e vështir të gjesh ça mungon, është rasti të analizojmë gjërat, kemi mundësi tjetër të kualifikohemi, shqiptarët kanë treguar që në kohë të vështira janë treguar te fortë". "Futbolli nuk është vendi i duhur për të treguar trimëri, të marrësh gjithë përgjegjësitë. Në futboll tregohet në fushë, unë kam thënë gjithmonë që trajneri e ka mbështetjen tonë, jemi me të", tha Mavraj. Tutje mbrojtësi i Arisit, ka thënë se nesër ndaj Uellsit do të luajnë për Panuccin që e ka përkrahjen e lojtarëve. "Ndoshta, nesër do të luajmë edhe për trajnerin tonë. Përkrahjen tonë e ka", deklaroi Mavraj. "Kur dalim në fushë nuk është se nuk e përkrahim trajnerin, nuk luajmë as kundër e as për inat, as nuk gabojmë. Këto janë gjëra që janë pjesë e futbollit dhe nuk ka lidhje pse trajneri u largua, erdhi, ngeli. Ne mundohemi, nuk është se nuk mundohemi, ajo që ndodhi ishte ndoshta nga mbingarkimi, kishim dëshirë të madhe për të fituar, nuk mendoj se kemi luajtur kundër trajnerit apo nuk kemi bërë çfarë ka thënë trajneri. Mënyra e lojës ka ndryshuar komplet, siç kemi luajtur është nata me ditën. Nuk ka më mirë apo më keq, nuk na takon të vlerësojmë, kemi bërë ndryshim, kemi qarkulluar më shumë topin. Ka hapësira për kundërshtarin, jemi duke u fokusuar në një repart por është mënyra e lojës që ka ndryshuar. Kur bën presing, krijon hapësira dhe nuk na ndodh vetëm ne", u shpreh Mavraj.

KOMUNA E BEROVËS

DEPARTAMENTI PËR MENAXHIM ME RESURSET NJERËZORE

„Dimitar Vllahov“ nr.10, 2330 Berovë
t/f + 389(0)33 471-057 lok. 108 и 109
www.berovo.gov.mk
E-mail:so.berovo@t-home.mk

INTERCERT CERTYFIED
ISO 9001 Q - 006/2016
mk

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E BEROVËS
Numri Arkivues 04 - 3780/1
19.11.2018

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005.....120/2018), Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Berovës numër 01-1017/1 të datës 29.12.2015, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Berovës numër 01-1117/2 të datës 13.04.2016, 01-1566/2 të datës 15.16.2016, 01-2593/4 të datës 19.12.2016, 01-317/1 të datës 22.03.2017, 01-389/1 të datës 30.01.2018, 01-1868/1 të datës 01.06.2018, dhe 01-2757/1 të datës 22.08.2018 në pajtim me pëlqimin me shkrim nga Kryetari i komunës numër 08-3778/1 të datës 19.11.2018 dhe Lajmërimin për mjetet e siguruara financiare nga Kryetari i komunës numër 08-3779/1 të datës 19.11.2018, Kryetari i Komunës së Berovës publikon

SHPALLJE PUBLIKE 02/2018

Për punësim për kohë të caktuar për shkak të rritjes së përkohshme të kapacitetit të punës në Sektorin për punë juridike dhe të përgjithshme pranë Komunës së Berovës

Komuna e Berovës për shkak të rritjes së përkohshme të kapacitetit të punës, publikon shpallje publike për punësim të 2 personave për kohë të caktuar, derisa të zgjatë nevoja për institucionin, ndërsa më së shumti është për një vit për vendet e punës në vijim:

(1) Këshilltar për çështje normative jurudike dhe çështje pronësore juridike në Departamentin për çështje juridike dhe të përgjithshme, Sektorin për çështje juridike dhe të përgjithshme dhe veprimtari publike pranë Komunës së Berovës, shifra UPR0101V01000 - 1 realizues, i cili do t`i kryen detyrat e punës për kohë të caktuar të vendit të punës në kohëzgjatje prej 1 viti, me neto rrogë prej 25.388,00 denarë.

(2) Punëtor i KU për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve - mirëmbajtës i ndriçimit publik, në Departamentin për çështje juridike dhe të përgjithshme, Sektorin për çështje juridike dhe të përgjithshme dhe veprimtari publike pranë Komunës së Berovës, shifra UPR0401A04001 - 1 realizues, i cili do t`i kryen detyrat e punës për kohë të caktuar të vendit të punës në kohëzgjatje prej 1 viti, me neto rrogë prej 15.500,00 denarë.

Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kualifikimet e nevojshme të cilat duhet të përmbushen, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune janë:

- për vendin e punës nën numër rendor (1) - niveli i kualifikimit VII A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe me së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VII/1 të mbaruar - shkenca Juridike, me së paku 3 vite përvojë pune në sferën;
- për vendin e punës nën numër rendor (2) - niveli i kualifikimit IV sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe 180 ose 240 kredi të fituara sipas ECVET ose MKSOO ose së paku arsim të mesëm të gjimnazit ose shkollë e mesme profesionale - drejtimi elektro, me ose pa përvojë pune në sferën.

Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët e interesuar janë të obliguar që të parashtrojnë dokumentacionin e nevojshëm në vijim:

- Fletëparaqitje të nënshkruar me dorë për vendin e punës për të cilin paraqiten (mund të merret në Seksionin për udhëheqje me resurse njerëzore në Komunën e Berovës);
- Biografi të shkurtë CV jo më të madhe se 5 faqe, me kontakt të nevojshëm të theksuar dhe adresë dhe letër motivimi me jo më shumë se 500 fjalë;
- Certifikatë të shtetësisë origjinal apo kopje të verifikuar në noter;
- Dëshmi për përvojën me parashtrim të historiatit për punësim nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë;
- Diplomë apo kopje të diplomës të verifikuar në noter për shkallën e mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës;
- Certifikatë nga mjeku për aftësi të përgjithshme shëndetësore si kusht i përgjithshëm për themelim të marrëdhënies së punës, e nënshkruar nga mjek i mjekësisë specialist i mjekësisë së punës, e dhënë nga organizata shëndetësore nga sigurimi shëndetësorë primar e cila e kryen veprimtarinë mjekësore;
- Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (për vendin e punës me numrin rendor 1);
- Certifikatë/vërtetim që me akt të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës nga Gjykata themelore ose Regjistri Qendror i RM.

Kandidatët të cilët në autobiografinë dhe letrën motivuese kanë shënuar të dhëna që kanë të kryer arsim më të lartë nga ajo që kërkohet në shpallje, kanë përvojë pune nga sfera, kanë njohuri të gjuhëve të huaja, apo kanë të shënuara të dhëna tjera, është e nevojshme që për të gjithë ato shënime të dorëzojnë dëshmi përkatëse - dokument në origjinal apo kopje të verifikuar në noter.

Orari i punës:

- Ditët e punës nga e hëna - premte
- Orët e punës në javë - 40
- Orari i punës prej ora 07:30 deri në ora 15:30

Dokumentacioni i nevojshëm në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter të dorëzohen përmes arkivit të Komunës së Berovës, Departamenti për menaxhim me resurset njerëzore ose përmes postës në adresën në vijim: Komuna e Berovës, Departamenti për menaxhim me resurset njerëzore, rr. "Dimitar Vllahov" nr. 10, 2330 Berovë, (me shenjë "për Shpallje publike numër 03/2018 për punësim për kohë të caktuar të punës" në anën tjetër të zarfit të shënohet edhe vendi i punës së për të cilin aplikohet).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes. Afati për parashtrimin e dokumentacionit është tre (3) ditë duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor, duke mos konsideruar ditën e vet publikimit.

Fletëparaqitjet dhe dokumentacionet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Për shkak të urgjencës së procedurës, fletëparaqitjet parashtrohen vetëm përmes arkivit të Komunës së Berovës ose përmes postës me rekomandim.

Procedurën për zgjedhje të kandidatëve do ta realizojë Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të komunës së Berovës.

Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve të rregullt, për përzgjedhjen e kryer administrative secili kandidat do të informohet me shkrim, ndërsa kandidatët e përzgjedhur do të ftohen enkas në intervistë dhe testim në lokalet e Komunës së Berovës.

Komuna e Berovës do të realizojë zgjedhje në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Me kandidatët e përzgjedhur do të lidhet marrëveshje për punë në formë me shkrim, pas vendimit përfundimtar për zgjedhje.

Nr. 04 - 3780/1

Berovë

Komuna e Berovës
Kryetar i Komunës
Zvonko Pekevski

Republika e Maqedonisë
Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor

МКД uroteks

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

B - Leje e integruar ekologjike për Shoqata për prodhim, tregti dhe shërbime ENGTRANS DOOEL-Shkup ENG Beton, Njësia punuese I Shkup

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07,159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë nr. UP1 -11/3 nr. 831/2018 nga 31.05. 2018 për marrjen e B - lejes të integruar ekologjike.

Kategoria e instilacionit:

Instilacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteteve të instilacioneve, bien nën aktiviteti nga Shtojca II Pika 3.3

3.3 Bazat stacionare të betonit me kapacitet të përgjithshëm të silosit me të madh se 50m3.

Kapaciteti Projektues: 360m³ në ditë

Drejtoria e mjedisit jetësor pranë MMJPH përgatiti,

B- Leje të integruar ekologjike për Shoqatë për prodhim, tregti dhe shërbime ENGTRANS DOOEL-Shkup ENG Beton, Njësia punuese I Shkup

Leja do jetë e shpallur, në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk

Ankesa kundër vendimit për lejen mund të dorëzohen nga ana e personave juridik dhe fizik, si edhe nga ana e shoqatave të qytetarëve të themeluara për përparimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, deri te komisioni shtetëror për vendosje për procedurë administrative dhe procedura për marrëdhënie pune i shkallës së dytë, **në afat prej 15 ditëve** që nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Në bazë zë nenit 37-i nga Ligji për ndërmarrjet publike, neni 20-g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14 dhe 119/14), neni 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM nr. 167/15, 27/16, 120/18) dhe neni 22 nga Statuti i NPK "Niskogradba" Manastir, Drejtori i NPK "Niskogradba" Manastir, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të një ofruesi të shërbimit publik 1 (një) realizues për periudhë të pacaktuar kohore edhe atë:

1. Vendi i punës "Udhëheqës i departamentit për përgatitje, projektim dhe zhvillim" shifra e vendit të punës KDR 03 05 A04 039

2. Kushtet e përgjithshme:
   - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
   - të përdorë gjuhën maqedone në mënyrë aktive
   - të jetë i moshës së rritur
   - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
   - me vendin gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Kushtet e veçanta:
   - së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VII/1 të mbaruar, Fakulteti i Ndërtimtarisë
   - së paku dy vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku 1 vit përvojë pune në ndonjë sektor publik, gjegjësisht së paku katër vite përvojë pune në profesionin, prej të cilave së paku dy vite punë në post udhëheqjeje në ndonjë sektor privat
   - njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Unionit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
   - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Java punuese zgjat 5 ditë pune, nga e hëna deri të premten, orari i plotë i punës përmban 40 orë në javë, orari i punës fillon në ora 07:00 dhe zgjat deri në ora 15:00, shuma e pagës mujore fillestare për vendin e punës është 23.680,00 denarë, plus shtesë për mundin e kaluar për 0,5% për secilin vit stazh pune.

Punësimet e parapara sipas planit vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: 1 (një) realizues - Maqedonas(e).

Procedura për selektim për punësim të një ofruesi të shërbimeve publike në NP përbëhet nga kontrollimi i të dhënave të theksuara në fletëparaqitjen për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, kontrollimi i dëshmive të parashtruara në fletëparaqitje dhe intervista.

Shpallja zgjat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor në tre gazeta ditore prej të cilave njëra prej tyre botohet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedone.

Kandidatët duhet t`i parashtrojnë këto dokumente në vijim për përmbushjen e kushteve të duhura për vendin e punës, në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter:

- certifikatë për shtetësi.
- certifikatë të lindjes,
- dëshmi që me vendim gjyqësor nuk ka të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- diplomë për arsim adekuat të mbaruar,
- vërtetim për përvojën e punës,
- dëshmi për përvojën udhëheqëse në vendin e punës,
- fletëparaqitje e plotësuar e cila është e publikuar në ueb faqen e NPK "Niskogradba" Manastir.

Fletëparaqitjet do të jenë në dispozicion në ueb faqe e NPK "Niskogradba" Manastir: https//njnjnj.niskogradbabt.mk ndërsa do të mund të tërhiqen edhe nga arkivi i NPK "Niskogradba" Manastir çdo ditë pune nga ora 07:00 deri 15:00.

Në bashkëngjitje me fletëparaqitjen kandidatët patjetër të parashtrojnë dëshmitë e nevojshme për të dhënat e theksuara në të njëjtën.

Kandidatët janë të detyruar që nën përgjegjësi materiale dhe penale të vërtetojnë që të dhënat në fletëparaqitjen janë të sakta, ndërsa dëshmitë e parashtruara besnike ndaj origjinalit.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e duhur kandidatët janë të detyruar t`i parashtrojnë në NPK "Niskogradba" - Manastir, në rr. Bulevard 1-vi Maj pn, 7000 Manastir, personalisht ose përmes postës.

NPK Niskogradba-Manastir
UD Drejtor
Metodi Siljanovski

KOMUNA E ÇAIRIT ОПШТИНА ЧАИР

KRYETARI I KOMUNËS
Bul. Hristijan T. Karposh Nr. 5
Tel: 02/2616-860 | **faks:** 02/2616-867
info@cair.gov.mk | **www.cair.gov.mk**
Nr. _____ prej datës _____

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gz. Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18) Komuna e Çairit miratoi:

K O M T E S Ë

Njoftohen qytetarët, personat juridik nga hapësira e përfshirë me **Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Çairit – Shkup**, administrata shtetërore, organizata shkencore dhe profesionale, komuna e Çairit – Shkup organizon:

PËRSËRITSHËM TË PREZANTIMI PUBLIK DHE ANKETA PUBLIKE

Ndaj **Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Çairit – Shkup**, i cili përfshin hapësirë prej **14,86 ha**, me këto kufij:
- Në veri kufiri fillon për boshtin e rrugës ndihmëse të posa planifikuar C6 – Rruga Vukovarska.
- Në lindje kufiri fillon për boshtin e rrugës ndihmëse të posa planifikuar C8 – Rruga Kemal Sejfulla, deri te pika e kryqëzimit të hendekut rrugor prej D 75.
- Në jug kufiri fillon për boshtin e rrugës së posa planifikuar anësore Xhon Kenedi prej C4, deri te pikat e kryqëzimit të hendekut rrugor prej D 75 deri te rruga ndihmëse e re e planifikuar C5 – Rruga Dizhonska.
- Në jug kufiri fillon për boshtin e rrugës së posa planifikuar anësore rruga C5 – Rruga Dizhonska - 1, prej boshtit të pikës thyese me rrugën ndihmëse të posa planifikuar C4, deri te pika e kryqëzimit të rrugës ndihmëse të posa planifikuar C6 – Rruga Vukovarska.

Në kufijtë e përfshirjes të PDU planifikohen këto dedikime:
A – Banim
A1 – Banim në shtëpi banimi
A2 – Banim në ndërtesë banimi
B – Dedikime komerciale dhe afariste
B2 – Njësi të mëdha tregtare
C – Institucione publike
C1 – Arsim dhe shkencë
C2 - Mbrojtje shëndetësore dhe sociale
C4 – Institucione shtetërore
D – Infrastrukturë
E1 – Infrastruktura komunale (rrjeti rrugor primar dhe sekondar)
E2 – Infrastruktura komunale (garazhe në kate dhe trafostacion)

Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Çairit – Shkup, do të eksponohet në hapësirat e Komunës së Çairit, në afat prej gjashtë (6) ditë pune (nga data 23.11.2018 deri më 30.11.2018), secilën ditë pune prej ora 8,30 deri më 16,30.

Përsëritshëm të Prezantimi publik i Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Çairit – Shkup, do të mbahet me datë **23.11.2018** me fillim në ora 09.30 në hapësirat e Komunës së Çairit – Shkup, zyra nr. 8.

Fletët anketuese për pjesëmarrje në anketën publike gjenden në hapësirat e Komunës së Çairit, zyra nr. 8.

Në afatin e përcaktuar personat e interesuar fizik dhe juridik, administrata shtetërore, organizatat shkencore dhe profesionale munden të dorëzojnë vërejtje dhe propozime ndaj propozim planit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e –urbanizëm ose në formë me shkrim.
përpiloi : T.S.
miratoi: Xh.H.

Kryetar i Komunës së Çairit
Visar Ganiu

FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT
nr. 019-18/4.1.15

Republika e Maqedonisë
Ministria e arsimit dhe shkencës
Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve
Huaja nr.: 8332-MK

Aktiviteti: Shërbimet e komunikimit dhe fushatës promotive për nevojat e Projektit për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve

Republika e Maqedonisë ka fituar hua nga Banka botërore për nevojat e realizimit të Projektit për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve që implementohet dhe planifikon një pjesë e këtyre mjeteve të shfrytëzohen për pagesë të shërbimeve konsulent.

Shërbimet konsulentë përfshijnë shërbime të komunikimit dhe fushatës promotive për nevojat e Projektit, gjegjësisht Ministria e arsimit dhe shkencës dhe Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik. Kohëzgjatja e paparë e marrëveshjes është deri maj 2019. Përshkrimi i detyrave të punës në gjuhën angleze është në dispozicion në http://mon.gov.mk/index.php/dokumenti/2014-07-30-12-00-34/sdis-proekt

Ministria e arsimit dhe shkencës fton firmat përkatëse kosulente ("Konsulentët") të shprehin interesin e tyre për sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të dorëzojnë informacione/dokumente me të cilat do të vërtetohet se i plotësojnë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Kriteret të cilat duhet ti plotësojnë për futje në listën e ngushtë të firmave më kualifikuese janë:

- Konsulenti të ketë bilanc pozitiv të gjendjes dhe qarkullim vjetor të mjeteve në 3 vitet e fundit fiskale jo më të vogël se 50.000.000 denarë në vit
- Konsulenti të ketë së paku 10 vjet përvojë në krijimin e implementimit të kampanjave për ngritjen e vetëdijes, si dhe përvojë në komunikimet multidisiplinare - integruese, veçanërisht në fushën e arsimit
- Konsulenti të ketë së paku 10 vjet përvojë në organizim të ngjarjeve në institucionet publike dhe sektorin joqeveritar
- Shpërblime dhe vërtetime për punën e suksesshme të konsulentit nga festivale ndërkombëtare me renome, si dhe rekomandime nga klientë konsiderohen si përparësi
- Konsulenti të ketë së paku 10 të punësuar, mes të cilëve kuadrin në vijim: strateg i komunikimit, ekspert për zhvillim të strategjisë kreative, ekspert për zhvillim të IP strategjisë dhe ekspert për planifikim dhe organizim të ngjarjeve.
  Biografitë e ekspertëve individual nuk do të merren parasysh për kualifikim në listën e shkurtë të konsulentëve më të kualifikuar.

Konsulentët e interesuar drejtohen në pikën 1.9 të procedurave për furnizime të Bankës botërore *{Guidelines: Selection and Employment of Consultants [under IBRD Loans and IDA Credits & Grants]* by *World Bank Borrowers, January 2011 ("Consultant Guidelines")},* ku janë theksuar politikat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesave.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formë të shfaqjes së përbashkët ose nën-konsulentë me qëllim të përforcimit të kualifikimeve.

Bashkimet e tilla mund të jenë në formë të "grup konsulentësh" ose "nën-konsulentë". Në rast të "grup konsulentëve", anëtarët e grupit do të evakuohen në mënyrë grupore për futje në listën e shkurtë dhe do të jenë përgjegjës në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për kryerjen e shërbimeve dhe të gjithë anëtarët do të nënshkruajnë marrëveshje në rast të ndarjes së asaj marrëveshje atij grupi. Konsulentët e interesuar në aplikacionet e tyre duhet qartë të shënojnë strukturën dhe "bashkimin" e tyre dhe obligimet për secilin prej anëtarëve dhe nën-konsulentëve. Deklaratat e paqarta për interes në kuptim të "në asociacion me" dhe/ose "në afiliacion me" dhe të ngjashme mund të mos shqyrtohen gjatë formimit të listës së shkurtë të firmave më kualitative.

Sipas parimit "në deklaratë për interes nga një firmë konsulente", secila firmë mund të vendosë nëse do të marrë pjesë si nën-konsulent ose si konsulent i pavarur ose si partner i grupit të konsulentëve. Një firmë mund të dërgojë vetëm një deklaratë për interes në procesin e njëjtë të furnizimeve edhe atë si konsulent i pavarur ose si partner në grup të konsulentëve. Asnjë firmë nuk mund të jetë nën-konsulent në rast se nëse parashtron deklaratë për interes si konsulent i pavarur ose si anëtar i grupit të konsulentëve për procesin e njëjtë të furnizimit. Firma e cila paraqitet si nën-konsulent mund të merr pjesë në më shumë se një deklaratë për interes, por vetëm si nën-konsulent.

Përzgjedhja do të bëhet në bazë të procedurës për zgjedhje sipas kualifikimeve të konsulentëve (Selection Based on Consultants' Qualifications) në pajtim me procedurat për furnizime të Bankës botërore të definuar në "Consultant Guidelines".

Informatat shtesë mund të merren në adresën e shënuar më poshtë gjatë orarit të punës prej 08:30 deri më 16:30.

Deklaratat për interes në gjuhën angleze duhet të dorëzohen në formë të shkruar në adresën e mëposhtme (personalisht, përmes postës, në e-mail) më së voni deri më 04.12.2018.

Ministria e arsimit dhe shkencës – Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve
Për: Daniella Maneva, (për shpallje nr. 019-18)
rr. "Shën Kirili dhe Metodij" nr. 54, 1000 Shkup
Republika e Maqedonisë
e-mail: danijela.maneva@mon.gov.mk (CC: igor.krstevski@mon.gov.mk)

Në bazë të nenit 22 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08,114/09, 130/09, 120/11, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13,170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), Drejtori i IN Qendra për kulturë "Trajko Prokopiev" - Kumanovë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
për punësim të 4 (katër) realizuesve për kohë të pacaktuar edhe atë:

1. Mjeshtër i tonit, me shifrën KUL0405A01004 – 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës Shqipe, për kohë të pacaktuar, me arsim së paku të mesëm katërvjeçar të mbaruar, gjegjësisht arsim i mesëm trevjeçar.
2. Mjeshtër i ndriçimit, me shifrën KUL04305A01002 – 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës Shqipe, për kohë të pacaktuar, me arsim së paku të mesëm katërvjeçar të mbaruar, gjegjësisht arsim i mesëm trevjeçar.
3. Mirëmbajtës i higjienës, me shifrën KUL0401B03001– 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës Shqipe, për kohë të pacaktuar, me së paku arsim fillor të mbaruar.
4. Mirëmbajtës i higjienës, me shifrën KUL0401B03001– 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës serbe, për kohë të pacaktuar, me së paku arsim fillor të mbaruar.

Në bashkëngjitje me fletëparaqitjen kandidati duhet të parashtrojë:
- Dëshmi për arsim adekuat të mbaruar (dëftesë, diplomë, certifikatë), origjinal ose kopje e vërtetuar në noter.
- Certifikatë për shtetësi, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter.
- Vërtetim mjekësor.
- Dëshmi që nuk ka të shquar dënim ose sanksion ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Vërtetim për dosje penale.

Afati për parashtrim të dokumenteve është 5 ditë pune, llogaritur nga dita e nesërme nga publikimi i shpalljes.
Përzgjedhja do të bëhet në afat prej 45 ditë pune pas skadimit të afatit për paraqitje.
Orari i punës për:
Vendi i punës - **Mjeshtër i tonit, me shifrën KUL0405A01004 -** 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës Shqipe është 40 orë në javë (e hënë - e premte), 8 orë në ditë dhe i njëjti zgjat gradualisht nga ora 10:00 - 14:00 dhe nga ora 18:00 - 22:00.
Vendi i punës - **mjeshtër i ndriçimit, me shifrën KUL04305A01002 -** 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës Shqipe është 40 orë në javë (e hënë - e premte), 8 orë në ditë dhe i njëjti zgjat gradualisht nga ora 10:00 - 14:00 dhe nga ora 18:00 - 22:00.
Vendi i punës - **Mirëmbajtës i higjienës, me shifrën KUL0401B03001**– 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës Shqipe, është 40 orë në javë (e hënë - e premte), 8 orë në ditë me ndërrime edhe atë nga ora 08:30 - 16:30 ndërrimi i parë, dhe 14:00 - 22:00 ndërrimi i dytë.
Vendi i punës - **Mirëmbajtës i higjienës, me shifrën KUL0401B03001**– 1 (një) realizues, me njohje të gjuhës serbe është 40 orë në javë (e hënë - e premte), 8 orë në ditë me ndërrime edhe atë nga ora 08:30 - 16:30 ndërrimi i parë, dhe 14:00 - 22:00 ndërrimi i dytë.

Rroga neto fillestare për vendet e punës është:
- **Mjeshtër i tonit, me shifrën KUL0405A01004,** është **17.767,00** denarë.
- **Mjeshtër i ndriçimit, me shifrën KUL04305A01002,** është **18.522,00** denarë.
- **Mirëmbajtës i higjienës, me shifrën KUL0401B03001** është **12.165,00** denarë.
- **Mirëmbajtës i higjienës, me shifrën KUL0401B03001** është **12.165,00** denarë.

Dokumentacioni jo i kompletuar, jo i rregulluar dhe i vonuar nuk do të mbikëqyret.
Fletëparaqitja me dokumentet e duhura të parashtrohet deri tek IN Qendra për kulturë "Trajko Prokopiev" - Kumanovë
Sheshi "Marshall Tito" nr. 3, 1300 Kumanovë.
Tel. 031/415 - 099

Drejtor,
Sasho Todorovski

E4E@MK ОБРАЗОВАНИЕ ЗА ВРАБОТУВАЊЕ ВО МАКЕДОНИЈА

KËRKESË

Për mbledhjen e ofertave nr. E4E 02/18

Projekt Arsimi për punësim në Maqedoni (E4E@mk) i mbështetur nga agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe i implementuar nga ana e Helvetas Swiss Intercooperation, Qendra maqedonase për edukim qytetar (QMEQ) dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë, fton të gjithë organizatat kualifikuese me përvojë të hulumtimit në arsim t`i parashtrojnë ofertat e tyre **për realizim të hulumtimeve për gjendjen fillestare të perceptimeve të nxënësve nga arsimi profesional i mesëm varësisht nga kualiteti, qasja dhe orientimi i arsimit profesional ndaj tregut të punës.**

Palët e interesuara mund të kërkojnë kopje të Përshkrimit të detyrave të punës duke filluar nga 20 nëntor 2018 në hapësirat e Projektit në rr. Vasil Gjorgov 16, kati i 2-të (QT Zebra) në Shkup. Telefon për informata: 071 214 473 (nga ora 08:30 deri 16:30). Të gjitha ofertat duhet të parashtrohen jo më vonë se 29 nëntor 2018, deri ora 14:00 në adresën e lartpërmendur.

Vërejtje: Përmbledhja e ofertave për kërkesën e lartpërmendur nuk do të thotë edhe përcaktim automatik i marrëveshjes për pune.

Shitet tokë e cila gjendet në Shkup ,f. Bukoviq, edhe atë:
-PK 1091/3, vendi i quajtur Rapshec , me sipërfaqe prej 270m2;
Flet pronësi nr. 430 për KK Bukoviq, pronësi e Ademi Abdulfehat.

Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat e tyre mund t`i paraqesin në zyrën e Noterit Mahir Ziberit, rr. Butelska nr. 4 , Shkup-Butel.

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

SH.F.K. **"11 TETORI"** Rr. 102 pn. Urviç Bogovinë
E-mail: : shf-11tetori@live.com

Nr. 0401-271/2 19-11-2018

Në bazë aktvendimit me nr. prot. 08-2258/2 të kryetarit të komunës së Bogovinës, nenit 126 paragrafi 7,8,9 dhe neni 128 paragrafi 3 nga Ligji për arsim fillor (Gazeta zyrtare e RM nr. 103/2008 ,33/10, 156/10 dhe 181/11), dhe neni 93 paragrafi 1,2,3 nga Statuti i SH.F.K. "11 Tetori", Urviç Këshilli i shkollës publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
PËR EMËRIM TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

KUSHTET:
Pos kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj kandidati duhet t`i plotësoj edhe këto kushte të veçanta:
- Të ketë të kryer së paku arsimim të lartë dhe t`i plotësojë kushtet për arsimtar ose për bashkëpunëtor profesional në shkollën fillore;
- Të ketë 5 vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimore dhe
- Të ketë dhënë provimin për drejtor.

Kandidatët bashkë me kërkesën duhet ti dorëzojnë këto dokumente te nevojshme:
- biografi të shkruar (CV e shkurt);
- diplomën për arsimin e lartë të kryer, të grupit lëndor ose klasor, pedagog, psikolog;
- certifikatë për provimin e dhënë për drejtor, por nëse s'ka provim të dhënë për drejtor, obligohet që në afat prej një viti nga dita e emërimit ta japë provimin për drejtor
- testin psikologjik dhe testin për integritet
- Listing me më pak se 5(pesë) vite pune, në procesin edukativo-arsimor
- certifikatë nga libri amzë i të lindurve;
- certifikatë për nënshtetësi;
- certifikatë që nuk është i gjykuar dhe nën hetime;
- certifikatë mjekësore;
- program për punën 4 vjeçare;
- të këtë certifikatë adekuate jo më të vjetër se pesë vjet, për njohje të gjuhës angleze TOEFEL IBT – më së paku 30 pikë, IELTS – më së paku 30 pikë, BULATS – më së paku 20 pikë, ose KET (Cambridge English) të kryer.

Konkursi zgjat 8 (tetë) ditë nga dita e shpalljes në revistat ditore.
Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet në adresën: SH.F.K. "11 Tetori" f.Urviç.
Dokumentet e pakompletuara si dhe ato të cilat do të arrijnë pas afatit të paraparë në shpallje, nuk do merren në shqyrtim.

Këshilli i shkollës
K r y e t a r
Gjurkan Rashiti

UNITEDI S'DO TË GJEJË TRAJNER MË TË MIRË SE MOURINHO

Manchester Unitedi nuk do të gjejë trajner më të mirë sesa Jose Mourinho. Kështu thotë ish-futbollisti Benni McCarthy, i cili e kishte fituar Ligën e Kampionëve nën drejtimin e Mourinhos me Porton në vitin 2004. McCarthy thotë se "Special One" është njëri prej trajnerëve më të mirë në qarkullim

Ish-futbollisti Benni McCarthy thotë se Manchester Unitedi nuk do të gjejë trajner më të mirë sesa Jose Mourinho, duke shtuar se portugezi është njëri prej më të mirëve në qarkullim. Mourinho është kritikuar shumë pas fillimit të dobët të edicionit me "Djajtë e Kuq" këtë stinor dhe pozita e tij si trajner i klubit anglez është vënë shpeshherë në dyshim, por McCarthy, i cili kishte fituar Ligën e Kampionëve nën drejtimin e Jose Mourinhos me Porton në vitin 2004 shprehet se klubi nga "Old Trafford" duhet të vazhdojë me portugezin. "Ndonjëherë në jetë ju do ta prekni fundin dhe Jose e ka përjetuar këtë edicion, por 100% ai do të kthehet përsëri. Manchester Unitedi nuk duhet të heqë dikë që për mendimin tim është njëri prej trajnerëve më të mirë në qarkullim. Me kë do ta zëvendësonin? Nuk mendoj se aty ka trajnerë më të mirë sesa Mourinho", është shprehur McCarthy. "Ai e ka personalitetin dhe karakterin për të dalë nga kjo situatë. Për mua ai është trajneri më i mirë për Manchester Unitedin. Atij thjesht mund t'i duhet ta kuptojë që kohërat kanë ndryshuar dhe se ai duhet t'i mbysë egot e lojtarët ndonjëherë dhe të pranojë se lojtarët e rinj kanë nevojë për më shumë dashuri dhe përkushtim. Ai nuk është një tip që mbyt egon e dikujt sepse ai beson që ju duhet të dilni jashtë dhe të paraqiteni si profesionalist sepse paguheni shumë para dhe është puna juaj që të tregoni më të mirën gjatë gjithë kohës", tha ai. "Nga këndvështrimi im personal, Jose ka pasur ndikimin më të madh tek unë. Ai ishte ai lloj i njeriut që unë doja të bëhesha. Mënyra se si ai ishte me lojtarët e tij dhe aftësitë e tij menaxheriale, askush nuk i afrohet. Nga ana taktike si trajner i futbollit nuk mund ta përshkruanit sesa i mirë ishte ai. Vetëm me taktika ai mund të fitonte ndeshjen edhe pa e goditur topin. Ai ishte i gjerë në mënyrën sesi donte që ne të luanim. Unë gjithmonë do t'i jem mirënjohës", ka thënë McCarthy, i cili gjatë karrierës së tij ka luajtur për klube si West Ham, Blackburn, Porto, Celta Vigo e Ajax.

Zbardhet plani i Marotta tek Interi

Zyrtarizimi është duke ardhur, pritet të bëhet së shpejti. Giuseppe Marotta do të jetë kryeshefi i ardhshëm i Interit për aspektin sportiv, së bashku me Alessandro Antonello, i cili do të vazhdojë të kryejë detyrat financiare në klub. Ish-ekzekutivi i Juventusit është në Kinë për të finalizuar detajet e fundit të kontratës, që do ta lidhë atë me zikaltrit për tri vitet e ardhshme. Më pas, Marotta premton goditje në merkato. Nga vera e ardhshme mbaron kushtëzimi i "fair play financiar" për Interin. Me ardhjen e menjëhershme të Marotta, kanë filluar të marrin formë edhe strategjitë zikaltër në merkato. Interi do të jetë protagonist i sigurt në muajt e ardhshëm, kur priten investime të mëdha, por jo të ekzagjeruara. Siç është raportuar nga "Corriere dello Sport", një nga emrat në krye të listës së përforcimeve, i ndjekur nga Marotta, është Sergej Milinkoviç-Savic. Serbi është një nga objektivat madhorë të 61-vjeçarit, tashmë i ndjekur nga afër prej tij për disa muaj, sa drejtonte merkaton te Juventusi. Çmimi i lojtarit të rëndësishëm të Lazio është mjaft i shtrenjtë, ndërsa negocimi me Lotito nuk do të jetë i lehtë, siç mëson historia. Megjithatë, Interi mbetet "në dritare" dhe është gati të hyjë në garën për serbin, duke qenë i përgatitur për ndonjë zhvillim të papritur të situatës. Vëmendje të madhe do të ketë Marotta edhe për një transferim me parametra zero, të kërkuar nga Marotta në Torino. Rabiot është një nga profilet më tërheqëse, si Martial, Ander Herrera dhe Ramsey, për të cilët, megjithatë, mbetet në avantazh të qartë Bayern Munich. Do të jetë një Inter i ri dhe i fortë, prandaj lojtarë si Andersen i Sampdoria dhe Frenkie de Jong nga Ajax janë kthyer në qendër të interesit zikaltër.

Candreva drejt largimit

Aventurës së Antonio Candrevas te Interi po i vjen fundi. Futbollisti i cili nuk po gjen një vend titullari në formacionin e Spallettit, me shumë mundësi do të largohet nga zikaltrit që gjatë merkatos së Janarit. Ekipet që kanë shfaqur interes për 31-vjeçarin janë të shumta, por, me sa duket, lojtari e ka një skuadër të preferuar që është pikërisht Torino e presidentit Cairo. Klubi "granata" ka kohë që e kërkon mesfushorin, të cilin mund ta transferojë nën urdhrat e trajnerit Mazzarri që gjatë merkatos së janarit.

Zbulohen ofertat e Realit dhe Bayernit për Wengerin

Ish-presidenti i Paris Saint-Germainit, Charles Villeneuve, ka zbuluar se Arsene Wenger kishte marrë oferta nga Real Madridi edhe gjatë kohës kur ai ishte ende trajner i Arsenalit. Wengeri i kaloi 22 vjet në pozitën e trajnerit të topçinjve dhe edhe vetë ai e kishte bërë të ditur se kishte marrë oferta nga klube të La Ligës gjatë kohës kur ishte me Arsenalin. Tanimë është zbuluar se francezi madje kishte mbajtur edhe negociata me "Los Blancos", pasi që këta të fundit tentuan ta largonin atë nga Premierliga. Asnjë marrëveshje nuk u arrit dhe Wengeri u largua nga Arsenali vetëm këtë verë. Ai u largua pasi mori shumë kritika nga tifozë dhe analistë të futbollit pasi që nuk arrinte ta fuste Arsenalin as në top katër klubet e Premierligës. Disa nga tifozët e Arsenalit nuk shkonim më në stadium dhe protestonim kundër tij, për shkak të paraqitjeve dhe rezultateve të dobëta. "Dy klube e kërkonim gjithnjë atë si trajner. Njëri ishte Bayern Munich, sepse ai flet katër gjuhë të ndryshme", ka bërë të ditur Villeneuve

për Paris United. "Unë gjithashtu shkova në një gjimnaz në Itali për t'i filluar bisedimet me Real Madrid, por ai vendoi të mos largohej nga Arsenali". Villeneuve kishte qenë gazetar para se ta merrte rolin e presidentit të PSG-së mes majit të vitit 2008 dhe janarit të vitit 2009.

Pas Madagaskarit, vendi i arit dhe diamantit shkruan përrallën tjetër afrikane

Keni dëgjuar për ishullin Mauritius, "perla" e Oqeanit Indian dhe aty ku "strehohen" në ditët më të ftohta të vitit ata që e kanë mundësinë ekonomike... Por, të ngrejë dorën ai që ka dëgjuar ndonjëherë të flitet për shtetin Mauritania. Sigurisht, jemi në Afrikë, në një vend që deri në vitet 900 kishte skllavëri dhe 90% e territorit ishte e përbërë nga... asgjë. Po, po, asgjë! Sepse, edhe në ditët e sotme, në shtetin e vogël të kontinentit të zi, ku flitet edhe frëngjisht, shkretëtira, shkëmbinjtë dhe dunat që krijohen janë panorama që do të shihni. Por, nëse deri më sot nuk kishit dëgjuar, atëherë siç duket futbolli edhe njëherë është bërë një ambasador dhe përfaqësues. Historia sapo është shkruar në kryeqytetin Nouakçot, aty ku tashmë kanë vetëm një hero, Ismail Diakite. Do të vijmë te historia e këtij kombi dhe këtij futbollisti, por duhet të dini se Mauritania është një vend që falë peshkimit (është ndër zonat botërore ku ka bollëk peshku, falë edhe pranisë së Oqeanit dhe sidomos favorizimit të erërave) dhe pranisë së arit e diamantit në tokën e saj, po rritet

gradualisht në ekonomi. Pse futbolli ambasador? E thjeshtë, sepse sot, Mauritania, për të parën herë në historinë e saj, pas fitores 2-1 ndaj Botsvanas, është kualifikuar në Kupën e Afrikës. Pas përrallës Madagaskar, listës i shtohet edhe Mauritania, që në historinë e themelimit të saj si kombëtare, ka bërë vetëm një rol: të marrë pjesë në kualifikuese!

DASHI 21. mars - 20. prill

Hëna do jete e pozicionuar mire ne qiellin tuaj te dashurisë. Ajo do iu sjelle mjaft përfitime, ndryshime pozitive dhe do e përforcojë marrëdhënien me partnerin. Do i kushtoni shume kohe atij qe dashuroni. Drite jeshile edhe për beqaret. Venusi do iu sjelle një surprize te këndshme. Me Neptunin, planetin fatit, do jeni te mbrojtur ne planin financiar. Pas pak do vije edhe një përmirësim i konsiderueshëm.

DEMI 21. prill - 21. maj

Neptuni do sjelle pështjellime ne jetën sentimentale te çifteve. Disa do kenë edhe shume vështirësi për te komunikuar me njeri-tjetrin. Nëse tregoheni me tolerante dhe te kuptueshëm situata mund te përmirësohet. beqaret do jene shume kërkues, do kenë fat por nuk do duan te krijojnë një lidhje serioze. Fati me financat nuk do iu mungoje por duhet te mundoheni ta ruani atë.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Gjithçka do shkoje për mrekulli sot për te lindurit e kësaj shenje. Do ndiheni rehat dhe ambienti do jete me i këndshëm dhe me i ngrohte. Beqaret do kenë takime e do tregohen mjaft te sjellshëm me personat qe do takojnë. Ne këtë mënyrë mund te arrini atë qe doni. Situata ne sektorin e financave do jete e qete dhe e qëndrueshme. Mund te bëni edhe ndonjë shpenzime me shume sot.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dielli do te ndriçoje me shume ne jetën e çifteve sot, sidomos ne mëngjes. Edhe Jupiteri, planeti i fatit do jete ne anën tuaj. Gjithsesi vigjilencën nuk duhet ta humbisni! Merkuri do jete mjaft i favorshëm për beqaret. Nen influencën e tij do keni ndryshime mjaft pozitive. Planin material do jete i mbrojtur dhe pa probleme te veçanta. Gjithsesi shmangni sa te mundni nënshkrimet e kontratave.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Ata qe janë ne çift do jene me te gatshëm sesa zakonisht dhe me te kujdesshëm për te plotësuar dëshirat e atij qe kane ne krah. Beqaret duhet te mbyllin çdo porte te se shkuarës dhe te hapin një faqe te re ne jetën e tyre. Sharmi nuk do iu mungoje, përfitoni. Venusi do iu mbroje planin e financave, por nëse shpenzoni me shume sesa duhet askush nuk do ua largoje vështirësitë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Gjate ditës se sotme do ketë momente kur marrëdhënia me partnerin do jete e ftohte. Për me tepër xhelozia do te shfaqet dhe do i përkeqësoje gjerat. Beqaret duhet te bëjnë kujdes sepse ka rrezik te zhgënjehen shume nga personat qe do takojnë. Doni te ndiheni me mire atje ku jetoni dhe te shpenzoni për këtë. Kujdes, duke qene se financat nuk janë te mira do merrni hua qe mezi do i shlyeni.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Marrëdhënia juaj me partnerin do te behet me e forte sot. te nxitur nga Venusi ju do jeni me te kuptueshme, me emocionale dhe me shprehës ndaj partnerit. Shume beqare do shohin te linde një dashuri e këndshme dhe mjaft premtuese. Përfitoni! Ka ardhur koha te bëni me shume ekonomi. Disa do bëjnë shpenzime te mëdha dhe te papritura dhe disa do kenë probleme me një trashëgimi.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Jeta ne çift do kaloje një prove gjate kësaj dite. Rrethanat do bëjnë te mundur qe iu te zgjidhni çdo problem qe keni pasur kohet e fundit me partnerin dhe qe iu kane larguar pak nga njeri-tjetri. Beqaret te cilëve iu rendonte mjaft vetmia do kenë aventura qe nuk do i kënaqin. Durim për dashurinë e shumëpritur. Do merreni me tepër me menaxhimin e buxhetit dhe do keni fat.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dite e bukur për jetën ne çift. Do merrni kënaqësi pa fund dhe disa nga dëshirat tuaja me te shtrenjta do te plotësohen. Beqaret nga ana tjetër do kenë një takim te papritur por qe do te marre një kthese interesante. E ardhmja pritet te jete shume e mire. Nëse keni mundësi te flisni me ndonjë ekspert për menaxhimin e financave do bënit mire. Gjithsesi situata nuk është alarmante.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Marrëdhënia juaj me atë qe keni ne krah do jete e mrekullueshme. Gjithë energjia dhe pasioni juaj do përqendrohen tek partneri dhe ai do e çmoje këtë. klima sentimentale e beqareve rrezikon te mos jete shume harmonike. Beni durim sepse çdo gjë do te rregullohet shpejt. Keni pak kohe qe nuk luftoni për te rritur te ardhurat, por sot kjo periudhe mbaroi. Do merrni masat e duhura.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Prezenca e Saturnit do iu beje me nazeli ndaj partnerit tuaj. Ky i fundit i çuditur nga sjellja juaj, e cila do jete shume ndryshe nga çka qene nuk do dije c'të beje. Beqaret, fale konfigurimit te yjeve, do kenë një eksperience mbresëlënëse, por qe nuk do jete shume e lehte për t'u jetuar. Yjet do i mbrojnë financat tuaja dhe situata do jete e qëndrueshme. Do jeni te kujdesshme me çdo gjë.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Duke qene se kundërshtitë do te mbizotërojnë ne jetën tuaj ne çift, do fryje edhe një ere revolte e cila do iu marre edhe ju me vete. Tregohuni shume te matur! Dita e beqareve do jete mjaft e bukur. Do jeni sharmante dhe Hëna do iu rezervoje një dashuri sekrete. Interesat financiare do te stimulohen dhe do mund te forconi buxhetin. Gjithsesi mos e humbni asnjëherë sensin e maturisë.

Mensur Mamuti	AUTORI KOSOVAR NË FOTO	BISKOTË, PEKSIMADHE / VEPËR E AUTORIT NË FOTO	P	KËNGËRE E JONA / FEMRA E ARIUT	E
I PËRSOSUR					
QYTET NË INDI, NABIGANXH					
VEPRIMTARI YNË, GËRVALLA					
KËNGËTARJA AMERIKANE, KEJS					
ORGANI QËNDROR I ORGANIZMIT (PASHQ.)					
PERIODIC TABLE OF ELEMENTS / ISHULL GREK				AUSTRIA / NDAJFOLJE, NË TË GJITHA ANËT	
K					VENDI I ARBËRVE (PASHQ.)
ONTARIO			NATRIUMI / DAULLE AFRIKANE (SH.)		
PRERËS LETRASH					
AI QË BËN SHTAMBA, POÇAR					
I SHIJSHËM					
KOHA	AKADEMIKU YNË, STAROVA / KËSULË NGA LESHI I DELES				
FOSFORI		AKTORJA FRENGE, ZHIRARDO / ERË E KEQE			
RRJEDHË UJI					VARGJE KURANORE / BERILIUMI
ATDHETARI YNË, BOLETINI				MËRZIT (DIKË) / JODI	
SHOSHITJE					

THIRRJE TELEFONIKE	RUMANIA	KOHA	REIUMI	VEND NË DRENICË, VENDLINDJA E AUTORIT NË FOTO	
		REPUBLIKA FEDERALE / VEND NË TEKSAS			
	LEONARD (SHKURT.) / VEPËR E AUTORIT NË FOTO, "... E TRËNDAFILAVE"				
			RUMANIA / AUTORI BENGAL, BANERXHI		
TOKAT E PUNUARA / AFRIM EMINI					
BANORËT E AONISË					

ZGJIDHJET: P, E, IDEAL, LAKRI, JUSUF, ALLISHA, ZEMËR, PTE, A, KRETA, ON, NA, KATER, SHTAMBAR, RF, I ËMBËL, LEO, STAROVA, R, P, ANI, ARAT, LUMË, AJETE, ISË, BEZDIS, SITJE, AONË.

Sudoku

mesatar

			9		6			
	4					5		
3	9	1	4					8
	3			7				
6		5	1		2	4		3
				5			2	
4					9	1	6	5
		3					9	
			5		1			

shumë i lehtë

	9			6	8		7	
1				2				6
		6				8		
8			3	5				
3	1						9	8
				4	1			5
		3				6		
7				3				9
	4		2	1			5	

Shumë i lehtë: 492168573, 187523946, 536794821, 874359162, 315672498, 629841735, 253987614, 761435289, 948216357. **Mesatar:** 758916342, 246738519, 391425678, 132874956, 675192483, 984653721, 427389165, 513267894, 869541237.

ÇDO EVROPIAN PRODHON 200 KG MBETJE TË RREZIKSHME NË VIT

Çdo qytetar evropian prodhon mesatarisht në vit 200 kg mbetje të rrezikshme. Sipas Agjencisë Evropiane të Ambientit, këto mbetje përmbajnë elementë të dëmshëm për shëndetin e njerëzve, por edhe për ambientin. Bëhet fjalë kryesisht për elementë që ndodhen tek kozmetika, bateritë, bojërat, pesticidet, llambat dhe të gjitha mbetjet elektrike dhe elektronike kryesisht të elektroshtëpiakeve që përdorim në shtëpitë tona. Për të gjithë këto argumente dhe për të hartuar politikat e duhura për të gjetur një zgjidhje për këtë problem kaq bashkëkohor, po mbahen punimet e Javës Evropiane për Reduktimin e Mbetjeve nga 17-25 Nëntor. Kongresi që ka mbërritur në Edicionin e 10 tashmë, këtë vit ka si temë diskutimesh pikërisht mbetjet e rrezikshme që mbërrijnë kryesisht nga produktet e përdorimit shtëpiak dhe vetjak.

Gruaja fsheh për 2 vjet vajzën në bagazhin e makinës

Rosa Maria Da Cruz, një nënë 50 vjeçe kishte fshehur vajzën e saj në bagazhin e makinës. Ngjarja ka ndodhur në Tulle të Francës në vitin 2013 dhe ngjarja u zbulua nga një mekanik. Ky i fundit kishte dëgjuar zhurmat që vinin nga makina dhe duke menduar se ishte një kafshë, e hapi dhe gjeti Serenën e vogël në kushte çnjerëzore. Fëmija, e cila është tani shtatë vjeçe tashmë u dha për kujdestari. Kur u gjet, shpëtuesit shpjeguan se ishte në kushte të dëshpëruara dhe vetëm pak mund të arrinte qe të mbijetonte aty brenda. Vajza e vogël erdhi në jetë nga një marrëdhënie jashtëmartesore. Gruaja kishte edhe 3 fëmijë të tjerë dhe për këtë arsye kishte vendosur që ta fshihte në makinë. Gruaja është akuzuar për keqtrajtimin e të miturve dhe rrezikon deri në 20 vjet burg.

Prezervativë falas për të rinjtë nën 26-vjeç!

Kontraceptivë falas për të rinjtë nën moshën 26 vjeç, për ata që tashmë janë të përjashtuar nga shpenzimet e kujdesit shëndetësor, azilkërkuesit ose përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare: kjo është ajo që M5 propozon në një ndryshim të manovrimit që përfshin, për një vit, edhe gratë që kanë pësuar një ndërprerje të shtatzënisë.

Pajisja falas e kontraceptivëve "barrierë" gjithashtu do të garantohej "për ata që janë diagnostikuar me sëmundje seksuale". Vendimi bie ndesh me një nga masat e mëparshme të miratuara nga ekzekutivi i partisë, përkatësisht dhënia falas e tokës bujqësore për familjet të cilat në vitin 2019, 2020 dhe 2021 do të lindin fëmijën e tretë.

Mes amendamenteve të Manovra-s, përfshihen ato që kanë të bëjnë me heqjen e makinave të vjetra. Liga propozon një nxitje prej një mijë euro, 500 të financuara nga shteti dhe 500 nga shitësit, për të hequr makinat e vjetra me benzinë nga euro 0 në euro 3 (edhe nëse janë të pajisura me sisteme të gazit natyror ose LPG). Nxitja, në propozimin e Lega-s, vlen për makinat e reja "të blera dhe të regjistruara, duke filluar nga 1 janari 2019 dhe deri më 31 dhjetor 2020".

Materiali që mbyll plagët jo me qepje, por me lazer



Pacientët që iu nënshtrohen operacioneve nuk do të kenë më nevojë për qepje. Studiuesit në Universitetin e Arizonës kanë zhvilluar një nano-material prej mëndafshi dhe ari që mund të mbyllë plagët. Për këtë qëllim, përzierja duhet të aktivizohet me një rreze lazer. Në eksperimentet e kafshëve, metoda e re e plagëve mbyllëse tashmë është testuar. Qasja e re e bën të mundur mbylljen e plagëve në indet e buta pa qepje ose ngjitje. Në eksperimente me derrat, mbyllja e plagës së re ishte shtatë herë më elastik se metodat tradicionale. Rezultatet u botuan në revistën Advanced Functional Materials. Materiali me të cilin janë mbyllur plagët përbëhet nga një pëlhurë mëndafshi në të cilën përfshihen nano-rodet e arit. Ari konverton dritën lazer në nxehtësi, gjë që shkakton fibroinën e proteinës së mëndafshit që të lidhet me kolagjenin në qelizat e lëkurës. Lëkura nuk dëmtohet nga nxehtësia.

KALENDARI HISTORIK 20 NËNTOR

326 - Bazilika e vjetër e Shën Pjetrit shpallet e shenjtë.

1307 - William Tell gjuan mollën mbi kokën e djalit të vet.

1494 - Mbreti francez Sharl VIII okupon Firencën.

1497 - Vasko de Gama arrin në Kepin e Shpresës së Mirë.

1738 - Franca dhe Austria nënshkruajnë marrëveshje të paqes.

1793 - Zyrtarisht hapet Luvri në Paris.

1820 - Zbulohet Antarktiku nga Kapiteni amerikan Nathaniel B Palmer.

1918 - Latvia shpall pavarësinë nga Rusia.

1936 - Gjermania dhe Italia njohin qeverinë e Françesko Frankos në Spanjë.

1956 - Maroku fiton pavarësinë.

1970 - Holanda dhe Shqipëria ndërtojnë marrëdhënie diplomatike.

A E DINI SE...

RESTORANTI KU SHËRBEHEN USHQIME ME KANABIS

Muajin e ardhshëm, në Brighton të Mbretërisë së Bashkuar, do të hapet një restorant i veçantë. Kjo e fundit qëndron në faktin se aty do të shërbehen ushqime të cilat do të kenë përmbajtje kanabisi. Restoranti do përdorë kanabidiol, një dozë më të ulët se kanabisi. Themeluesi i restorantit, Sam Evolution tha se ai ka punuar për shumë vite që të sjellë këtë gjë të re për konsumatorët. "Përfshirja e kanabidolit mund të jetë burimi ushqimor më i plotë me shumë përfitime terapeutike", tha ai.



BARSOLETA

DEPRESIONI

Burri i mërzitur ulur në kafene me një birrë përpara. Vjen një mik i tij, e sheh ulet në tavolinë dhe merr birrën e tij dhe e pi. Burri i mërzitur ia plasë vajit, ndërsa shoku e pyet: Çfarë ndodhi, pse po qanë për një birrë a?
- "Eh more mik sot e kam pasur një ditë shumë të keqe, asgjë s'po më ecën mbarë.
- Pse çfarë ka ndodhur, tregomë?
- Dje shkova në shtëpi, kur qe e pashë gruan në shtrat me një tjetër. Në drekë më lajmëruan se më kanë larguar nga puna. Gruaja iku me atë burrin tjetër, i kishte marrë edhe të gjitha paratë në bankë dhe mbeta pa asnjë cent. Provova ta mbysë veten. E mora litarin për tu varur, mu këput. E mora revolen për ta vrarë veten, nuk shkrepi. U shtriva në hekurudhë, treni nuk erdhi ishte bllokuar diku në borë. Me paratë e fundit që kisha në xhep e bleva një helm dhe e derdha në birrë, dhe ja ti erdhe e ma pive birrën...

THËNIA E DITËS

Mund t'i rezistosh një pushtimi të ushtrisë, por nuk mund t'i rezistosh një pushtimi të ideve.
(Victor Hugo)